

**Niko Nikolla**



**NJERIU  
PA EMER**  
roman

Niko  
Nikolla

---

NJERIU  
PA EMER



roman  
satirik



---

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»  
TIRANË

51400

## PROLOG



Në agjencitë e autobusëve të linjave interurbane, zakonisht njerëzit që nisen, përcjellin apo presin, bëjnë një lloj zhurme që u ngjet pazareve të vegjël. Një gjë e tillë po kryhej edhe atë mëngjes në agjencinë e Tiranës, kur, papritur, zhurma u pre dhe, përmes heshtjes së thellë, filloi të shquhej një zë i qetë, i qartë dhe tingëllues. Spikeri i radios transmetonte një lajm. Gjindja kurioze gati mbajti frymën. Spikeri njoftonte se kometa Hallej, pasi i qe afruar Tokës 174 milionë kilometra, kishte ndërruar drejtim.

Rreth kometës Hallej bisedat kishin kohë që zienin. Herë-herë lajmet për të përhapeshin ogurzeza si diçka mi-

stike dhe e frikshme. Herë-herë njerëzit e largonin këtë frikë për faktin se ajo edhe 75 vjet më parë i ishte afruar Tokës, madje në atë kohë kishte hyrë edhe në folklorin tonë. Pra hamendjet, bisedat, diskutimet rreth saj tani spikeri po i priste si me thikë.

Në këto çaste në mes të heshtjes dhe kuriozitetit, çau përmes turmës një djalosh shtatlartë, me rroba bojëqielli, me flokë të gufuar, fytyrë ezmore, në mesin e së cilës kishin zënë vend një palë syze të errëta, ndërsa në dorë mbante një çantë të madhe nga ato që kanë zakonisht nëpunësit e dikastereve.

«Sonda xhirota, — vazhdonte spikeri, — për të vëzhguar kometën, pasi bëri një udhëtim prej 700 milionë kilometrash, iu afrua asaj dhe bëri 4 mijë fotografi.»

Një udhëtar fërshëlleu e tha:

— 4 mijë fotografi, sa plani im vjetor.

Spikeri vazhdonte:

«Bërthama e kometës i ngjante një arre të madhe me diametër 11 kilometra.»

Një udhëtar tjetër, duke lëvizur kokën e duart bashkë, tha:

— Me një fjalë ajo nuk na ra.

Në këto çaste djaloshi me rroba bojë qielli hyri hijerëndë në autobus dhe po ulej në një nga vendet e preferuara. Një udhëtar çakërrqejf, duke zënë kokën me një dorë dhe tjetrën duke e zgjatur përpara, tha:

— Bobo, kometa hyri në autobus.

Njeriu me rroba bojë qielli e dëgjoi romuzin, po nuk foli. Ai plasi çantën në ndjenjëse dhe nxori kokën në dritare.

Ndërkaq spikeri vazhdonte: «Kometa po largohet dhe, sipas llogarive astronomike, i takon t'i afrohet Tokës në vitin 2062.»

Njeriu që iu drejtua romuzi, foli me zë të lartë:

— Një minutë, shofer...

— Një minutë, — përsëriti udhëtari që kishte në krah pa ditur edhe ai vetë pse e nxori këtë fjalë.

— Një minutë, një minutë, — belbëzuan edhe nja dy-tre udhëtarë të tjerë.

Shoferi ktheu kokën prapa të merrte vesh ç'ishte kjo thirrje «një minutë.»

Personi me rroba bojë qielli kishte nxjerrë kokën në dritare dhe po i thoshte një plakut:

— Lajmëro në ministri: veturën të mos e nisin, se po shkoj me autobus. Më pëlqen udhëtimi me njerëzit e thjeshtë, me popullin.

— Si?! — i tha plakut i habitur dhe i hutuar.

Ai nuk priti përgjigjen e plakut, por hoqi kokën nga dritarja e i tha shoferit me ton urdhërues:

— Nise.

— Nise, — vazhdoi një zë tjetër.

— Nise, nise, nise, — u dëgjuan zëra të tjerë të shpërndarë dhe të çrregullt.

I pari që deshi të shuante këtë kuriozitet ishte njeriu i ulur pranë tij, një djalosh i shkurtër, tërë muskuj, me ca sy larushë, veshur me një xhakavento bojë portokalli, që pyeti:

— Ku punoni?

Tjetri bëri me dorë diçka të paqartë, po nuk foli.

Kureshtarët u shtuan edhe më shumë. Pas tij ishin ulur profesori i Institutit të Restaurimit të Monumenteve, Tako Kerçi, me asistentin e tij, Qenan Qenanin.

Derisa autobusi mori rrugën mirë dhe fitoi shpejtësinë mbi asfaltin, që shkëlqente nga rrezet e diellit të mëngjesit, udhëtarët mbetën në heshtje. Pastaj bisedat filluan dalëngadalë të shtoheshin.

Profesori Tako Kerçi kishte muhabetin e tij. Ai i tha asistentit:

— Restaurimi i ikonës së shën Kozmait nuk ka vlerë fetare, por vlerë arti.

— Domosdo, — u hodh papritur njeriu me xhakaven-  
to portokalli që rrinte para tyre.

Biseda mori zjarr. U harrua kometa Hallej dhe tani në-  
për gojët e njerëzve vërtitej shën Kozmai, ç'vlerë do të  
kishte kjo ikonë? ... Profesori nëpërmjet ikonës së shën  
Kozmait mendohej të shpjegonte vlerat e piktorit si artist  
i madh. Njeriu me rroba bojë qielli hapi gojën:

— Një artist i madh bën art të madh, — tha.

Fjalët e tij e bënë edhe më enigmatik në sytë e të tje-  
rëve që ishin rrotull e, sidomos, të atij që kishte pranë.  
Mirëpo biseda u ndërpre, sepse nga fundi i autobusit u  
ndie një gërnetë, pastaj një palë saze ia morën këngës:

*Çezmë e bardhë karshi fshatit,  
tre qostekë të sahatit.*

— Iso, more, iso!

Në autobus u harrua kometa, ikona e shën Kozmait  
dhe njeriu me rroba bojë qielli.

\* \* \*

Kënga vazhdonte shtruar, por ja që s'donte autobusi  
të ecte shtruar. Ai filloi të bënte naze. Shoferi, si për t'i  
ardhur pas avazit makinës e jo sazexhinjve, e ndaloi dy-  
-tri herë. Mirëpo, kur një udhëtar tha se s'qenka gjë ky  
autobus, shoferi u nxeh e iu përgjigj tërë inat:

— Autobusit tim i marrsh të keqen. Unë do t'ju shpie  
shëndoshë si molla:

Sazexhinjtë e dëgjuan dhe i kthyen përgjigje me saze  
e me këngë:

*Faqekuqe porsi molla,  
nazike moj, belholla,*

— Iso, more, iso!

Autobusi qëndroi para një dyqani. Kënga pushoi dhe u dëgjua shoferi që nga timoni i foli me zë të lartë shitësit, atje brenda, prapa banakut:

— A ke piper të kuq?

— Kam, kam, — erdhi përgjigja.

— Më sill një kartë, — urdhëroi shoferi.

Sazexhinjtë ishin gati:

*Moj dasma që do piper,  
moj dasma.*

Mirëpo prapë kënga u pre. Këtë radhë udhëtarët u shtangën nga habia. Shoferi, pasi kishte marrë piperin, hapi kapakun e radioatorit dhe e hodhi brenda.

— Po loz mendsh, — tha profesori, kur pa këtë skenë.

— Makina po ha piper, — tha djaloshi që ishte pranë atij me rroba bojë qielli.

— Edhe ha, — tha tjetri i qetë.

Shoferi nuk u vuri veshin fjalëve dhe romuzeve, po shtrëngoi kapakun e radiatorit, ndërroi marshet dhe autobusi u lëshua me të katra përpara sikur t'i digjte piperi i kuq.

Gjindja u bë kurioze. Pas një cope udhe shoferi ndaloj autobusin, u ngrit në këmbë, ktheu kokën prapa e sqaroi gjindjen:

— Piperin nuk ia hodha autobusit për t'i dhënë shije, po për t'i zënë vrimat radiatorit të shpuar.

— Domethënë e ktheve piperin në kallaj, — tha rëndshëm njeriu me rroba bojë qielli.

— Alkimi, — i vuri kapakun profesori.

— Bëni 15 minuta pushim sa të pini një cigare jashtë, — shtoi shoferi.

Njerëzit dolën në rrugë dhe ndenjën apo filluan të shëtisnin secili pas qejfit të tij. Kureshtar dhe llafazan

djaloshi me xhakavento portokalli nuk iu nda këmba-këmbës atij me rroba bojë qielli, i cili, sa zbriti nga autobusi, po ecte me vrap drejt një lëndine.

— Ku shkoni, shoku?...

— Të mbledh lule!

— Shumë bukur, shumë bukur, — tha tjetri duke e ndjekur pas.

— Nevojat fiziologjike nuk kryhen në grup, — iu përgjigj ai me ironi.

\* \* \*

Kur u kthyen nga lëndina, njeriu me rroba bojë qielli dhe djaloshi me xhakavento portokalli shëtisnin e flisnin bashkë si të ishin shokë të vjetër.

— Ku punoni? — pyeti portokalliu.

— Merrem me studime, — tha bojëqielli.

— Në cilën fushë?

— Aktualisht kryetar i ekspeditës së Akademisë së Shkencave për të studiuar folklorin për kometën Hallej.

— Shumë bukur, shumë bukur!...

Ndoshta në fillim njeriu me rroba bojë qielli i tha me shaka këto fjalë, siç i erdhën ndër mend. Por ato u dëgjuan dhe u miratuan me entuziazëm nga tjetri. Në të vërtetë ai do të merrej me ca studime të tjera. Ai shkonte të gjente një kushëri të babait që nuk dihej në ishte shqetësuar apo jo për katastrofën që mund t'i sillte Tokës kometa Hallej, apo të kishte dëgjuar ndonjë këngë a bejte për të.

Studimet e tij të posaçme i kishte bërë në një sënduk në familjen e tij. Ashtu si kometa që iu afrua Tokës 174 milionë kilometra dhe pastaj ndërroi drejtim, po ashtu, në drejtim të kushëririt të babait, ishte dukur në horizont një trashëgimi enigmatike jashtë shtetit. Ajo i ishte afruar kushëririt (nuk dihet në çfarë distance) dhe pastaj kishte ndërruar drejtim e ishte zhdukur kushedi ku në rruzullin tokësor.



## Kreu i parë



### QYTETI ME KATËR PORTA

Asnjërit prej udhëtarëve të autobusit nuk i shkonte ndër mend se ai njeriu që u ra në sy menjëherë ishte nisur drejt «Qytetit me katër porta».

Ku bie ky «Qyteti me katër porta»?

Për këtë mund t'ju sqarojë vetëm njeriu me kostum bojë qielli dhe me syze të errëta. Madje edhe ai nuk e dinte dhe as i kishte shkuar ndonjëherë ndër mend se ekzistoka një qytet i tillë. Po një ditë më parë, kur po kërkonte nëpër ca sëndyqe mos gjente ndonjë pare, në fund të njërit, brenda në një kapelë republikë si ato të kaubojve, të mbështjellë me një gazetë, gjeti një tok kartëmone-dhash të reja. Për kapelën republikë kishte dëgjuar një hi-

stori të çuditshme. Atë e kishte sjellë stërgjyshi i tij kur që kthyer nga Argjentina plot me shkrepëse që ndizeshin në mur, në gur e kudo që t'i fërkoje. Kjo ishte e vetmja pasuri që pati prurë, por që kishte çuditur fshatin.

Kartëmonedhat ishin të reja, por ato ishin mbështjellë me një gazetë të vjetër. Si për të gjetur të fshehtat e tjera të kapelës e të këtyre të hollave, ai hapi copën e gazetës dhe i ra në sy në krye të saj një titull me germa të mëdha «Qyteti me katër porta». Titulli e tërhoqi, po u bë edhe kureshtar nga shkrimi. Në një copë të faqes së gazetës ai lexoi këtë shënim: *Lexuesi të na falë se mungon germa e 28 e alfabetit; të cilën po e zëvendësojmë me germën f.* Ai e lexoi për kureshtje fejtonin.

«Në qyfehin fonë kemi një drejfor me mendje femër, me një fjalë që i pjelë, — shkruante autori. — Ky është drejfori i komunales, Alush Panajaja.»

— Hëm! — tha i çuditur Llajni. — Paska shkruar për tim atë.

«Ky shoku Alush ka shumë punë, po ai ndërmjef punëve di fë zgjedhë më kryesoren: Qyfehi ka kanale që duhen rregulluar, ka balfra që duhen pasfraur, por ama qyfehi ç'u mor vesh që ëshfë qyfef kur s'di nga hyn e nga del. Prandaj Alushi një difë mendoi e urdhëroi që në kafër hyrjet e qyfefit fë bëhef nga një porfë me harqe befoni.

— Mos na thonë që e bëmë qyfehin si hanin me kafër porfa, — i thanë shokuf Alush nja dy punëtorë.

Alushi i zemëruar u tha se nuk merrnin vesh nga modernizimi, se ngrifja e kafër porfave do fa bënfe qyfehin më fë bukur, më serioz dhe më fë njohur në syfë e udhëfarëve që kalojnë këfyre anëve...»

Ai lexonte artikullin dhe qeshte me vete. Ç'është ky lloj shkrimi?! Mos vallë është në gjuhën sanskrite?

«U bënë porfaf, mirëpo qyfehi rrifej përdifë e fani mund fë fhuhef jo qyfehi me kafër porfa, por kafër porfaf në mes të qyfefit. Në këfë qyfef po bëhef një sfadium. Mi-

rëpo ka njerëz që mendojnë se edhe sfadiumi mund të vihef mbi rrofa e fa çojnë ku të duan. Kjo do të ishfe më e mira e të mirave të punës. Sepse, ku fa kërkonin inferesaf e fitozëve sfadiumin mund fa çonin rrofaf, jo fondet e shfëfif. Po ç'hyjnë fondet? Hyjnë, si s'hyjnë. Në fillim fhanë të ngrenë një sfadium nga lindja e qyfefif, afër porfës së parë. U bënë punime. U hap fusha e filloi të rrefhohef me mure. Kur u prishën një fok me para e prifej që të prifej shirifi i inaugurimif, na vjen një urdhër fjetër e fhofë se në vendin e sfadiumif do të ngrihej fabrika e miellif. Sfadiumi, fhanë, duhef të bëhef jo në lindje po në perëndim të qyfefif. Dhe sfadiumi filloi të ndërfohej në perëndim të qyfefif. U ndërftua bukur, mirëpo që në ndeshjen e parë të futbollif u pa se si do të dilfte jashfë përdorimi. Pranë ishfe mafernifefi.

— Grafë vijnë në mafernifef për të pjellë, jo për të dëshfuar, — fhërrisfe i skandalizuar dokfor Fhanasi. Sa u bë goli i parë në sfadiumin e ri, fitozëf fhërrisnin sa u mbanfe zëri.

— Nuk shkon dëm, — fhanë. — Në maternifef lindin fëmijëf. Këfu pranë bëjmë një park lodrash për fëmijë. Me një fjalë, afje lindin, këfu argëfohen. S'ka më mirë, Bëhef një proces zinxhir.

Fani fhonë se në qyfefin me kafër porfa në mes, do të ndërfojmë një sfadium të ri. Kur, nuk dihef. Veç në komifef po parashikohen fërë fondet. Në qyfef fani po merren me një problem fjetër. Po ndërfohef unaza, por edhe kjo mbefi përgjysmë, sepse u ndërrua kryefari dhe, ky i riu që erdhi, njeri i apasionuar pas bujqësisë, vuri duarf në kokë, kur bëri llogarifë se sa fokë buke hanfe unaza. Në ca vende ku ishfe hapur ajo u fufën frakforët dhe u mboll foka, po ja që kryefari i parë u kfhye prapë dhe prapë puna e unazës u vu në «vijë».

«Qytet interesant, — tha Llajni me vete, — një vizitë këtu do të jetë e përshtatshme për mua.»

Pa me vërejtje copën e gazetës, po ajo s'kishte as datë, as emër. Lljani nuk mundi ta merrte me mend se ky fejtton ishte botuar para daljes së tij në dritë, d.m.th. rreth një çerek shekulli më parë. Megjithatë Lljani e mori vesh se ky Alush nuk ishte i ati por i kushëriri. Të dy kushërinjtë kishin një emër e domosdo edhe një mbiemër.

Në këtë copë gazetë, që ishte shkruar pa gërmën t, sepse i mungonte shtypshkronjës, dhe flitej me ironi për një kushëririn e fisit të tyre, ishin edhe ca letra ku ai bëri zbulimin. Ishin tri letra përgjigje drejtuar të atit, ku kushëriri me të parën i thosh se ishin mirë me shëndet e vazhdonte: «Për sa më pyesje për trashëgiminë, gjer më sot s'kam marrë ndonjë haber. Sido që të jetë, siç thamë, atje ka për mua edhe për ty.»

Letra e dytë forconte shpresat e së parës, ndërsa e treta i tregonte të humbura shpresat.

«Rroftë Shoqëria Komisioneria, — tha ai me vete kur mbaroi leximin. — Nuk thonë kot që çdo e keqe ka edhe një të mirë. Vërtet s'mora asnjë provim në Universitet, po gjeta një pasuri. Unë nuk po nisem».

## MIDIS ALEATEVE TË KLASËS PUNËTORE

Nuk ishte e thënë që atë ditë ku studiues të arrinte në qytetin me katër porta, sepse gjatë rrugës u bënë shokë të ngushtë me udhëtarin që rrinte pranë tij. Ata u miqësuan shumë shpejt, sikur të ishin njohur prej vitesh, prandaj udhëtari i tha me domosdo të qëndronte me të në fshatin Mazrekë e ta nderonte me pjesëmarrjen e tij në dasmën e kushëririt.

Studiuesi pranoi me gjithë qejf. Zbritën të dy nga autobusi në mes të fshatit dhe u nisën për në shtëpinë ku bëhej dasma.

Siç është zakon, madje, që të jemi të saktë, duhet thënë siç është bërë mani, të zotët e dasmës, sa më shumë njerëz t'u venë, aq më shumë e kanë për mburrje dhe, sidomos kur këta që u venë janë nga larg, pale kur janë nga kryeqyteti. Ndërsa në rastin konkret ky ishte jo një mysafir sido kudo po një studiues i kometës Hallej.

— Aleatët e klasës punëtore i kanë qejf shokët e tyre, prandaj edhe i presin me krahë hapur, — i tha i kushëriri i dhëndrit mysafirit të nderuar.

— Si ta merr mendja, byrazer? — e pyeti tjetri kushëririn e dhëndrit. — A e bëjnë dot aleatët e klasës punëtore dasmën me forcat e veta.

— Për artikuj ushqimorë, po, — vazhdoi sqarimet kushëriri i dhëndrit, — ndërsa për artikuj industrialë, jo.

— Qënke njohës i madh në fushën e merceologjisë ti, byrazer, — i tha për t'ia bërë qejfin.

— Në punishten e pastave, ku unë jap ndihmesën time, — sqaroi i kushëriri i dhëndrit, — kemi një përgjegjës që ka dhënë merceologji në fakultet, por e kanë sjellë te ne për forcimin e punës. Ai na griu duke na mbajtur leksione, por, ama, unë jam më i dalluari i të dalluarve, në përvetësimin e tyre, sa ja, edhe këtu, në mes të fshatit, mund të t'i mbaja jo ty, por tërë aleatëve të klasës punëtore, leksionet e merceologjisë. Por ç'e do, se kam një të keqe të vogël: nuk mbaj mend asnjë fjalë.

\* \* \*

Ata u futën në shtëpinë e dhëndrit dhe i kushëriri u prezantoi mysafirin e nderuar.

— Shoku, — tha ai me mburrje, — është një miku im i ngushtë.

— Pi ka të kemi, or mik? — e pyeti babai i dhëndërit.

— Nga Tirana, — nxitoi të thoshte nipi.

— Bre! — tha babai i dhëndërit. — Po i kujt je pi Tirane?

— I shokut X..., — tha mysafiri dhe, si për të mos e zgjatur bisedën më tej, kaloi përmes dhomës e vajti te dritarja për të soditur natyrën.

— Si e quajnë mikun tënd të ngushtë pi Tirane? — pyeti xhaxhai nipin.

Këtu nipi u zu ngushtë, po doli nga gjendja e tha:

— King, e thërresim ne.

— E paçim me ymër shokun qingj, — tha plaku.

Llajni soditi një copë herë nga dritarja natyrën e bukur të fshatit, e kur u kthye nga të zotët e shtëpisë, tha:

— Ky fshati juaj më kujtoi një fshat të bukur në Holandë.

— Bre! — tha plaku.

— Eh, kujtime, kujtime! — vazhdoi Llajni.

Ndërkohë, një djalë, me një tabaka me gota rakie, i ishte afruar mysafirit. Ai mori gotën e tha:

— E po, gëzuar. Holandën e kemi këtu.

Ata përpoqën gotat. Kushëriri i dhëndërit, si për t'i bërë më shumë qejfin mysafirit e për t'ia konfirmuar emrin që i ngjiti, u përgjigj:

— Gëzuar, shoku King!

Gotat u përpoqën. Mysafiri e piu me fund. Ndezi cigaren e filloi të nxjerrë nga goja rrathë tymi. Pastaj ëndërrimtar, tepër i prekur e i mallëngjyer, sa gati u përlot, tha me drithma zëri:

— Kur ishim të vegjël, këndonim një këngë:

*Atje n'Holandë në vendin e mullinjve,  
eh, o tempera, o mores!<sup>1)</sup>*

1) lat. — O kohëra, o kujtime!

\* \* \*

**O PASHA, O TUNGJATJETA,  
ME NGADALË ATO TRUMPETA.**

Mysafiri nga Tirana nxori nga çanta e tij një qese najloni mbi të cilën ishte stampuar një reklamë cigresh. Nën të, me gërma të forta, shkruhej anglisht: «Pini Dunhill dhe do mbeteni të kënaqur», «Dunhill pinë kozmonautët». Ai e mori në dorë qesen laramane dhe ia dorëzoi të zotit të dasmës:

— Ishte e papritur ardhja ime në këtë gëzimin tuaj të madh. Po kjo çantë është simbol i miqësisë sonë. E kam blerë në Holandë dhe është modeli i fundit. Tani po jua dorëzoi bosh, po peshqeshet që do të mbajë brenda ajo, vijnë menjëherë pas kthimit tim në Tiranë.

I zoti i dasmës, pasi falënderoi për peshqeshin e vyer, në shenjë nderimi, shkoi dhe e vendosi qesen mbi pajën që kishte sjellë nusja. Ca dasmorë kureshtarë u afruan dhe e panë qesen me gërmat e mëdha e lara-lara nga ngjyrat, ku, mbi të gjitha, të binte në sy një cigare duke tymosur.

\* \* \*

Në shtatë konakë dhe me dy palë saze filloi dasma. Nusja me dhëndrin u shpunë në dhomën e mysafirëve më të nderuar. Po, midis më të nderuarve, domosdo, u nderua miku nga Tirana. Ai ndenji në të djathtë të dhëndrit. Prandaj edhe shumë herë sytë e dasmorëve përqendroheshin tek ai.

51400

Me shtatin e tij të lartë, me rrobat bojë qielli dhe syzet e errëta dukej i gëzuar, por edhe autoritar. Kur filluan dollitë dhe i erdhi radha atij, ai e shpuri dollinë me 101 shëndete. Ndër të parët që u bënë viktimë e shëndeteve të tij ishin dhëndri dhe dy vjehrrit: ai i nuses dhe i djalit.

I pari ra nën tavolinë vjehrrit i nuses. Vjehrrit i djalit qau një copë herë mbi krushkun duke folur me zë pak mallëngjyes:

— Obobo, mor krushku im, që s'të dija kaq të dobët në raki!

Krushku, si ndenji një copë herë gjysmë i rrëzuar nën tavolinë, papritur u ngrit e filloi të mbante një fjalim. Nuk i merrej vesh ç'thoshte, se fjalët i shqiptonte pa zanore, por edhe sazet e zallamahia tjetër e mbytnin zërin e tij. Pas vjehrrit të nuses ra nën tavolinë vjehrrit i dhëndrit. Duke lëshuar veten poshtë, u dëgjua një thirrje e tij në formë lutjeje:

— Ma bëj hallall, or miku i Tiranës!

Llajni filloi të merrej me dhëndrin. Ngritën nga pesë shëndete me fund për nusen, por të gjashtin dhëndri nuk arriti dot, se zbriti të takonte të atin nën tavolinë për t'i thënë se mysafirin nga Tirana po e nderonin si duhet.

Në këtë gurgule të madhe, erdhën në dhomë nja katër nipër të kësaj shtëpie dhe, për ta nderuar mysafirin nga Tirana, ashtu siç e kishte merak xhaxhai i tyre, e bombarduan me shëndete.

Llajni i pinte gotat një-rën pas tjetrës, po në sytë e djemve të rinj mbahej i fortë. Ai dukej krejt esëll. Vetëm kravata dhe këmisha i ishin lagur si të ishin futur në një kazan rakië.

Njëri nga kushërinjtë e dhëndrit solli dy gota uji me raki e i tha mysafirit të nderuar:

— Këto, ne të dy, do t'i pimë me fund për shëndetin tuaj!



— T'i pimë, — tha Llajni dhe, duke marrë gotën në dorë, i kryqëzuan krahët me njëri-tjetrin. Po kur i afruan të dy te goja, mysafiri e detyroi tjetrin t'i ndërronin ato dhe, sa e mori tjetrën, e piu me fund. Mirëpo gota që piu Llajni ishte me ujë. I ngopur me ujë, Llajni e detyroi tjetrin ta pinte edhe ai me fund. Tjetri më shumë nga turpi sesa nga dëshira, nuk e zgjati, se i doli hilja në shesh. Pasi e piu, fshiu buzët, u mbajt edhe një copë herë në këmbë, por, pas disa çastesh duke u lëkundur, u plas në mes të dhomës. Mirëpo nipërit e tjerë u hodhën në sulm më me furi. Amaneti i xhaxhait duhej çuar gjer në fund. Mysafirit të nderuar duhet t'i bëheshin të gjitha nderet që ta mbanin mend dasmorët, ta mbante mend edhe ai dasmën e Mazrekës.

Njëri nga djemtë tha:

— Tani vijnë forcat e Ganefos.

Llajni e dëgjoji dhe u përgjigj:

— Le të vijnë!

Nga dera hyri me ca lëvizje mëngjëroshe një burrë i shkurtër çalaman, murrash nga flokët dhe me një sy. Ky ishte përgjegjësi i punishtes së rakisë.

— Ky është Ganefua? — qeshi Llajni.

— Po, po, — u dëgjuan zëra.

— Midis shokut në fjalë dhe Ganefos ka një lidhje të ngushtë: të dy qendrën e kanë në Azi. Ky për mua është Timurlengu.

— Kot e nget atë brazdë, — tha i porsaardhuri.

Njerëzit që ishin rreth e rrotull qeshën. Shoku përgjigjës i punishtes së rakisë, i mbiquajtur nga mysafiri i nderuar Timurleng, në çast kishte afruar gotën e rakisë pranë fytyrës së Llajnit dhe ia bënte bromp.

\* \* \*

Llajni u ngrit e, me një vështrim nënvetullor, filloi të mbante një fjalim:

— Vëllezër dasmorë!

Jam tepër i emocionuar që ndodhem në gjirin tuaj. Kur zbresim në bazë, ne marrim vesh ç'është jeta.

— Bjeru druve shkurt, — thirri një dasmor.

Ai u hutua, iu morën mendtë, por, si për të kundërshtuar këtë turbullim të sistemit nervor, futi në përdorim kamaren e gojës:

— Sa budallaqe janë mendtë. Ato janë zemëruar me mua dhe kërkojnë të ikin. E ku të venë?! Ja, ta zëmë se dolën, po ju, vëllezër krushq, përse jeni këtu? Kot? Forca juaj, vëllezër dasmorë, është e tillë sa, jo mendtë e mia s'i lini të dalin jashtë, por asnjë mizë s'mund të bëjë as gëk as mëk... Si thashë... kur zbresim në bazë, ne marrim vesh ç'është jeta.

Dukej se fliste me shpirt të nakatosur. Pushoi disa çaste sikur të mblidhte mendtë e shpërndara, po papritur mori inat e vazhdoi me tërsëllim:

— Po unë s'pyes për jetën. Jam gati ta jap që tani, të bëhem fli i kësaj dasme, i këtij dhëndri azgan e i kësaj nuseje gjeraqinë.

Si përgjigje të oratorisë së tij, të frymëzuar në burimet e kazanëve të rakisë, nja dy lebër ia morën këngës:

*O pasha, o tungjatjeta,  
me ngadalë ato trumpeta...*

— Iso, more, iso, — thirri Llajni që harroi fjalimin e filloi të bënte: E e e...!

Lebërit vazhdonin këngën:

*Me ngadalë ato trumpeta,  
se këtu është Gjoleka,  
të pret e të bën feta,  
të var lisave në dega.*

— Gjoleka! — thirri Llajni — Po ai është daja i gjithit tim.

Lebërit vazhdonin këngën:

*O pasha, o tungjatjeta...*

.....

\* \* \*

— Vëllezër! — vazhdoi Llajni duke filozofuar. — Ç'është jeta? Ja, po jua them unë. Mbrëmë drejt Tokës sonë mëmë vinte me shpejtësi kometa. Vinte, posi... Iu afrua tokës 174 milionë kilometra. Por... por ajo u bë pishman e nuk i ra Tokës, u kthye prapë. Në këto çaste që ajo udhëton nëpër kozmosin pa anë e fund, unë ndodhem në gjirin tuaj, në dasmën tuaj të nderuar.

I mbiquajturi Timurleng, çakërrqejf, tha me zë të lartë:

— Fjala jote është një jehonë buçimtare. Ne, i dashur mik, më fal se s'ta di as emrin, që do të të ruajmë si kujtimin më të shtrentjë. Nuk ka parë Mazreka orator më të madh. Si e ke emrin?

— King, — thirri kushëriri i dhëndrit.

Llajni deshi të fliste, po s'foli. Ai lëshoi vetëm një «hëm».

— I dashur King-Kong, — vazhdoi përgjegjësi i punishtes së rakisë, — ne jemi shumë të gëzuar dhe, në këto caste, duke dashur të të quajmë mysafirin më të nderuar, mund të themi me plot gojën se dasmën tonë po e nderon si i deleguar i kometës Hallej.

— Timurleng, mos bëj shaka me mua!

— Kjo nuk është shaka, por nderim, — e kundërshtoi ai.

— Atëherë, meqë m'u dha rasti, po ju njoftoj në këtë dasmë se gëzimi është i dyfishtë. Hallej, që është një ndër një mijë e ca kometat më të dalluara, sikur t'i kishte rënë Tokës, këtu s'do të kishte dasmë. Prandaj. . .

— A ka vallë jetë në kometën Hallej? — pyeti kushëriri i dhëndrit.

— Ç'qënrim vallë mban kjo kometa? — pyeti një dasmor xurxull.

Përgjegjësi i punishtes së rakisë qeshi me sa zë që kishte. Llajni u nxeh pak nga kjo qeshje, por nuk e humbi toruan e vazhdoi:

— Sa për pyetjen që bën ti, gjykimhumbur, a ka jetë në kometën Hallej, më mirë se kushdo mund të përgjigjet Timurlengu, sepse ai ka të bëjë me avuj. Bile duhet thënë, — vazhdoi ai, — e shihni këtë gotë me raki? Gjersa rrushi të bëhet raki, atje në kazanët e bekuar të Timurlengut, shndërrohet në një lloj komete që nuk i bie Tokës, po kokës. Në këtë rast unë i bie gotës së Timurlengut.

— Fjala alkool, — vazhdoi Llajni, — vjen nga arabishtja, që do të thotë gjë e lehtë, e paktë, delikate. Në shekullin e 19 alkimisti nga Firencja, Todeo Alderoti, e quajti «akua ardens», që do të thotë ujë që digjet. Venedikasit e filluan të parët industrializimin e tij, ndërsa Timurlengu mund të quhet industrialisti më i madh i rakisë në Mezrekën e shekullit të 20.

Ata të dy përpoqën gotat dhe i pinë me fund.

— Po t'i binte kometa Tokës, — tha Tirmurlengu, du-

ke fshirë buzët, — avujt e saj do t'i ktheja në raki, këtu në punishten e Mazrekës.

Edhe një copë herë ata të dy vazhduan të këmbenin replika me njëri-tjetrin, pastaj, dalëngadalë fjalët u humbën. Ata merreshin vesh me shenja.

Dasma ishte në kulmin e saj.

## ESE PËR DASMAT

Sido që të bëhen dasmat, të gjithë njerëzit nuk mbe-  
ten të kënaqur. Madje ato, nga një gëzim, po kthehen në  
një mani. Tërë çështja shtrohet se kush e kush të mbu-  
rret më shumë me dasmën që bën.

Ishte një kohë që, në dasma, si peshqeshe, vërsho-  
nin enë alumini, tenxhere, tepsi. I zoti i dasmës, sipas  
sasisë së mysafirëve që ftonte, mund të hapte një dyqan  
«Enë kuzhine». Por, meqë më vonë industria jonë përparoi,  
tok me të përparoi edhe zgjedhja e peshqesheve. I zoti i  
dasmës mund të hapte një dyqan me «Prodhime qelqi». Pa-  
staj doli moda e drurit, pra i zoti i dasmës mund të hapte  
një dyqan me «Prodhime artistike», ku, mbi të gjitha, mund  
të binin në sy bucelat ose kupacët. Arriti një kohë që, bre-  
nda një viti, e njëjta bucelë mund të qarkullonte në dhjetë  
dasma, madje ka ndodhur të kthehet tek i zoti që e bleu  
i pari.

Mirëpo, ashtu si kaloi koha e aluminit dhe e qelqit,  
kaloi edhe koha e drurit. Ajo u zëvendësua me atë të she-  
qerit. Nëpër dasma vërshuan ëmbëlsirat, vendin e parë të  
të cilave e zinin pastat, tortat, po sidomos kutitë e lloku-

meve. Këto, të fundit, ndryshe nga ëmbëlsirat e tjera, kishin një vlerë praktike e me leverdi. Kutitë e llokumeve bliheshin të shtunën në dyqan e ktheheshin të hënën. Dasmorët, apo edhe kategoria më e lartë e tyre, krushqit, e panë se edhe ky lloj peshqeshi po demodohej, prandaj praktika i mësoi që peshqeshet në natyrë të konvertohen në një lloj tjetër që s'ish as pastë, as tortë, as llokume, po një letër mbi të cilën, me gërma që dalloheshin qartë, lexohej: «I paguhen prurësit më të parë.» Nga shifrat që përmbante kjo letër varej edhe bilanci i dasmës, i cili mund të ishte negativ apo edhe pozitiv. Në rezultatet për të pasur një bilanc sa më pozitiv preferohet sidomos shifra 100. I zoti i dasmës, më shumë se sytë e të ftuarve, sheh zerot që përmban letra. Është i vetmi përjashtim ku dy zerot shihen me një ndjenjë simpatie.

\* \* \*

Megjithëse dasma sot nuk vazhdon një javë, po me ato ditë që bëhet ajo hyn në fryrje të panevojshme, në rëndime shpenzimesh. Sikur ta paraqitnim në një formë tjetër atë që ngjet natën e dasmës ose më mirë të themi të darkës, do të kishim një pamje të tillë:

Shpenzimet e dasmës janë aty-aty me pajisjen moderne të një apartamenti të ri për çiftin. Mirëpo dasmorët brenda disa orëve hanë krevatin, dyshekun, jorganin, u futen garderobës, qilimit, pasqyrave, madje ka nga ata dasmorë që nga mëngjesi duan të pinë e të hanë edhe komodinën e fundit, në mos edhe kremstarët. Dhe zakoni i ri

do që tavolinat që janë plot pa filluar darka, të mbeten po plot kur mbaron ajo, paçka se u hëngër e u pi pajisja e një apartamenti.

Megjithatë as në dasmën e Mazrekës dhe as në çdo dasmë tjetër të gjithë s'mbetën të kënaqur. Autori, i kënaqur dhe i pakënaqur nga dasmat, e pa të udhës t'u tregojë një lloj tjetër dasme ku prapë njerëzit s'mbeten të gjithë të kënaqur.

## A F O R I Z E M

Famija Mandrikulli, burrë dhe grua, të dy shitës solidarë zarzavatesh, ndodheshin para një gëzimi të madh: do të martonin të vetmin trashëgimtar që patën lindur pas shumë mundimesh, kurimesh dhe mjekimesh, që nga ato më populloret, deri te më shkencoret. Sido që fëmija lindi shtatanik, ai u zhvillua, u rrit, bile edhe pse mbeti pak nën shtatin mesatar të njeriut, i mbahej pak goja e nuk shqiptonte dot gjërmën «sh», shkollën e vazhdoi, e mbaroi jo me më pak mundime sesa hoqën prindërit për daljen e tij në jetë.

Çifti Mandrikulli në prag të dasmës lanë dyqanin dhe morën librezën e pensionit në xhep, ndërsa pjella e tyre, Serafimi, me diplomën në zyrën e kuadrit të institutit numër 13, ëndrrën e tyre po e kurorëzonte me sukses. Përpjekjet e tyre për gjetjen e nuses e dhanë frytin. Femra që do të bëhej nuse në shtëpinë Mandrikulli ishte e re, e njomë, e bukur, me prindër e farefis të gjerë, po me një cen fare të vogël që s'para i binte në sy njeriu: kapakun e syrit

të djathtë e kishte pak më të lëshuar mbi sy dhe qerpikët i kishte të bardhë. Ky cen i vogël, kur e vështroje me vëmendje, i jepte disi një pamje komike, si të atij njeriu që të shkel syrin kur do të thotë për tjetrin «lëre me të tijën se, kur u ndanë, kaq i ranë».

Edhe nga çifti Mandrikulli nusja shihej me dy lloje sysh:

Gruaja thoshte:

— Paçin këmbën e mbarë e me fat, se për vete mar-tohen. Unë, ja ku e kam bandillin tim.

Dhe, duke vështruar të shoqin, mundohej të buzëqesh-te. Por pamja e saj nursëze nuk e linte buzëqeshjen të shpërndahej në fytyrë, prandaj ajo i shndërrohej në një-farë skërmitjeje.

Ndërsa burri, duke marrë shkas nga buzëskërmitja e së shoqes, me një maçokëri shtonte:

— Hm! Fati! Ja ku është fati, — dhe tregonte barkun e tij rrumbullak, — ky, ky është fati i insanit. Sa më shumë pjellor të jetë ky, aq më shumë shtohet bota. Po nu-sen e kam të mirë, shakaxheshë të madhe. Se shakaja është shëndet, është gëzim. Për të qarë qajnë edhe kafshët, por për të qeshur ke parë ti kafshë të qeshë?! Jo! As ke për të parë kurrën e kurrës.

Me këtë gëzim e me këto muhabete, u afrua dita e dasmës.

— Do të bëjmë një dasmë që s'e ka bërë kush, — tha e zonja e shtëpisë. Një jetë të tërë kemi punuar. Një djalë kemi. Një herë e martojmë.

— Do ta bëjmë që ç'ke me të, — vazhdoi bisedën i zoti i shtëpisë. — Jo ta marrë vesh qyteti, por edhe tërë mileti, me kuç e me maç.

— Darkë allosoj, — i tha një natë e shoqja.

— Darkë the?! — dhe i shoqi qeshi me vete.

Ai bluante në kokë ca veprime të çuditshme, po nuk i shfaqte që të bënte mat shterpësinë e mendjes të së sho-



ges. Mendja e tij kishte shkuar aq tutje në çështjet e dasmave, sa, kur të vinte nusja në shtëpi, nga tarraca e ndërtesës ku banonte do të hidhte fishekzjarrë. I pëlqeu kjo ide, e joshi në fillim, megjithatë prapë kishte një si frikë, se mos gjente belanë me policinë. Ç'ishin këta fishekzjarrë që shpërthenin krejt papritur nga ndërtesa 74, e cila njihet në tërë lagjen për harmoninë dhe mirëkuptimin e banorëve të saj?! Megjithatë, për t'iu mburrur së shoqes në prag të dasmës, ia hapi çudinë.

— Kur të futë nusja këmbën e djathtë në shtëpi, do të hedh fishekzjarrë nga tarraca.

— Fishekzjarrë?! — pyeti e habitur e shoqja.

— E, fishekzjarrë, ç'ka këtu për t'u habitur?

— Dashke ti që të na pllakosin zjarrfikësit me pompat e ujit?

— Durim, — tha i shoqi. — Përse i kemi miqtë. U themi këtu-këtu dhe, fap, i ndezim fishekzjarrët.

— Më mirë i hedhim brenda, — nxitoi t'ia ulte zërin e shoqja, e frikësuar nga kokëkrisuria e burrit të saj, që kishte marrë një yrysh të papërmbajtur.

— Brenda?! — qeshi i shoqi. — Dashke që të bëhet batërdia, të digjemi e të përvëlohemi! Të marrin zjarr fustanet e krushkave, apo s'janë prej teritali, që, sa t'u bjerë një shkëndijë, të mbeten gollomesh.

— E po, të bëj ty truroitur një pyetkë, si ta bëjmë, o sevdalliu i marrosur.

— Sill ndër mend ditën e dasmës sonë, moj e uruar, — tha ai. — E mban mend kur shkuam në fshat e gjyshi im e bëri tavanin e dhomës shoshë nga plumbat?

— Qenë kohë të tjera, more mynxyrëmadh, — tha e shoqja. — Po jo sot në mes të qytetit bam-bum.

— Hm, Bam-bum! Bam-bum! — vazhdoi i shoqi, duke qeshur me vete. — Fishekzjarrët i kam blerë me kohë dhe i kam ruajtur për këtë ditë. Dasmë e madhe pa një bam-bum s'bëhet.

— E di si them unë? U japim krushqve që do të na vij-  
në për darkë nga një peshqesh. Kjo do të mbahet mend.

— Hm! Peshqeshe krushqve që do të na hanë darkën?  
E ku është parë kjo gjë?

— Po se s'është parë, prandaj ta bëjmë ne!

— Mendjefemër ke, moj grua, — tha i shoqi si me  
ironi.

E shoqja mori hov nga fjalët e tij dhe vazhdoi më  
tutje:

— O kapedani im! Unë them se, që të bëhet një dasmë  
e padëgjuar, në ftesë të shënojmë që s'pranojmë asnjë pesh-  
qesh. A është bërë ndonjë dasmë kështu?

— Hm! — tha i shoqi, disi i habitur. — Hm! Mede-  
mek asnjë peshqesh! Medemek thatë!

Debati i çiftit Mandrikulli për rrugët e pashkelura në  
lëmin e dasmave mori zjarr.

— Një gjë e paparë më erdhi në kokë, — tha e shoqja.  
— Krushqve, sa janë ata 10-15 veta, t'u japim në zarf një  
kartëvizitë dhe nga një pesëdhjetëlekëshe me urimin: «Ta  
pini për shëndetin e lumturinë e çiftit. Na e shpërblefshi  
me të tilla gëzime.»

— Hm, — tha i shoqi, t'i pinë për lumturinë e çiftit!

— Bukur shumë, — tha e shoqja e ngazëllyer.

— Qoftë bërë, — tha i shoqi me ton autoritar. Por  
kuota mund të zbritet nga pesëdhjetë lekë në njëzet e pesë.  
Kështu mund të marrim nam më të madh, se u japim edhe  
njerëzve tanë.

Mirë e kishte çifti Mandrikulli se kjo do të ishte një  
dasmë e padëgjuar. Ku ishte parë e ishte dëgjuar që të  
vesh në dasmë pa asnjë peshqesh, të hash, të pish, të bësh  
qejf dhe në fund të marrësh edhe një paradhënie për të  
ngritur dollari për çiftin pas dasmës. Të tilla dasma duhen,  
jo si ato që bëjnë disa me defterin kontabël ku dy kapi-  
tujt humbje e fitime përbëjnë tonusin e ndreqjes apo të  
prishjes së humorit të të zotërve të dasmës.

Ashtu si u tha, u bë, por vetëm me një ndryshim të vogël: në vend të parave do t'u jepnin të gjithëve nga një kuti llokume.

Dasma ishte me të vërtetë e madhe dhe gëzimi më i madh. Autori nuk ka ndër mend të ndalet në ato skena që autorë të tjerë i kanë përshkruar si «u derdh rakia lumë», si «lojti edhe qeni i kallajxhiut», si «u kërcye vallja e napolonit», apo si «u darovitën sazexhinjtë», si «ishte bërë byreku e bakllavaja me njëqind petë» e si kjo e si ajo. Këto dihen, se në çështjen e dasmave kemi marrë një yrysh të madh, aq sa harrohen edhe ata që martohen duke treguar ç'hëngrën e ç'pinë. Rrallë dëgjohen dasmorët të flasin për nusen e për dhëndrin, të cilët marrin më shumë kuptimin e menysë. Bile edhe të zotët, dasmë nuk quajnë martesën, po tavolinat.

\* \* \*

Afër mëngjesit, kur të ftuarit po dilnin jashtë, te dera i priste çifti Mandrikulli. I falënderonin të gjithë me radhë dhe çdo njeriu i lëshonin nga një kuti me llokume në dorë.

Kështu mbaroi kjo dasmë e paparë, por pa zbardhur mirë dita do të fillonin avazet e saj.

Çifti i hipi taksisë dhe u nis për të shijuar ditët e jetës së re kolektive, bashkëshortore. Familja Mandrikulli ishte pjesëtuar në dy çifte. Kishte gdhirë dita e parë që çifti Mandrikulli gëzonte të drejtën e epitetit vjehërr dhe vjehërrë, po atyre s'u shkonte në mendje se ç'telash e sherr i kishin hapur vetes në këtë dasmë të padëgjuar.

Trokiti dera e jashtme me tërsëllëm.

— Ndonjë telegram nga djali, — tha vjehrra Mandrikulli.

Vjehri Mandrikulli nxitoi të hapte derën. Në vend të postierit me telegramin në dorë u duk i vëllai i vjehrrit Mandrikulli. Shprehja e fytyrës së të vëllait dukej nervoze. Nuk përshëndeti as kunatën, po lëshoi këtë breshëri fjalësh:

— Si s'të vjen turp, more derdimen! Po edhe mua një kuti llokume më dhe për gëzimin e çiftit, aq sa i dhe edhe Maqos, që e kemi kushëri lëngstërlëngu? Asnjë dallim s'më ke bërë nga ai, mua që jemi të një barku! Po kush u gëzua më shumë se unë për nipin tim? Kush të mësoi ty të mos heqësh dorë nga kërkimi i trashëgimtarit? Po sa mundime e sa kohë kam humbur unë me ilaçet popullore? Nuk po flas kur e çoja dhe e merrja nipin tim në çerdhe, pale në kopsht, pale në shkollë, pale në provimet, pale në hartimet, pale ... pale ...

Pas bataresë ai bëri një prapakthehu dhe u zhduk tatëpjetë shkallëve. U ndie një zhurmë poshtë. Me sa u mor vesh, xhaxhai ishte përplasur me krushkën, tezen e dhëndrit. U hap dera dhe tezja iu drejtua së motrës:

— Të tërë si këmbët e dhisë u bëmë! Pika-pika! Një kuti llokume më shumë nuk më takonte mua nga Parashqevia, që vetëm për një dasmë ta ka parë derën? Nuk është punë llokumesh, po është punë sajdisllëku që ke për mua e për tim shoq, për shtëpinë tonë. Pika-pika!

Edhe kjo s'pranoi as shpjegime, as folje, po lëshoi përdhe pakon e llokumes dhe u zhduk.

— Hm! — tha vjehri Mandrikulli. — Hm, — dhe duke shfryrë, u vesh e doli jashtë.

Të parin njeri që takoi ishte Rustem Salepxhiu, me karrrocën përpara.

— Për shëndetin e çiftit të pimë nga një salep, — i tha ai dhe mbushi dy gotat.

Filluan të rrufisnin të dy salepin e nxehtë. Rustemi lëshonte herë pas here ndonjë romuz, kur ia behu kryesarhoshi i qytetit.

— More teveqel, — u dëgjua zëri i tij i trashë që dilte nga gurmazi si një bubullilmë e shurdhët.

— E paske bërë synë që në pikë të sabahut, — i tha Kostandin Mandrikulli, si për të nxjerrë inatin për epitetin teveqel.

— Qënke budalla ti, — iu përgjigj kryesarhoshi. — Po ku e di konjaku sa është ora? E, mo Rustem, e di konjaku sa është ora? Hë, fol! Po ti, more derdimen, ato pare që prishe për të blerë llokumet, m'i jepje mua që të të uroja e të vazhdonte dasma javë të tëra nëpër lokalet e qytetit. Kjo do ishte dasmë e padëgjuar, jo jotja.

Kostandin Mandrikulli rrinte i hutuar në mes të salepxhiut dhe kryesarhoshit të qytetit që hidhnin e prisnin romuze me njëri-tjetrin.

Doni më për dasmat?!...

## NE FOTOGRAFI BUZEQESH NJË ÇIFT

Kur i doli Llajnit gjumi, as ai s'po e merrte vesh ku ishte, çfarë kishte ndodhur e çfarë kishte bërë. Në fillim, kur pa se nuk luante dot as këmbë, as dorë, bile as qafën s'e rrotullonte sadopak, pandehu se mos kishte vdekur dhe rëndimi që kishte në trup mund të ishin rrasat e varrit. Në kokë i erdhën ca mendime fluturake.

«Po mirë, i vdekuri shikon? Ndoshta nuk shikon, po ëndrra sheh? Jo, i vdekuri i harron të gjitha. Atëherë unë ç'jam, i vdekur apo i gjallë. Në qoftë se jam i vdekur, ku gjendem, në «fer» apo në «parajsë». Ra prapë në një kllapi dergjeplotë.

Dalëngadalë po merrte veten. Në fillim dalloi se ishte shtrirë mbi një krevat dopio, mbuluar me një jorgan atllas bojë rozë. Më vonë pa se në murin përballë tij ishte një fotografi e madhe me një kornizë ngjyrë ari. Nga fotografia buzëqeshte një çift. Nusja ishte me fustan të bardhë e burri me kostum të errët.

Prapë s'merrte vesh, i vinte mendja rrotull, apo i rrotullohej dhoma. Një herë iu duk se ai burri i fotografisë ishte vetë ai. Por burri që qeshte në fotografi kishte mustaqe. U nisa nga Tirana pa mustaqe. Mos m'u rritën rrugës?! Vuri dorën mbi buzën e sipërme e preku disa qime të rritura. A mund të duken qimet si mustaqe në fotografi. Kam apo s'kam mustaqe. Jam, po ku jam, si jam? Hë, mor gjykimhumbur, gjeje ç'je. Epo pus nafte nuk jam! Me siguri jam burrë kaproç. Qeshi...

U hap dera dhe pa që drejt tij po vinte një njeri.

«Bobo, më zunë, — u tremb me vete. — Mirë bëra një gjumë të sakatepsur. Po ç'dreqin do të kem bërë që ndodhem në këtë dhomë?!»

Njeriu iu afrua te koka e me zë të butë i tha:

— Si u gdhive, o byrazer?

Llajni vështronte me habi se nuk e njihte dhe as i kujtohej ta kishte parë ndonjëherë këtë fytyrë me hundën si samar.

— Të lumtë se na nderove mbrëmë, — tha hundësamarri, që i rrinte mbi kokë.

Llajni me vështrimin e tij hajdutëronte hundësamarin. Deshi ta pyeste ku ishin parë e ku e kishte nderuar, po, meqë s'fliste dot, nuk hapi gojën.

Ra një heshtje. Mysafiri i shtrirë lëshoi ca fjalë belbacake.

— Nuk po më njeh, — vazhdoi tjetri, — o miku im i shtrenjtë? A të kujtohet autobusi që erdhëm dje? Unë jam kushëriri i dhëndrit.

Llajni u mundua të kapte një mendim që filloi t'i vërtitej. Me vështirësi e kapi dhe e nxori ngadalë nga goja:

— O i dashuri... miku im i shtrenjtë... Piva për nderin tënd... Miku i mikut tim... është, është ... miku im.

\* \* \*

Mysafirit nga Tirana nuk mund t'i shkonte ndër mend se në kohën që ai me një fjalërrjedhje të pompuar mbante fjalimin në Marrekë, një tjetër njeri frymëzohej nga kjo oratori dhe, «në shenjë respekti e konsiderate të lartë», po merrte guximin për t'i shkruar një letër.

Kur oratori ra në gjumë të thellë, muza e simpatizuesit po shtrihej si në çarçaf mbi letrën e bardhë, e cila mban çdo gjë që të shkruash mbi të. Nuk ka më të durueshme se letra. Po tani i frymëzuari, pasi hodhi mbi të ç'mundi, prishte me padurim fjalimmbajtësin për t'ia dhënë në dorë.

Që në mëngjes ai u përpoq nja dy herë të hynte në dhomën ku prehej mysafiri në gjumin e tij të thellë, por nuk e lanë duke i thënë me plot gojën se në asnjë mënyrë nuk duhej t'i prishej qetësia.

Vonë, kur mysafiri doli në rrugë, ai menjëherë e takoi dhe, me lutje e gëzim, i dha në dorë letrën, në të cilën shkruhej:

**Letër shokut King!**

*I nënshkruari Sisokol Sisokoli, lindur nën liqenin e Ulzës (me një fjalë në ish-fshatin Kokërdhok) dhe banues mbi liqenin e Fierzës (me një fjalë në apartamentet e hidrocentralit), invalid i grupit të dytë, parashtroj kërkesën time sa më poshtë:*

Ndodhem i strehuar në një apartament të ri me për-  
bërjen 1 me 1 (me një fjalë një dhomë e një kuzhinë). Si  
pozicion gjeografik unë kufizohem me katër familje. De-  
markacioni me gjëtoninë përcaktohet si vijon: Nga lindja  
(me një fjalë nga është hyrja e pallatit) banon Pina Mina  
(me një fjalë duhet thënë sa për tridhjetë njerëz, se ka një  
zë të lartë, llafe shumë dhe farefis edhe më shumë). Në  
juglindje banon Qemal Qemali, i cili, meqë s'ka llafe, zotë-  
ron një radio të markës «Iliria» me të cilën do të vërte-  
tojë pa asnjë kusht se zëri i saj mund të dëgjohet në tërë  
Ilirinë e moçme. Kryefamiljarin Qemal Qemali e zë gjumë  
edhe duke ngrënë bukë; mirëpo në vend të tij punon veg-  
la e quajtur radio. Nga jugu banon qytetari Ismail Kaçaku  
që abstenon për çdo gjë. Kurse sipër (me një fjalë, mbi  
kokën time) banon Lefter Kali, burrë kokoroç me 12 fëmi-  
jë, të shoqen 13 dhe vetë 14.

Në orën 5.00 të mëngjesit (me një fjalë sipas meridia-  
nit të Grenviçit, sepse orën diellore nuk e njeh) në vend  
të gjimnastikës së mëngjesit mbi kokën time dëgjohet një  
lloj zhurme që nuk përcaktohet dot ç'është: a është zhur-  
më që shkaktohet nga ngjeshja e dheut me tokmak, si në  
trasetë e hekurudhës Milot-Rrëshen-Klos, apo rrahje qu-  
mështi me dybek, si në baxhon e kooperativës së Lek-Daul-  
-luka-paçit.

Pas këtij procesi fillon një lloj vrapimi dhe unë e pan-  
deh veten se jam në fushën e maratonës. Më hipën një  
nostalgji për antikitetin dhe këtu nxitës bëhet djali i madh  
me emrin Akil (Stratiagos Akil). Për etapën e parë të gara-  
ve jurinë e kryeson themeluesi i këtij institucioni me em-  
rin e quajtur familje, kurse e ëma në këtë juri është vetëm  
me votë konsultative. Edhe Akili këtu shquhet mbi të gjë-  
thë, sepse disponon një mjet mjaft modern (e kam fjalën  
për një bori të dhuruar nga i ati). Këtu ai bëhet rival me  
gomarin dhe ia kalon gomarit. Këtu mund të të plasim në  
vend timpanët e veshëve nga vala goditëse, sidomos, kur



me zërin e tij bashkohen edhe e motra, Ariana, dhe vëllai, Armandoja.

Këtu hutohet edhe juria, e cila s'është në gjendje të japë çmime, prandaj unë po ju shkruaj juve, shoku King, dy kërkesa:

1. Të më emëroni drejtor të azilit të pleqve.

2. Në rast se nomenklatura përkatëse nuk e sheh të arsyeshëm këtë propozim, pranoj të bëhem anëtar i azilit të pleqve me të drejta të barabarta me të tjerët, por me një kusht që të ndërmjetësoni që në azile të bëhen zgjedhjet për drejtor ku me siguri do të fitoj shumicën absolute të votave.

Mbetem me shpresë se lutja ime do të merret parasysht.

**Sisokol Sisokoli**  
**Invalid i grupit të dytë**

Sidoqoftë ky tani mendonte të hynte në qytetin me katër porta. Pas dasmës tani ai e pa të udhës të vizitojë shtëpinë e pleqve, i plotfuqishëm për të verifikuar ankesën e Sisokol Sisokolit.

\* \* \*

Thonë se gozhda del me gozhdë, edhe raki del me raki, po, në qoftë se kjo e mallkuar raki lidhet me njëra-tjetrën, s'del as me dreq. Kështu i ndodhi edhe udhëtarit tonë, i cili, pasi u largua nga Mazreka me kokë të turbullt, në bufenë para azilit të pleqve i futi nja dy gota të tjera. Iu duk se e mori veten, por kjo ishte për disa çaste, se pastaj hyri në një turbullirë të re sa edhe pesha e trupit të tij i dukej herë më e lehtë, gati sa një pupël, herë e rëndë

si një kasafortë që s'e lëvizin dot nga vendi dhjetë burra. herë i dukej vetja një trim i pashoq, e herë si një njeri që ka frikë nga hija e vet. Herë i dukeshin fjalët e tij sikur dilnin nga një trup tjetër, e herë sikur duke kapërcyer buzet e tij përplasheshin në kokat e të tjerëve me një fuqi magjike që i hutonin.

Pra, duke e ndier veten herë të mençur dhe herë budalla, si kontrolloi edhe një herë në çantë letrën e Sisokol Sisokolit, me hap që s'gjykonte as vetë se si e hidhte, u nis drejt azilit.

## Kreu i dytë



*Moj shtëpia me dyzet pleq,  
kujt t'ia prish e kujt t'ia ndreq.*

Shtëpia e pleqve ishte ngritur mbi një kodër në dalje të qytetit, jo shumë larg katër portave. Dikur aty pati që në një teqe, po tani ndërtesa e saj, me kubenë e rrumbullakët, shërbente si klub dhe sallë dëfrimi për pleqtë. Përballë teqesë ishte ngritur ndërtesa e re e azilit me tri kate dhe anekset e nevojshme. Dikur teqeja ishte rrethuar me një pyll të bukur ku dervishët kalonin vapën, po tani pylli ishte shndërruar në një vresht të bukur, ku thonë se bëhet rrushi më i ëmbël i tërë qytetit.

Llajni hyri në oborrin e azilit, po atje nuk pa njeri. Ishte koha e drekës dhe pleqtë pushonin në dhomat e tyre.

Në fillim shtyu portën e teqesë dhe u fut brenda. Përballë ishte një sallë e shtruar me qilima dhe me mindere anash. Në fund të saj i zuri syri dy pleq që kishin ulur kokat mbi një tavolinë. Kur u afrua, ata nuk e vunë re, se po loznin domino.

Njëri nga pleqtë, duke vënë gurët, mermëriste me vete: «Lule, more, Selam lule.»

Tjetri lëshoi dopiogjashtën e tha:

— Me shëndet, Selman!

— Shëndet e të mira, o Rrapo! — u përgjigj kundërshtari.

Po në vend të përgjigjes së xha Rrapos, mbi kokat e tyre u dëgjua një zë i çuditshëm që vinte në një gjuhë të huaj:

— Gut morning!

Selmani me Rrapon ngritën kokat. Para tyre qëndronte një djalosh i gjatë me rroba bojë qielli dhe me syze të errëta.

— Hau duiudu, — u përgjigj Rrapoja.

— Turisteshen.

— Ç'kërkojnë turistët në azilin e pleqve? — pyeti Selmani, pastaj i tha turqisht Rrapos: Bu shejtan beni all-datnak istior?<sup>1)</sup>

Ndërsa Rrapoja e pyeti çobançe:

— Ci vrej llaj drak?<sup>2)</sup>

Turisti me rroba bojë qielli u mundua të fliste anglisht, po fjalori i tij ishte shterpë. Iu kujtua e vetmja shprehje që dinte turqisht e tha:

— Binde bir kallaxhok sene!<sup>3)</sup>

— Allah, allah, — tha Rrapoja me qesëndi. — Qenka turist i fortë ky, o Selo.

---

1) turqisht — Ky djall do të ma hedhë mua?

2) çobançe — Çfarë do, mor djall?

3) turqisht — Në këtë vit në një mijë një do të mbetet.

Njeriu me rroba bojë qielli u zu ngushtë e tha gjermanisht:

— Auvidersen!

— E, e, e, — foli Seloja. — Ky qenka gjerman, bre Rrapo.

«Turisti» ktheu kurrizin e filloi të ecte përmes sallës për të dalë jashtë. Po dy pleqtë u ngritën në këmbë dhe i zunë derën. Ai bënte me dorë se do të fikte e, si për të shpëtuar, thoshte nëpër dhëmbë:

— Autobus turisteshen!

— Pasaport, — i tha Rrapoja.

— Turisteshen, turisteshen autobus, — filloi të bërtiste Llajni.

— E paske zënë kalin së prapthi, more turist vena-lli, — thirri Rrapoja.

U duk se u nxeh turisti, po Rrapoja me Selmanin nuk shqiteshin nga porta. Ai, për të dalë, filloi të shtynte Selmanin, po Rrapoja nuk priti më. Një të zënë nën vete «turistin» dhe ai u palos përtokë sa gjatë gjerë.

\* \* \*

Pas ndonjë gjysmë ore kur kishte ardhur në vete, ai u gjend në një krevat. Hapi sytë dhe pa dy pleqtë, një infermier me bluzë të bardhë dhe një burrë të shkurtër me syze.

— Si qe puna? — pyeti burri i shkurtër me syze. —

— Unë jam drejtori i azilit.

Viktima e pleqve të azilit shqiptoi si me turp:

— Bëra shaka!

— Shaka me zarar, — u përgjigj Rrapoja.

— More, shpëtove mirë, — vazhdoi Seloja. — Dhe kë-

të nder e ke nga Rrapoja që ka qenë polic e dinte marifete të tilla, se, po të qe për mua, do të ta kisha ngjeshur kokës e tani kishe shkuar si turist andej nga ke dalë.

— Po ti, more rrufjan, që ke mbetur si miu në qyp, pse tallësh me ne?! — bërtiste Selmani.

— Lëshoma, o drejtor, — tha Rrapoja, — se do t'ia bëj kurrizin më të butë se barkun.

Pleqtë nervozë nuk bindeshin, po drejtori u tha se këtë çështje do ta shqyrtonte vetë.

## DREJT STUDIMEVE SHKENCORE

Pas pak djaloshi me rroba bojë qielli dhe burri i shkur-tër me syze u panë duke ecur të qetë përmes oborrit të azilit dhe hynë në drejtori.

Mysafiri i paftuar tha se vinte nga një gazetë për të parë kërkesën e një qytetari dhe nga çanta nxori letrën. Ai e vërtiti dy-tri herë nëpër duar si të donte t'i jepte më shumë rëndësi edhe vetes, edhe letrës dhe pastaj ia zgjati tjetrit që vazhdonte të bëhej gjithnjë e më kureshtar.

Ai e mori letrën dhe e lexoi me një frymë:

— Po kjo në fund ç'është? — tha drejtori.

— Cila? — pyeti përfaqësuesi i gazetës.

— Ja, kjo këtu, — dhe i tregoi rreshtat për zgjedhjen e drejtorit në azilin e pleqve.

— Njerëzit kanë të drejtë të propozojnë.

— Si të propozojnë, domethënë të hiqem unë si drejtor.

— Jo, jo, për këtë mos ki asnjë merak. Pse jemi ne.

Drejtorin kjo përgjigjë e ngrohu. Viktima e pleqve e ndjeu këtë dhe tha me seriozitet:

— Përkundrazi, unë kam dëgjuar fjalë të mira për azilin e pleqve që drejtoni ju, megjithatë... — Drejtori hapi sytë. — Megjithatë, — përsëriti, — një vend në azil mund t'i gjejmë.

— Kjo është punë e lehtë, — tha drejtori. — Për këtë mos ki asnjë merak.

Letërprurësi vështroi nga dritarja dhe në oborr pa dy pleqtë që fjaloseshin kokë më kokë. Iu kujtua ngjarja dhe u step. Ndezi një cigare dhe rrinte në këmbë i menduar.

Drejtori e vështronte me kureshtje, po edhe me druajtje.

Biseda me drejtorin vazhdoi edhe një copë herë. Ai u interesua për kushtet e jetesës së pleqve, për argëtimin e tyre.

— Për shembull, — tha Llajni, — këtu mund të ngrihet një grup teatral, në mos grup teatral, grup estrade.

Drejtori vështronte i habitur, po edhe aprovonte. Me të vërtetë pleqtë e azilit mund të argëtoheshin më mirë.

— Ndoshta grup teatral mund të ngrihet, — tha drejtori, — po grup estradë jo, se s'kemi këngëtarë.

— Grup teatral mund të ngrihet menjëherë, — vazhdoi Llajni. — Konkretisht mund të vëmë në skenë komedinë «14 vjeç dhëndër». Mund ta shfaqin këtu, madje edhe në qytet. Do të keni sukses të madh. Madje mund të shkonin edhe në turne. Ta zëmë, filluan punimet në hidrocentralin e Banjës; filluan. Shkon grupi juaj teatral dhe jep shfaqje. A ka gjë më të bukur? Pale në hekurudhën Milot-Rrëshen-Klos. Në mes të brigadave të rinisë pleqtë japin komedinë «14 vjeç dhëndër».

— Po mos na dalë 80 vjeç dhëndër? — pyeti drejtori.

— Aq më mirë, — tha Llajni, — do të jetë një gjë origjinale. Azili juaj mund të marrë nam si një institucion artistik që t'ia kalojë Teatrit të Operës dhe Balëtit.

Këto biseda të këndshme e kishin zbutur drejtorin, po djaloshi po i hynte në zemër dhe për një arsye tjetër. Ai, duke u marrë me argëtimin e pleqve, nuk po e trazonte atje ku i dhimbte dhëmbi. Drejtori kishte marrë shtëpi të re dhe shumë materiale të azilit, në një mënyrë apo në tjetrën, tani gjendeshin në përdorim të katër djemve të tij beqarë, nga të cilët më i vogli kishte mbushur me kohë moshën 30 vjeç dhe nuk i pëlqente të zinte punë gjëkund.

Llajni, sikur të kapte me intuitë ato çka mendonte drejtori, vazhdoi:

— I dashur drejtor, është e vërtetë se mosha e njeriut është rritur. Në shekullin e parë të erës sonë mesatarja ka qenë 22 vjeç, sot, te ne, është 70 e kusur vjeç, po, ama, kjo është rritje biologjike, duhet të rritet mosha intelektuale. Me një fjalë të mos matufepset njeriu në 50 vjeç. Ky është një problem që duhet ta studiosh ti në azile, bile për këtë mund të mbrosh dizertacion.

— Unë për 6 muaj dal në pension, — tha drejtori.

— Mos vallë ti, shoku drejtor, ke bindjen se je matufepsur? Përkundrazi, ti ke energji të pashtershme.

— Hë, — tha drejtori.

— Atëherë ti mund të qëndrosh këtu me suksese të njëpasnjëshme jo 6 muaj, po 6, bile 16 vjet. Azili ka nevojë për njerëz që t'u pjellë mendja dhe, për mendimin tim, pleqtë që banojnë këtu kanë fat që të kanë ty drejtor.

— Kjo shtëpi me 40 pleq kujt t'ia prish e kujt t'ia ndreq, — tha drejtori si për ta shkrifëruar më tej bisedën.

— A, jo, jo, i dashur drejtor, ti je në krye jo të 40 pleqve, por mund të jesh në ballë të 2000-ve e mund të shndërrosh në një model drejtimi e organizimi ku mund të vijnë të marrin përvojë të përparuar edhe kolegët e tu nga gjithë vendi.

— Më ardhke tamam pas huqeve, — tha drejtori duke mbyllur vrik të dy sytë.



\* \* \*

Trokiti dera dhe, kur ajo u hap, në portë u duk një oficer i ri.

— Mund të hyj? — pyeti ai.

— Urdhëroni, urdhëroni, — tha drejtori.

Oficeri hyri brenda dhe i zuri për dore të dy.

— Të prezantoj, — tha drejtori, duke treguar djalo-shin me rroba bojë qielli. — Ky është një miku im nga Tirana.

— Gëzohem, — tha oficeri dhe pa me vërejtje mikun nga Tirana. Ai rrinte serioz dhe pinte cigare.

— Urdhëroni, — tha prapë drejtori.

— Kam ardhur të bëjmë ca verifikime në evidencat ushtarake.

— Shumë mirë bëni, — ndërhyri mysafiri i Tiranës. — Socializmi është evidencë, llogari.

Oficeri pa me vërejtje folësin se ndërhyrja iu duk e çuditshme, por nuk foli. Drejtori hapi kasafortën dhe nxori ca regjistra. Oficeri tha:

— Në qoftë se tani jeni të zënë, unë pres të mbaroni punë.

Drejtori nuk foli se s'dinte ç'të thoshte.

— Jo, jo, — tha mysafiri, — mund të vazhdoni punën.

Oficeri pa prapë me habi mysafirin, por, kur e pa se ai s'po lëvizte nga vendi, i tha:

— Mirë atëherë, na fal pak mua me drejtorin sa të mbarojmë punë dhe pastaj vazhdoni ju.

Mysafiri i Tiranës u zu ngushtë, por, si për të dalë nga gjendja, para se të dilte jashtë, bëri një pyetje:

— Meqë merreni me evidencat, a mund të më ndihmoni të gjej një të quajtur Alush Panajaja?

— Alushin? — foli i çuditur drejtori i azilit.

— Po, po, Alush Panajaja, — theksoi mysafiri.

- Po për këtë të ndihmoj unë, — tha drejtori.
- Faleminderit, — u përgjigj tjetri.
- Alush Panajaja ka qenë këtu llogaritar i azilit, ndër-  
sa tani ka ikur në fshatin Drizë, se ka dalë në pension.
- Domethënë në Drizë e gjej? — pyeti mysafiri.
- Me siguri, — tha me ton bindës.
- Po nga bie Driza?
- Është fshati i parë në të majtë të qytetit, ndonja  
dy orë larg, po është në zonën malore.

Oficeri tha:

- Sa të mbaroj punë, unë andej do të nisem.
  - Faleminderit, — tha mysafiri.
  - Mirë pra, — vazhdoi oficeri. — Sa më shpejt të  
mbaroj punë unë, aq më shpejt do të nisem për atje.
- Mysafiri deshi të bënte edhe ndonjë pyetje tjetër, po oficeri nuk ia zgjati më, prandaj ai, pa ç'pa, ndezi ciga-  
ren dhe doli jashtë.

Në oborr u ndesh ballë për ballë me dy pleqtë.

- E, more turisteshën, — tha Selmani.
- Shaka, — tha mysafiri.
- Mos bëj shaka me zarar, — vazhdoi Rrapoja.
- Po na të kemi zotrote? — pyeti Selmani.
- Jam nga Tirana, — u përgjigj tjetri.
- Po ç'punë bën, more djalë? — pyeti prapë Selmani.
- Jam gazetar, — tha tjetri.
- Qofsh shëndoshë, po më i shëndoshë do të bëhesh,  
po t'i futësh një artikull këtij drejtorit tonë.
- Pse? — pyeti mysafiri. — Ç'ka bërë?
- Është matufepsur më keq se ne, — tha Rrapoja.
- Jo, more! — pyeti mysafiri i habitur. — Po ç'bën  
me matufepsjet e tij?

— Tund zinzhirin tërë ditën. Ne i themi t'i kërkojnë  
llogari kuzhinierit, se harxhet ikin që ikin, po gjellët s'kanë  
shije. Ai «ëhë!». Ne e kemi racion të pëmë dy kafe në ditë.

Ai për vete pi dhjetë dhe prapë «ëhë, ëhë». Nuk e marrim vesh, ne jemi në azil dhe ai duhet të kujdeset për ne, apo ai është në azil dhe duhet të kujdesemi ne për të? Paret i jep shteti, po ato shkojnë dëm se nuk u bëhet hyzmeti.

Rrapoja me Selmanin i folën gjerë e gjatë dhe ai mban-te shënim në një bllok të vogël. Pastaj erdhën edhe dy pleq të tjerë. Dhe Selmani tha:

— A do ta bëjmë një katërshe?

— Për atë kemi ardhur, — thanë dy pleqtë e tjerë.

— E po ti, shoku gazetar, bëj punën tënde, se ne do të bëjmë tonën.

Ata të katër kaluan përmes sheshit, shtynë portën e teqesë dhe u futën brenda.

Llajni vazhdoi të pinte cigare njëren pas tjetrës, derisa në shesh u dukën drejtori me oficerin.

— Ikim? — tha oficeri.

— Po kisha edhe ca punë me drejtorin.

— E mirë, ti rri, unë po iki.

— Jo, jo, — tha mysafiri. — Në qoftë se s'të pret puna, po vij me ty. Kthehemi prapë.

— Kur të doni, — vazhdoi drejtori. — Mua më keni në krye të detyrës. — Ai e përcolli mysafirin gjer te bufeja në krye të rrugës. Pinë të tre nga një konjak. Mysafiri piu edhe një tjetër se, siç tha, ai kishte ardhur me dy këmbë, jo me një dhe u ndanë.

## **MYSAFIRIT I TREGOJNË NJË SEKRET**

Ata të dy kishin ndonjë orë që ecnin. Rruga ishte e përprjetë, po mysafiri nga Tirana nuk pushonte së foluri.

— Ju keni një detyrë shumë delikate, por ama të nde-

ruar, — vazhdonte t'i thoshte mysafiri oficerit. — Ju jeni ajka e djalërisë, jua kam zili.

Më së fundi oficeri u mërziu kaq shumë, sa tha:

— Tani, ty, i dashur gazetar, po të them një sekret, por të lutem...

— Ç'është ajo, — tha mysafiri.

— Jo, se, po ta nxjerrësh jashtë, më merr në qafë, se këto janë sekrete shtetërore.

— Të kesh besim të plotë dhe unë të garantoj se do ta mbaj më të fshehtë se ti.

— Të besoj, — i tha oficeri, — prandaj dhe po ta tregoj.

Oficeri ndaloi. Ndaloj edhe mysafiri.

— Po të vazhdojmë këtë rrugë, del gjatë, se i bie rreth e rrotull kodrës, kurse këtu bie drejt e shkurt, për gjysmë ore dalim në fshat.

— T'i biem shkurt, — vazhdoi ai, — pse të mos i biem.

— E po këtu është sekreti.

— Unë nuk shoh ndonjë sekret këtu.

— Pikërisht sekreti është atje ku s'e sheh.

Ai vështronte oficerin në sy.

— E sheh këtë kodër të madhe?

— Po, — tha tjetri.

— E po kjo kodër është e gjitha e minuar.

— Jo, more, — tha tjetri i habitur dhe i kënaqur nga sekreti që po mësonte.

— Pra, në qoftë se duhet të kalojmë këtë brez të minuar, nuk mund të kalojmë më këmbë. Duhet të hiqemi deri te liqeni zvarrë.

— Të hiqemi, — tha mysafiri.

Oficeri vazhdoi:

— Mirë unë tërhiqem se jam me rroba ushtarake, po ti me këtë kostum dhe elegancë që ke!

— E po, si të bëjmë atëherë? — pyeti tjetri.

— Ka një mënyrë, po nuk e di në e bën dot.

— Si? — pyeti mysafiri.

— Të heqësh xhaketën dhe pantallonat.

Ai u zu ngushtë, po pastaj, si për të betonuar fjalët që i kishte thënë oficerit për heroizmin, sakrificën dhe trimërinë, tha:

— Në qoftë se është nevoja, edhe këtë e bëjmë, bile japim edhe jetën.

— Mirë, atëherë, jemi përpara brezit të minuar. Po ece më këmbë, pesha e trupit tënd të rëndë ka rrezik të shkaktojë shpërthimin e minave, prandaj të hiqesh zvarrë dhe lehtë e lehtë.

Mysafiri hoqi në fillim xhaketën, pastaj edhe pantallonat.

— Lidhi me rrip, — tha oficeri, — dhe vëri mbi shpinë!

Kur përgatitjet në «bazën e mësymjes» morën fund, Llajni u shtri dhe filloi të tërhiqej zvarrë.

— Me kujdes! — porositi oficeri. — Një gabim i vogël kushton jetën!

Mysafiri nuk fliste. Po si u tërhoq pak zvarrë, hapi gojën e tha:

— U lodha!

— Në asnjë mënyrë të mos e thuash fjalën u lodha, përkundrazi me energji të pashtershme duhet të mbërrish në objektiv. Objektiv i është maja. Zvarritu! Zvarritu! Të shohim kush do të arrijë i pari, ti përmes fushës së minuar apo unë përmes tuneleve me bomba.

Kur u takuan në majë, mysafiri dihashte, i dërsirë dhe i rraskapitur. Qëndroi disa minuta shtrirë, pastaj filloi të shkundej e të vishej dalëngadalë.

Po binte mbrëmja. Oficeri që kishte arritur i pari, duke mbajtur me zor të qeshurit, i tha mysafirit:

— Të lumtë! E kalove fushën e rrezikshme! Tani i sheh ato shtëpitë atje përtej?

— Ato midis pyllit?

— Po, — vazhdoi oficeri. — Ajo është Driza A, kurse unë do të shkoj në Drizën B, që bie në anën tjetër.

— Si?! — tha mysafiri i habitur. — Do të më lësh vetëm?

— Ti, shok i dashur, sot mësove një sekret të madh e dhe një provë të shkëlqyer vetëmohimi e sakrifice, tani përpara për në Drizë, po kujdes se tregon sekretin!..

— Sekretin? Në asnjë mënyrë! — tha mysafiri. — Po ujq a ka këtej?

— Ujq jo, është vetëm një ari në atë pyllin atje përtej. Në qoftë se të del, hip në pemë, ose më mirë merr këtë hurin këtu. — Oficeri u ul përdhe dhe i dha mysafirit në dorë një dru të gjatë. Pastaj, pa e zgjatur më, i dha dorën e i tha: — Rrugë të mbarë e suksese në detyrë!

Oficeri filloi të zbriste tatëpjetë bregut Mysafiri ndenji edhe një copë herë në këmbë i lodhur, i mërzitur, i penduar e në mëdyshje për rrugët që do të bënte, pastaj filloi të ecte.

\* \* \*

Alush Panajaja u gëzua për kushëririn që i erdhi, po ky gëzim nuk zgjati shumë dhe u shndërrua në pezmatim.

— Kalova andej, — i tha kushëriri kushëririt.

— Nga? — pyeti Alushi.

— Andej pra, nga zona e minuar.

— Cila zonë e minuar? — pyeti me habi Alushi.

— Ajo që është te kodra përtej.

Alushi më shumë s'u besonte veshëve të tij, sesa s'e kuptonte.

— Cila zonë e minuar? — pyeti prapë kushëririn.

— Është sekret i madh, prandaj ti dhe kurrkujt mos i hap gojën.

— Si do të hap gojën për sekretet, — vazhdoi i çuditur. — Po zonë të minuar s'ka këtej?!... Ajo pllaja atje është kullotë. Nuk pe bagëti?

— Jo, jo, këto i di unë më mirë se ti.

Kushëri Alushi u mundua të sqarohej edhe një copë herë, pastaj e kuptoi që këtu kishte një rreng e, megjithëse nuk e zgjati më, ngjarja i mbeti në mendje.

Po e ëmbla vjen në fund.

Disa herë Alushi u lëkund nga fjalët e djalit të kushërirut Alush për punën e trashëgimisë, sepse i fliste me aq bindje, sa filloi të krijonte edhe dyshime mos i kishin bërë ndonjë hile.

— Unë i kam shokë dhe miq të ngushtë të gjithë që punojnë në shoqërinë komisionare. Nuk është i pari rast që janë bërë gabime. Rasti më i fundit ishte ai i një shokut tim të ngushtë në Tiranë që i thanë se i gjyshi si trashëgimi në testament kishte lënë një makinë rroje të markës «Xhilet», në të vërtetë ai kishte lënë një testament në firmën «Xhilet».


Këto përpjekje mysafiri i bënte me dy qëllime: Mos vallë Alushi kishte marrë trashëgimi dhe nuk e kishte shpallur, ose, në s'kishte marrë, pse të mos futej ky pinjoll i tyre? Kërko se diçka do të gjesh.

Alushi i mërziur i tha për të fundit herë:

— Pasuria e tim eti dhe stërgjyshit tënd ishte gjash-të dollarë. Në bazë të testamentit babait tuaj i takonin tridhjetë qindarka. Po të duash, po t'i jap.

— Mirë, mirë, të shohësh ti kur ta gjej unë dhe atë-herë ke për të më kërkuar ndjesë për gabimin që ke bërë e po bën edhe sot.

— Mirë, ashtu qoftë, po e nxore, të lumtë, por kot mundohesh. Njeriu duhet t'i gëzohet djersës së tij e jo trashëgimisë lëngstërlëngu.



## Kreu i tretë

### E DINI PSE I NENSHTROHET GOMARI NJERIUT?

Atë natë në fshat përrurohej klubi i gjahtarëve e peshkatarëve sportivë, prandaj Alush Panajaja i tha kushërit të tij se do të shkonin bashkë, madje gjahtarët e fshatit do ta kishin për nder që në këtë ditë të shënuar për ta, do të merrte pjesë edhe një mysafir i nderuar nga Tirana.

Alush Panajaja, dora vetë, ishte kryetari i gjahtarëve dhe peshkatarëve sportivë të fshatit, prandaj edhe vendi në ballë i takonte atij. E, domosdo, pranë tij do të rrinte mysafiri i menduar.

Ndërtesa e klubit ishte mbi një kodër, në mes të një lirishte të rrethuar me bredha.

Legjenda e murimit të nuses në themelet e kalasë Rozafat të Shkodrës, me forma të tjera, ka ardhur deri në



ditët tona. Madje edhe kur hapen themelet e një shtëpie, të zotët e saj bëjnë kurban, sigurisht sipas rastit, sipas kuletës e sipas interesit. Zakonisht bëhet kurban një dash, po mund të zbresë edhe në një këndes. Në rastin konkret kurbanin nuk ishte bërë kur u hodhën themelet, por kur u hodh çatia e klubi u bë gati për të filluar nga veprimtaria. Veprimtarët e tij, në këtë rast, kurban kishin bërë një derr të egër, të cilin, pasi e kishin qëlluar me plumba, e kishin rrjepur, e kishin pjekur dhe ja, tani, e kishin vendosur në mes të tavolinës, duke i vënë një patate në gojë e gjethe dafine mbi kurriz. Dafina, si simbol i lavdisë, e tregonte më ashikare fundin e kurbanit dhe gjahtarët e peshkatarët sportivë tani po mblidheshin rreth tij, jo më për ta vrrarë, por për ta shijuar. Pra tani ata nuk ishin në rolin e gjahtarëve, por të digustuesve, siç bëhet zakonisht nëpër ekspozitat e kulinarisë.

Tani patatja në gojën e derrit ishte vetëm një zbukurim që s'i bënte përshtypje gjindjes. Problemi shtrohej ndryshe. Pjesëmarrësit ishin të interesuar ç'pjesë e ndarjes anatomike të viktimës do t'u takonte. Dhe kjo gjë vërtetonte jo vetëm digustimin vetjak, por edhe vendin dhe rangun që i takonte secilit në atë tavolinë. Megjithatë përparë se të arrijmë në këto çështje konkrete e praktike, duhet të kalohen disa faza të tjera. Konkretisht pas fazës së lajmërimit e grumbullimit të pjesëmarrësve, e cila ishte përfunduar me sukses, bile edhe jashtë parashikimit, se kishin ardhur edhe më tepër të ftuar, e midis tyre, jo vetëm nga rrethi, por edhe nga Tirana, tani veprimtaria e përrurimit ishte gati të hynte në një fazë të re. Veprimtarët do të dëgjonin fjalimin e rastit.

Nuk vonoi shumë dhe përballë, mbi kokën e derrit, doli kryetari i gjahtarëve dhe peshkatarëve sportivë të fshatit, Alush Panajaja. Në të djathtë të tij rrinte anëtar i këshillit drejtues të kësaj shoqate të rrethit. Pranë tij, domosdo, do të rrinte drejtori i pyjeve së bashku me tre

rojtare të zonave. Në krah të majtë rrinte kryeveterineri i rrethit. Por këtij i duhej të rrinte pakëz këlleç për shkak të mysafirit nga Tirana, i cili deshi të ishte në krah të kushëririt të tij fjalimmbajtës. Pas veterinerit të rrethit rrinte zootekniku i kooperativës dhe, pas tij, kryebariu, Adem Qafmali, bashkë me rojën e kooperativës së zonës, ku ishte vrarë viktimja gjatë dëmtimit të kavaletës me patate.

Më poshtë, në drejtim të shpatullës së derrit, në të dy anët rrinin nëpunësi i gjendjes civile (në të djathtë) dhe brigadieri i SMT-së (në të majtë). Pastaj vinin 14 gjahtarët e fshatit, në mes të të cilëve spikaste pamja gazmore e drejtorit të shkollës së mesme bujqësore, gjahtar mjaft i apasionuar, sidomos për sa i përket sektorit të degustimit. Në grupin e gjahtarëve ndodhej edhe Dervish Koburja, që kishte vrarë derrin.

Pritej të vinte kryetari i kooperativës, por në vend të tij erdhi përgjegjësi i furnizim-shpërndarjes, i cili njoftoi të pranishmit se shoku kryetar kërkonte falje për mungesën nga që e kishin thirrur urgjent në rreth e në vend të tij ndenji ai vetë.

\* \* \*

Kryetari i shoqatës së gjahtarëve dhe peshkatarëve sportivë të fshatit e hapi mbledhjen me një fjalim përshëndetës për gëzimin që ndiente ai vetë, shokët e tij, madje gjithë Driza për klubin e ri. Duke folur për rëndësinë e kësaj ngjarjeje, ai tha:

— Qysh nga shfaqja e njeriut mbi tokë, ai është përpjekur të gjejë të mira materiale, ndër të cilat mishin,

gëzofërat etj., të cilat i ka siguruar nëpërmjet vrasjes së kafshëve të egra, duke praktikuar gjuetinë. Me zhvillimin e shoqërisë njerëzore, kur njeriu gjeti shumë burime të tjera për ekzistencën e tij, nocioni i gjuetisë e zgjeroi shumë përmbajtjen dhe kuptimin. Ai vazhdoi ta praktikonte gjuetinë si mjet stërvitjeje për luftë, pastaj si mjet zbatimjeje, pastaj në ditët tona, si mjet çlodhës dhe edukimi etik.

Po nuk mundi të vazhdonte më gjatë, sepse ngjau një e papritur: Në sallonin e klubit hyri një njeri me tërsëllëm dhe me një ujë të varur në kurriz. Kaloi përmes sallës dhe e lëshoi përdhe, atje pranë tavolinës ku gjendej derri me pataten në gojë.

Kryetari ndërpreu fjalimin, gjindja përqendroi vëmendjen tek ujku i vrarë. Gjahtari rrinte serbes para tij. Në ballë i dukeshin bula djerse. Si të donte t'u jepte përgjigje njerëzve që e vështronin me habi dhe me zili, kaloi një herë dorën nëpër mustaqe, po nuk foli.

Në vend të tij foli mysafiri nga Tirana:

— Domethënë e asgjësove edhe këtë kafshë grabitqare.

— Bezbeli, — tha vrasësi i ujkut.

— O kushëriri im i dashur, — ndërhyri kryetari i shoqatës. — Ky është Tofik Tosuni, kryegjahtari më i madh, jo i fshatit, por i tërë krahinës.

— Gjuetia sot është shkencë, — tha mysafiri sikur thoshte një sentencë.

— Shoku Tofik e ka me praktikë, — sqaroi gjahtar Sinan Dumani.

— Ja, për shembull, — vazhdoi mysafiri me një hijerëndësi, — e dini pse i nënshtrohet gomari njeriut?

— Se është gomar, — u përgjigj prapë Sinan Dumani.

Të tjerët qeshën. Tofik Tosunit i lëvizi një muskul në faqen e majtë.

— Jo, jo. Gomari i nënshtrohet njeriut sepse ky objekt i duket kafshës dhjetë herë më i madh sesa është.

— Armiku i ujkut është njeriu. Por, ama, ujku për ujkun është njeri, — tha kryetari i shoqatës.

— Ujku mund të kryqëzohet me qenin, — tha Tofik Tosuni, — bile edhe mund të zbutet, por, po të lihet i lirë, kthehet në gjendjen e parë.

— Si e vratë këtë ujk? — pyeti mysafiri.

— Ka shumë metoda, — u përgjigj kryetari i shoqatës. P.sh. metoda me çues, me pritë, me flamuj, me imitim të zërit etj.

— Me flamuj?! — tha i habitur mysafiri. — Pse edhe ujku bën manifestim?

Ata qeshën prapë.

— Jo, jo, — tha Sinan Dumani, të cilin, meqë kishte njohuri të mëdha teorike për gjuetinë, e kishin zgjedhur sekretar të shoqatës. — Në fakt flamujt, — vazhdoi ai, — janë copa beze me ngjyra zakonisht të kuqe me gjatësi 30 centimetra dhe me gjerësi 15 centimetra. Ata fiksohen në një spango me gjatësi 60-70 centimetra. Mbasi përgatitet 3-4 kilometra spango me këta flamuj, rrethohet pjesa përkatëse e pyllit duke fiksuar spangon nëpër shkurre, degë e shkopinj me lartësi rreth një metër nga toka. Mbasi bëhet kjo punë, gjahtarët zënë vend në anën e kundërt nga fryn era. Çuesit vijnë ngadalë. Ujqit nuk i kalojnë flamujt.

— Atëherë bjeri t'u biem, — tha një gjahtar tjetër.

— Unë e vrava me imitim, — tha Tofik Tosuni.

— Si?! Domethënë ti di të imitosh ujkun? — pyeti mysafiri.

— Bezbeli, — u përgjigj vrasësi i ujkut.

— Kjo metodë, — tha sekretari i shoqatës, — bazohet në zakonin që kanë ujqit për të ulërirë. Duke imituar ulërimën e tij, gjahtari arrin të tërheqë ujkun, që mund të gjendet në afërsi. Praktikisht veprohet kështu: mbasi

dëgjon ujkun që ulërin, gjahtari i përgjigjet. Në qoftë se ujku qëndron në vend, thirrja do të përsëritet me intervale 15-20 minuta.

— A mund të kemi nderin të dëgjojmë si ulërin ujku? — tha mysafiri.

Kaluan disa çaste në heshtje.

Në sallë u ndie një kungërimë veshçjerrëse e zgjatur. Mysafirit i hynë dridhma se pandehu mos u ngrit ujku i vrrarë. Po të tjerët qeshën dhe atij i shkriu gjaku.

— Dëgjo, or mik, — tha gjahtar Sinan Dumani, — gjuetia e ujkut nuk është punë kalamajsh. Ujku nuk rri vetëm, po me kope. Ja tani ata kanë zbritur nga malet poshtë se atje ka dëborë dhe ata duan ushqim.

— E di ti, mik, — e mori fjalën sekretari i shoqatës, — si e bën dasmën ujku?

— Medemek si mbyllet dhëndri, — shtoi me të qeshur kushëriri i mysafirit.

— Me ulërima, si do të bëhet ndryshe, — vazhdoi mysafiri. — Mos do të prenotojë lokal në ushqimin social?

— Në ushqimin social jo, po në vathë po, — tha Tofik Tosuni. — Dy javë përpara ky ujk, — dhe ai tregoi viktimën që rrinte shtrirë pranë tavolinës së dërrit, — me një fjalë ky ujk dhe, jo tjetër, këtë e di unë më mirë, si buka që hamë, vajti në vathën e Zoto Koçiut, se i ziu Zoto kishte zbritur në fshat, se e kishte punën si ajo kënga «Tjetër herë me djalë». I kishte lindur gruaja në maternitet dhe ai la kopenë vetëm, jo vetëm, po në dorë të këtij ujku. Po ky, — dhe tregoi me gisht viktimën, — hapi derën, hyri në vathë. Delet e shkreta «Blegërin, moj, delja maleve». Kush mundi doli e secila vajti të gjejë çobanin te dera e maternitetit, ku Zotoziu, i marrosur nga sevdaja, i këndonte çobaneshës. Çau sa mundi ky i mallkuar. Po të tjerat mezi u mblodhën nëpër mal një javë të tërë. Ama

dhe unë dy javë pas tij sa e solla këtu, — dhe zhubrosi surratin.

— Kjo është burrëri, — tha gjahtar Birçe Rakipi, — jo si i ngjau këtij shokut Qano, — dhe, duke iu drejtuar një gjahtari pranë, tha me zë të lartë:

*Ç'thua, o Qano qorri,  
ujku mu në shteg të dolli,  
në grykë të çiftes të pordhi.*

Të gjithë qeshën.

Po Qaniu, si të kishte zënë pritë, ia ktheu hazërxe-vapin:

*Me vulë, Birçe, me vulë,  
për kunadhe vrave pulë.  
Birçja ball' i karvanit  
vrau pulën e xha Hasanit.*

Prapë qeshën. Po Birçja fishekun e kishte në gojë:

*Kush i zuri minjtë e marit?  
Qanua shok i Babulit.  
Te cepi i zyrës Qanua,  
po bërtet e çirret i ziu,  
oburra, se iku miu.  
Ky Babuli plot pëllëmba  
nëpër ferra, nëpër gjemba,  
Xakja, fajkua vrapi,  
ç'e zuri minë te rrapi.*

Kryetari i shoqatës mori yrysh e tha:

*Hajde, Birçe mustaqelliu,  
në dorë çiftja të ngriu.*

Të gjithë qeshën, po mysafiri tha serioz:

— Domethënë, tani po bëni dasmën e këtij ujku.

— Jo, jo, — tha sekretari, — Ta them unë si bëhet dasma e ujkut.

— Pse, e ka bërë dasmën? — tha mysafiri.

— Jo, — u përgjigj gjahtari. — Këtë s'e lashë unë të martohet se i hipi tamahqarllëku e, konsumoi shumë mish. Ia bëri kopenë fërtele Zotoziut.

— Kur vjen koha e martesës, — tha sekretari, — nusja nuk martohet në kopenë e saj. Dhëndrin e gjen në tjetër «derë», me një fjalë në tjetër kope. Mirëpo, edhe atje nuk bëhet dasmë pa mish. Niset nusja, niset. Atje e presin dasmorët. Me një fjalë në shtëpinë e dhëndrit. E dhëndër e di kë bëjnë?

— Më të zotin, — tha Tofik Tosuni, — kë do të bëjnë, Qanon apo Xaken, që u kanë rënë dhëmbët me kohë.

— Kështu pra, shkon ujkonja nuse në kopenë tjetër. Atje i pari e pret dhëndri. Po ama dhëndri, po s'qe i zoti ta bëjë nusen për vete, atëherë marrin hak të tjerët. Nuk i turren nuses, po dhëndrit. Kush të dalë më i zoti, e merr nusen, bile dhëndurët e pazotë, mund t'i bëjnë fërtele sa t'i ngordhin.

— Tabiat hajvanor, — tha llogaritari i kooperativës.

— A, jo, jo. Kjo është një shprehje arbutërore, — kundërshtoi sekretari i shoqatës. Kur s'je i zoti të marrësh nuse, pse kërkon të bëhesh dhëndër?

— E po, të na trashëgohet çifti, — tha mysafiri. Dhe, ngaqë donte të degustonte sa më shpejt derrin e pjekur, mori gotën e rakisë në dorë dhe e ngriti me fund pa pyetur për të tjerët.

\* \* \*

Alush Panajaja vështroi me bezdi djalin e kushëririt. Po ai iu duk sikur me seriozitetin e tij i thoshte «nuk jam çanak me dhallë».

Alushit iu ngacmuan më tej mendimet dhe iu shtua bezdia duke parë fytyrën e mikut të tij. Ai vërtet i ngjiste shumë të atit. Kishte të njëjtat tipare, po, në qoftë se tek i ati ato ishin rritur si me kursim të madh, tek i biri ishin të harlisura. Hijerëndësia e tij dukej e shtirur, në mos më shumë e pështirosur. Tiparet i kishte të bukura, po ishte më shumë një pispillosje se një ruajtje e tyre origjinale. Murrash nga flokët, me fytyrën qime derrore dhe buzë të llagaritura, ai dukej ndryshe nga të tjerët, po në këtë ndryshim ai kishte një diçka fluturake. «Djalë tigani», — mendoi me vete. Dhe, si për t'i gjetur fundin këtij mendimi, kujtoi të atin: Ai ishte njeri i mirë, i ndershëm, i drejtë. Të dy kishin vajtur e kishin luftuar. Prapë vështroj mysafirin me rrobat beharore dhe prapë mendja i shkoi tek i ati. Ai kujtoi atë ditë kur i tha: ti je intendent. Këtu në shtab depo ka. Unë jam partizan i thjeshtë. Më janë grisur pantallonat. Shikoi si i kam.

I kushëriri e pa e nuk foli, po zhveshi të tijat dhe i tha: merri e nëmi mua të tuat. Unë jam intendent, këtu s'më duhen më të mira, ti do të luftosh. Vishi.

Tani i biri vinte këtu të gjente pasuri e trashëgimi. Vështroi prapë mysafirin, po cipëplasuria e tij qe e pashembullt. Ai, pa pyetur për njeri, ngrinte gotat e rakisë me tamahqarllëk.

«Nga trëndafili del edhe ferrë», — mendoi.



## INTERMEXO

Ne kishim gjithë ditën që luftonim. Padsreke armiku u tërhoq dhe çeta jonë e lodhur, e uritur, por e gëzuar se mundi armikun dhe s'pati asnjë humbje, u nis atje ku ishte vendosur intendenca e zonës.

Ishte një ditë e ftohtë pranvere dhe ndaj të ngrysur hëna doli e plotë që prapa maleve.

Në luftë s'na vente mendja për të ngrënë, po tani që po shkonim, sidomos atje ku ishte intendenca, gjithkujt i vente mendja te barku bosh e tek ushqimi që do të hanim. Dhe me të vërtetë, kur arritëm atje, njeriu që na doli përpara ishte intendent.

Nuk e morëm vesh, tha apo s'tha ndonjë nga ne se ishim pa ngrënë, por intendent pas pak shtroi një bata-nije të madhe dhe ne u ulëm rreth e rrotull saj.

— Tani do të bëjmë një shpartallim tjetër, — tha njëri nga shokët tanë, që njihej si hamësi më i madh i çetës.

— Ti ke lindur për në komunizëm, — i tha intendent me buzën në gaz, kur solli një kanistër me copa buke të prera në pjesë të barabarta. Çuditërisht copat e bukës ishin asnjë më pak e asnjë më shumë, po aq sa ishim ne. Tani, duke kafshuar nga pak bukë, prisnim gjellën. Dhe me të vërtetë erdhi një gjellë që të gjithëve na pëlqente. Ajo s'ishte as në ndonjë kazan apo tenxhere, po intendent i mbante në dorë. Ajo ishte një rrotull djathi kaçkavall, i verdhë dyllë.

— Si në komunizëm, o shoku intendent, na e gjete midenë, — tha hamësi ynë më i madh.

Ai qeshi. Pastaj lëshoi rrotullën e djathit mbi batanije e, prapë duke qeshur, tha:

— Shokë, bukën e keni, ja edhe djathin. Po unë them që djathin të mos e presim e ta shkojmë dëm. Njëllor është sikur e hëngrët. Hani bukën e shihni djathin. Në qoftë se ndonjë ka qejf ta shijojë, le ta fshijë rrotullën me bukë. Njëllor është, sikur e hëngrët.

Ky ishte pra kushëriri i Alush Panajasë, i biri i të cilit tani merrte pjesë në inaugurimin e klubit të gjetisë të fshatit Drizë e pinte raki si makut.

Ai njeri që ishte kaq i ndershëm, kaq i fortë dhe i drejtë, dobësinë më të madhe tani kishte djalin e tij.

\* \* \*

Sekretari i shoqatës, duke parë se mysafiri vështroi me një lloj nepsi derrin e egër, tha:

— Ndjenja e familjes te derri është shumë e zhvilluar. Qysh nga lindja e deri në vjeshtë, vonë, derrkucat rrinë me nënën e tyre dhe ndahen në nëntor, në kohën e kryqëzimit. Në nëntor derrkucët e ndarë nga nëna e tyre bashkohen në tufa të mëdha ose të vogla, me meshkuj 3-vjeçarë ose me dosa shterpa. Meshkujt në moshë mbi trevjeçare jetojnë vetëm. E shihni këtë derr që kemi këtu përpara?

— Pooo, — u dëgjuan zëra.

— Edhe ky, — vazhdoi sekretari, — ushqehet me bar të njomë, rrëzomë fieri dhe rrënjë bimësh. Në rast nevoje konsumon edhe patate e misër, ku bën edhe dëme. Po ama ha edhe mish, sidomos minj, bile edhe këlyshët e lepurit apo kecat e kaprollit.

— Derrat e vrarë, — vazhdoi me padurim drejtori i shkollës, — janë gjahu që prishet më shpejt se çdo gjah tjetër, prandaj, shokë, të mos e lëmë të prishet.

— Të mos e lëmë, — u dëgjuan zëra.

— Të mos e lëmë, — tha sekretari i shoqatës, — po fjalimin e kryetarit ta lëmë të prishet?

— E lëmë në mes, — u dëgjuan prapë zëra.

Kryetari mori prapë në dorë letrat, po kasapi i Drizës i ishte vërsulur derrit për t'i bërë prerjen anatomike.

\* \* \*

Pas një ore, kur derri ishte shndërruar në eshtra, kryegjahtari i krahinës ngriti edhe një doli dhe bëri një propozim që u pranua me duartrokitje.

Dollia që për sukseset e mysafirit në punë, në familje dhe në jetë. Por edhe propozimi që për mysafirin. Ai tha:

— Për nder të mysafirit unë propozoj që sonte të organizojmë një gjueti derri.

Në sallën e klubit, me përjashtim të ujkut, të gjithë duartrokitën. Me duartrokitjet e tyre u bashkua edhe mysafiri.

— Metoda më me rendiment është gjuetia me çuarje, — theksoi sekretari i shoqatës.

— Mos dështojmë, — sqaroi kryetari i shoqatës, — sepse kjo metodë kërkon dëborë.

— Për nder të mysafirit, — vazhdoi sekretari, — të organizojmë një gjueti model për rregull e disiplinë.

Në 14 gjahtarët 9 prej tyre u caktuan çues. Pra katër gjahtarë do të shoqëronin mysafirin që do të vriste derrin. Atij i dhanë çifte, fishekët e së cilës ishin mbushur me saçma 15-she.

Udhëtuan ndonja dy orë e nata po kthellohej. Kur arritën në vendin e gjahut, zunë prita përballë erës. Çuesit ishin zhdukur në anën tjetër të pyllit. Nuk kaloi shumë kohë dhe në pyll u ndie lehja e një qeni. Kryegjahtari,

që rrinte pranë mysafirit, e preku me dorë dhe me zë të ulët i tha të shkonte andej nga dëgjohej zëri i qenit. Në fillim mysafiri nuk lëvizi nga vendi. Po kryegjaktari sa e kuptoi se ai s'kishte ndër mend të shkonte vetë atje, e shoqëroi.

— Derrat e rinj, — i pëshpëriti ai në vesh, — ata që janë një-ose dyvjeçarë, ecin më shpejt se qentë, ndërsa të vjetrit shpesh kthehen dhe e përballojnë qenin.

Në rrëzën e një lirishte të vogël ai pa qenin që lehte dhe derrin që i turrej atij.

— Bjeri! — tha.

Mysafiri ngriti çiftin dhe shtiu. U ndie ulërime e qenit.

— Na vrave qenin, mor i mallkuar, — thirri Sinan Dumani dhe u kthye me inat nga mysafiri. Po mbeti i pataksur nga vrapshpejtësia e tij.

Mysafiri kishte hedhur çiftin përdhe e rendte sa mundte tatëpjetë.



PJESA E DYTE

# Kreu i parë



## NJERIU ME TRI DITELINDJE

Njeriu me rroba bojë qielli pas pjesëmarrjes në dasmë, inspektimit në shtëpinë e pleqve dhe ceremonisë së klubit të gjahtarëve hynte në qytetin me katër porta.

Qytetar Asllan Lalës që atë ditë kryente detyrën e nëpunësit të shërbimit në zyrat e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, i vinte gjumë. Nëpunësi i shërbimit u mundua një copë herë ta mbante veten, po mbi qepallat rëndonte gjumi joshës. Vuri duart në tëmtha duke mbështetur dy bërrylat mbi tavolinë dhe filloi të dremiste. Ai as e dinte dhe as deshi të dinte ç'kishte thënë një Shekspir se gjumi është balsami i shpirtit. Po, ama, sado larg që ishin me mendje

dhe me shekuj këta dy njerëz të të njëjtit rruzull tokësor, kishin arritur në të njëjtin përfundim. E po nuk thonë kot se mendjet e mëdha puçen. Veç kësaj, po ky Asllan nuk mund të dinte dhe as e vriste mendjen të dinte se një i quajtur Ibn Sina, Avicena, nga thellësia shekullore e botës arabe, paskësh thënë se gjumi i përngjet vdekjes. Për më tepër, pasi paskësh arritur në këtë përfundim, bënte dhe thirrje: «O ti, njeri, pse në kohën kur je gjallë kërkon të bësh vepra që u përngjasin të vdekurve?» Po ama një gjë praktike Asllani e dinte; si nëpunës shërbimi mund të marrësh edhe një sy gjumë. Por ja, ç'e do që, tamam në çastet kur nëpunësi i shërbimit, Asllan Lala, kërkoi të bënte një vepër që u përngjiste të vdekurve, na vjen një i gjallë, goxha mashkull, që nuk e la të qetë.

Në timpanet e veshëve të tij iu përplasën dy fjalët:

— Kryetarin dua!

Ato u kapën si «gati-tu» nga truri i përgjumur. Si kundërveprim qepallat lëvizin. Në sytë e tij gjysmë të mje-gulluar, u shfaq një figurë njeriu me syze të zeza që pinte duhan. Në mënyrë të pavetëdijshme, Asllanit i dolën dy rrokje të zvergura:

— Lepe! — sikur të donte t'i thoshte «qetësohu».

Në organin e të dëgjuarit u përplasën prapë fjalët:

— Kryetarin dua!

Ra përsëri qetësi, por njeriu me syze të zeza sa herë e shihte të nevojshme, lëshonte si me bubullimë fjalët «kryetarin dua». U ndal një çast për të ndjekur një dorë që u shkëput prej tëmthit dhe bëri një lëvizje dykohëshe si të një pistonit motori në shuarje e sipër. Kjo lëvizje i thoshte të porsaardhurit se kryetari ishte sipër në zyrë. Për hollësi të tjera as nëpunësi që ishte në krye të detyrës dhe as tjetri që po fillonte shërbimin atij mëngjesi duke kërkuar takim me kryetarin, nuk ndërmoren pyetje dhe nuk kërkuan sqarime të tjera. Nëpunësi i shërbimit prapë u zhyt në botën e gjumit. Por s'ishte e thënë që të kryen-

te në të njëjtën kohë dy punë: edhe shërbimin, edhe gjumin. Në organin e të dëgjuarit erdhën e u ripërplasën me vrazhdësi një palë fjalë të tjera:

— Ti, ç'punë bën këtu?

Gjumi iu tremb dhe iku të fshihej nëpër labirintet e pafund dhe misterioze të trurit. Miliarda qeliza si gardianë hapën e mbyllën dyert e tyre. Ndërsa Asllani i frikësuar, pasi çeli sytë për të marrë vesh ç'po ngjiste përreth, si për t'i dhënë të kuptonte atij zëri se rojë vigjilente mund të jesh edhe duke dremitur, i tha:

— Lepe!...

I panjohuri mori zjarr:

— Po të pyes: ç'punë bën ti këtu?

— Nëpunës shërbimi, — u përgjigj Asllani me gjumë të arratisur. duke parandier që, më pas, do të përballonte një furtunë pyetjesh.

I panjohuri nxori nga buzët vetëm dy bashkëtingëllore: Hëm!

— Lepe! — tha prapë Asllani, si për të kuptuar më mirë se ç'donte të thoshte i panjohuri me këtë «hëm».

Por ky zgjati kokën brenda në sportel, shoi me nervozizëm cigaren mbi taketuken e tavolinës dhe, vetëm pasi nxori kokën jashtë, tha:

— Me një fjalë të kanë vënë nëpunës shërbimi dhe ti fle. Hëm!...

— Lepe! — përsëriti Asllani krejt i hutuar.

— Jo lepe, po thirri kësaj! — vazhdoi i panjohuri dhe vuri me forcë gishtin tregues në tëmth, duke e rrotulluar si turjelë me sa forcë që kishte.

Tamam ai gisht që do të luante rolin e turjelës, jo për të, por për tjetrin, e nxori Asllanin nga stepja. Ndryshe nga i panjohuri, ai nuk e vërtiste gishtin si turjelë, por, duke e goditur me të tëmthin, iu përgjigj:

— Mejtonj!...

— Ti më dukesh sikur sapo ke dalë nga kazani i rakisë.



Asllani u step. Ku e dinte ky i panjohur se gjithë natën kishte zier raki? Ç'do të ngjiste me të? Po prapë s'e dha veten:

— Jo, jo, mejtonj!

— Mendimet lëri për në shtëpi. Këtu kryej detyrën! — vazhdoi tjetri me zemërim.

— Vijnë, mor shok, të shkretat mejtime. Vijnë. Po unë kam zakon që, për t'i kapur më mirë e për të mos i lënë që të më ikin, i mbyll sytë dhe flas me to.

— Gabim i madh, gabim i rëndë. Gabim i pafalshëm. Ti s'lë mendimet të të ikin dhe lë njerëzit të venë në zyrë të kryetarit. Ç'është këtu, han. Hëm...

— Si urdhëron! — u përgjigj me përlësi Asllani.

— Çfarë si urdhëron! — vazhdoi i panjohuri. — Hëm! Pa m'u përgjigj tani me ato «mejtimit» e tua? Cili jam unë, nga vij, ku shkoj, cilat janë arsyet që dua të takohem me kryetarin...

— Ke të drejtë, po unë e bëra nga respekti. Dukesh se je njeri jabanxhi, me punë, me detyra zotrote, me telashe. I njoh njerëzit unë!

— Ti s'njeh asgjë, — tha prapë me inat i panjohuri.

Ra heshtje. I panjohuri ndezi cigaren me një çakmak ngjyrë ari e vazhdoi:

— Detyra mbi të gjitha, shok! Unë po të fal, sepse e ndiej pendimin tënd. Pendimi është hapi i parë drejt njohjes së gabimeve. Pa pendim, s'ka autokritikë dhe, pa autokritikë, s'ka zhvillim.

Në këto çaste bisedën ua prishi një fshatar që, pa pyetur për nervozizmin e djaloshit me syze të errëta e me rroba bojë qielli dhe për hutimin e nëpunësit të shërbimit, i tha këtij të fundit:

— Or shoq, kam një hall e dua ta pleqëroj me krietarin!

Asllani pa nga i panjohuri, sikur ta pyeste. Dhe ky, sikur t'ia kishte blerë mendimin, ia prishi menjëherë:

— Ç'më vështron kështu si hutaq? Ky të shkojë para meje. Ky është masa, jo unë e ti që jemi nëpunës.

Asllanin e qetësuan fjalët e të panjohurit, të thëna me atë ton disi intim, ndaj iu drejtua fshatarit:

— Shko në sekretari, jo zduq-zduq, te kryetari.

— Bukur! — tha i panjohuri. — E sheh ç'bën kritika!... Tani, dëgjo këtu!

— Lepe! — u përgjigj i qetësuar Asllani.

— Merre pak atë hotel turizmin. I thuaj që të më rezervojë një vend të mirë. Hajt, bjeri telefonit!...

— Po çfarë t'i them turizmit? — pyeti nëpunësi që ishte në krye të detyrës.

— I thuaj një dhomë nga të rezervuarat për shokun e deleguar.

— Qenkeni me fat, shoku i deleguar, — tha Asllani. — Kryekamerier atje është im kunat... .

— Në kryerjen e detyrës kunetërit nuk lozin asnjë rol. Familjariteti zhduk kërkesën e llogarisë.

Asllani i ra telefonit dhe, duke marrë krahë nga fjalët e shokut të deleguar, i tha të kunatit, kryekamerier Xanit, në mënyrë të prerë:

— Me urdhër nga lart do të vijë aty shoku i deleguar. Ia bëj nderin tamam, dëgjon?

I panjohuri doli jashtë. Të dy kunetërit vazhduan edhe një copë kohë të flisnin në telefon me njëri-tjetrin.

\* \* \*

Asllani ia filloi përsëri dremmitjes, ndoshta më i qetë se më parë, sepse shoku i deleguar, megjithëse i prishi gjumin, rehatillëkun, në vend të ngjitej te kryetari, mori një drejtim tjetër: ai do të binte në dorën e të kunatit

të Asllanit, që ishte kryekamerier i hotelit më të madh të qytetit. Sa të arrijë në hotel shoku i deleguar, ne po përfitojmë nga rasti t'ju njohim në njëfarë mënyre me Asllanin. Themi në njëfarë mënyre, sepse le të tjerat, por edhe ditëlindje ky njeri kishte tri. Kjo ngatërresë nuk vinte ngaqë Asllani për ditëlindjen ka përdorur kalendarin tibetjan, ku koha nuk matet me vite kalendarike, por me të ashtuquajturit viti i kalit, i tigrin, i demit, i gjarprit, i lepurit etj., por sepse i ati e regjistroi shumë vjet më vonë se viti kur kishte dalë nga barku i s'ëmës. Prandaj, sipas regjistrit themeltar, kur vajti në shkollë ai ishte një vjeç. Mësuesi, pa ditur ç'ditëlindje kishte regjistri themeltar i komunës, në regjistrin e shkollës e shënoi 8 vjeç. Pra, po nga ky regjistër themeltar Asllani duhet të konsiderohet si njeriu i parë në botë që shkollën fillore e ka mbaruar në moshën 5 vjeç. Këtë hile i ati e bëri që të mos e merrnin ushtar. Mirëpo zyra e rekrutimit, kur mbushi moshën, gjithnjë sipas regjistrit themeltar, e thirri ushtar. Edhe pse po afronte të tridhjetat dhe dukej shumë më i madh nga shokët që s'kishin vënë akoma brisk në faqe, meqë rekrutimi nuk merrej me mjekra dhe mustaqe, berberi i qethi kokën njëlloj si të tjerëve dhe kapter Sinani dha urdhrin e prerë: «Tenoseni në këmbësori.»

Përpyekjet e mëvonshme për të rregulluar ditëlindjen i bëri vetë, pa ndihmën e të atit. Si rezultat mundi ta ngrinte moshën 4 vjet. Për rritjen e moshës ai u nis nga një qëllim fisniko-familjar: për të dalë shpejt në pension. Mirëpo ja që edhe ajo nëpunësja e gjendjes civile kur hodhi dëshminë e gjyqit në regjistrin e gjendjes civile, në vend të shënonte ditëlindjen 30 shtator 1928, e lexoi muajin gabim dhe 30 shtatorin e mori 30 shkurt. Kjo i solli një bela tjetër. A ka njeri në botë që të ketë lindur në 30 shkurt? Kërkoj pra përsëri t'i korrigjonin ditëlindjen. Por doli se dëshmitarët që vërtetuan se ishte katër vjet më i madh, ishin të rremë. Mirëpo Asllani i vazhdoi gjurmimet dhe, kur pa-

raqiti dëftesën e klasës së parë fillore, doli se ishte jo 4, po 7 vjet më i madh. Kështu, megjithëse i ati hëngri 7 vjet e dëshmitarët i shtuan 4 vjet, mbeti ajo e mësuesit që i shtoi një vit. Bereqaversën. Një vit më shpejt në pension.

Ky njeri, me tri ditëlindje dhe me asnjë të saktë, s'kishte as origjinë shoqërore të përcaktuar. I ati dilte herë si fshatar, herë si bakall e herë si sekser, bile edhe si polic bashkie. Dhe për më tepër, siç nuk i dihej ditëlindja dhe origjina, ashtu nuk i dihej edhe jeta e tij e mbyllur në familje. Ishin parë nja dy herë gjeometrat e zyrës së urbanistikës duke matur me goniometër rreth shtëpisë dhe ishte hapur fjala se aty do të ndërtohej një bllok apartamentesh, por kjo punë ishte lënë si në harresë.

Asllani kishte mbushur afro dyzet vjet që shërbente si nëpunës i thjeshtë, pa u ndier. Ai s'i binte asnjëri në sy, se edhe të ecurën e kishte të qetë e mezi hidhte një hap, edhe të folurën e kishte të avashëm, edhe të qeshurën të kufizuar. Hynte në zyrë në mëngjes në orarin e caktuar dhe, pasi rrinte tërë ditën mbi shkresa, i mbyllte ato në fund të orarit e, me qetësi, ishte ndër të fundit që dilte nga zyra. Të vetmin argëtim të preferuar kishte tavllën. E luante vetëm me dy shokë. Kur luante njëri me Asllanin. tjetri shikonte, ose e kundërta. Atij që i binte rasti të shikonte, shndërrohej në një lloj arbitri. Mirëpo Asllani i kishte zët llafet, prandaj, sapo arbitri hapte gojën të fliste, ai i lëshonte një «shëët» të zgjatur dhe vendosej përsëri qetësia në dhomën e pritjes ku kërcitja e zareve dhe e gurëve që përplaseshin në tavëll, ishte e vetmja zhurmë që dëgjohej. Kur i iknin bashkëlojtarët, zhvendosej nga dhoma në minderin e kuzhinës. Rrinte aty me orë të tëra herë shtrirë e herë këmbëkryq, derisa e shoqja i sillte darkën që, zakonisht, ishte një përsesh me kos ose me qumësht, apo një terator, një trahana gjysmë e ngrohtë ose një pjatë me patate të ziera e me pak djathë apo ndonjë turli zarzavatesh. Pasi hante, ngrinte kokën, drejtonte sytë

nga televizori, ku priste me padurim të dëgjonte buletin meteorologjik, që ishte një ndër rubrikat e tij më të preferuara. Presionet e ulëta e mërzitnin. Këtë mërzi e shfaqte me uljen e vetullave dhe me një gjysmë belbëzimi që dilte nga buzët: «Pe, pe, mot i keq.» Fjala e fundit s'arrinte të kapërcente as pragun e gjuhës.

Përveç kësaj rubrike, në televizor ndiqte këshillat mjekësore, sidomos ato që transmetohen drejtpërsëdrejti nga studioja numër 1. Këshillat praktike i ndiqte për të shtuar dijet në fushën e kulinarisë. Pasi i dëgjonte, bënte njëfarë përpjekjeje për t'ia shpjeguar së shoqes në formë udhëzimi, mirëpo edhe këto përpjekje mbeteshin gjysmake, sepse një pjesë nuk i mbante mend, një pjesë i ngatërronte dhe, së fundi, edhe përtonte.

Si ishte bërë nëpunës, as ai vetë nuk e dinte mirë, por edhe se ç'detyrë bënte, nuk shqetësohej. I mjaftonte që ishte nëpunës. Merrte një rrogë dhe pikë. Pra ishte një rrogëtar i zellshëm. Dinte se punonte në një seksion të Komitetit Ekzekutiv dhe se atje priste çdo mëngjes punën që do t'i ngarkonin. Kjo punë varej shumë prej shefave që emëroheshin dhe transferoheshin shpesh. Kishte dhe nga ata që e quanin Asllanin njeri të edukuar, sepse nuk kundërshtonte kurrë, pavarësisht në ua plotësonte ose jo urdhrat. Kishte të tjerë që e bënë të mefshët, të plogët, bile edhe dembel e të paaftë. Po ai, sa herë e kritikonin, thoshte me vete: «Si qengji i butë që pi dy nëna, edhe unë do e përballoj këtë përgjegjësi që sot është e nesër ikën, se vjen një tjetër.» Pra, Asllani bënte një punë e merrte një rrogë. Ky ishte një lloj nëpunësi që të linte përshtypjen e një njeriu të lodhur nga puna mbi shkresa, edhe në pamjen e jashtme, edhe me rrobat e tij, me një ngjyrë gati të papërcaktuar. Pra, ky ishte një nëpunës vemje që të qepej qetë dhe zor se të shkulej.

## Kreu i dytë



### **KU ESHTË NDRYSHIMI MIDIS KAMERIERIT E KOZMONAUTIT**

Kur kometa Hallej ishte 200 milionë kilometra pranë Tokës, i panjohuri me emrin shoku i deleguar, i rekomanduar nga nëpunës Asllani, u prit nga kryekamerieri në hollin e hotelit më të mirë të qytetit.

Në qoftë se nëpunës Asllani ishte një dembel, kryekamerier Xani ishte e kundërta e të parit. Ai me shpejtësi rrufeje e vështroi nga koka te këmbët të porsaardhurin dhe, po në çast, mendoi me vete: «Që është një djall ky, është, po ç'djall do të jetë? Madje edhe djalli s'është kaq

i zi.» Rekomandimi me telefon dhe pamja e njeriut që kishte përpara i dukeshin si dy gjëra të kundërta, që s'mund të kishin lidhje me njëra-tjetrën. Sidoqoftë kryekamerier Xani, i rregjur në profesionin e vet, që mund të gjente me intuitë edhe sa lekë kishte klienti në xhep, për të fituar kohë dhe për të marrë vesh se ç'djall ishte ky, pyeti me për-amendim:

— Shoku i deleguar, a u lodhët pak?

— Si të them... — tha i porsaardhuri, që deshi edhe ai ta peshonte njeriun që e priti.

Si të donin të blinin njëri-tjetrin, të dy nxorën paketat e cigareve. Kryekamerier Xani nxitoi të thoshte:

— Janë «Durrësi» të Durrësit, jo «Durrësi» të Shkodrës, siç i keni ju, shoku i deleguar.

Ky i fundit nxitoi të thoshte se ishin speciale, mirëpo e kuptoi se para një kamerieri të tillë të rregjur, kjo do të qe një gafë që do t'i zhvlerësonte lëkurën.

— Kjo tregtia jonë s'di ç'bën, «Durrësi» të Durrësit, «Durrësi» të Shkodrës!

Fjalët për tregtinë i ngacmuan diçka të thellë në shpirt kryekamerierit, por e mori veten aty për aty:

— Tregtia është zanat, shoku i deleguar, zanat tepër i vështirë dhe tepër i rëndë, — dhe e vështroi në sy.

Ai nuk u përgjigj, po në fytyrë iu shfaq një nënqeshje ironike. Kryekamerieri e kuptoi se ky shok i deleguar që u paraqit kaq papritur dhe i rekomanduar nga kunati, Asllani, në këtë hotel, i mori fjalët si një reklamë, prandaj Xani vazhdoi të peshkonte më thellë në trurin e mysafirit, duke i bërë një pyetje krejt të papritur dhe disi ngacmuese:

— Shoku i deleguar, keni shumë në këtë detyrë?

I deleguari, megjithëse i lëvizi një muskul në faqen e djathtë, tha prapë i qetë:

— Edhe shumë jo, po edhe pak jo.

— Suksese e faqebardhë si ngaherë!

Ndërkaq në holl hyri sportelisi. Kryekamerieri i tha diçka në vesh e pastaj iu drejtua klientit:

— Në ç'drejtim e doni dhomën, nga lindja, nga perëndimi, apo nga jugu? Sa për veriun, nuk jua rekomandoj, se natën fryn pak erë e bën pak ftohtë.

— Ku të jetë më mirë, — tha shoku i deleguar.

— Atëherë ma lini mua. Në dhomën 101.

— Mirë, — tha klienti. Dhe thellë në veten e tij lëvrinë ato mendimet e planet që do të fillonte t'i zbatonte menjëherë, bile edhe me këtë kamerier tinëzar, që diç e pandehte veten.

\* \* \*

Pas një ore, i larë e i hekurosur, mysafiri hyri në bar-bufenë e hotelit. Lokali ishte plot, po kryekamerier Xani sa e pa, me shkathtësi i rregulloi një tavolinë në krye të sallës.

— Një ekspres me sheqer në lugë, — tha shoku i deleguar, pa ia vënë veshin menysë, që filloi t'ia tregonte kryekamerieri.

Kur erdhi kafeja, ai filloi ta pinte ngadalë. Në bar-bufe hyri një grup të rinjsh ekskursionistë. Në lokal bëhej zhurmë, po kryekamerieri, me aftësitë e tij, ngriti shpejt e shpejt ca klientë e të rinjtë filluan të uleshin nëpër karrige.

Shoku i deleguar rrinte atje në tavolinë në krye të sallës dhe dukej sikur kishte humbur në mendime e s'vin-te re fare ç'bëhej në bar. E kundërta ngjiste me kryekamerierin. Sapo gjente ndonjë rast, e ndiqte me sy të deleguarin që vazhdonte të hiqej sikur s'e kishte mendjen aty fare. Edhe kur nja dy të rinj ekskursionistë bënë fjalë me



kryekamerierin se u kishte bërë llogaritë gabim, ai as e ngriti kokën të shihte, as për kureshtje. Ishte zhytur i tëri në mendime.

Vonë, kur salla u boshatis, njeriu që rrinte në tavolinën e kryes e thirri kryekamerierin të paguante.

— Shoku i deleguar, kafja për mirëseardhjen në qytetin tonë është nga ana ime.

— Jo, jo, — nxitoi të përgjigjej klienti. — Miqësia miqësi, qesja të vejë e të vijë.

— Do të kemi rast, — tha kryekamerieri dhe, duke e përshëndetur me kokë, bëri të largohej.

Në këtë çast shoku i deleguar tha me një ton autoritar:

— Ulu pak në tavolinë!

— Ju lutem, — u përgjigj kryekamerieri, — nuk na e lejon detyra.

— Detyrën unë e di më mirë se ti, — dhe ia nguli sytë me inat.

«Ç'është kjo kthesë kaq e menjëhershme, — mendoi kryekamerieri, — apo si duket ky ku ngul hunë var hejbetë», — po nuk e bëri veten dhe, disi i turpëruar, për t'i dhënë mikut të kuptonte se, në shenjë respekti për të, po thyente edhe rregullin e detyrës, u ul. Shoku i deleguar nxori paketën «Ds».

— Ndize një «Durrësi» të Shkodrës.

— Jo, më mirë «Durrësi» të Durrësit.

— Do të kemi kohë, — tha shoku i deleguar.

Kryekamerieri rrinte si mbi gjemba. Diçka parandjeu me intuitë. Ndezën cigaret në heshtje. Shoku i deleguar tha:

— Më kanë folur për ty. Dhe ato që më thanë i verifikova vetë këtu, në lokalin ku punon ti si kryekamarier dhe në prezencën tënde dhe timen.

— Ju lutem. Vërejtjet i mirëpresim. Ne jemi shërbëtorët tuaj, të popullit. Por, kur gabojmë dhe kemi një shok që na e thotë, ia dimë për nder. ... Pa dashje, shoku i deleguar!

— Hëm! Pa dashje! Po atij burrit pranë dritares, pse ia more paratë dy herë? Apo pse ishte i dehur?

— Kujt? Për zotin jo! Ai u mat të paguante, pastaj unë ika, se më thirrën të tjerët.

— Edhe ke kurajë të më gënjesh. Po rast tjetër nuk pate sot?

— Unë rast tjetër? Këto janë gabime nga hutimi, shoku i deleguar. Për atë që kam më të shtrenjtë mund t'ju betohem.

— Për betime s'kam nevojë. Të njoha mirë. Po të duash, t'i bëj llogaritë edhe për një muaj.

Kryekamerieri u mundua ta mbante veten, po fjalët e shokut të deleguar sikur i gërmonin thellë në shpirt, sikur e zinin për gryke dhe e shtrëngonin. As ai vetë s'e mori vesh si i shpëtuan fjalët;

— Ndonjë lek e nxjerrim, por, ama, edhe shumë humbasim. Ikin, shoku i deleguar, ikin pa paguar. Ikin e s'vijne më, ikin, dhe një e ikur është buka e kalamajve për një javë.

— Mua mos m'u hidh degë më degë, po bjeri shkurt. E di ti kush është ëndrra e një kamerieri? T'i ketë klientët analfabetë! Prandaj kërko falje, se nga qëndrimi yt do të varet qëndrimi im. Ç'më rri si pus i errët. Pendesa jote më bën të vë dorën në zemër. Në të kundërtën...

— Koka e falur nuk pritet, — tha kryekamerieri dhe u mundua të buzëqeshte.

— Dua të shoh çështjen tënde, — tha njeriu enigmatik.

— Faleminderit! Veç me dorë në zemër, — tha kryekamerieri.

Të dy heshtën për një copë kohë. Heshtnin e ndërkaq të dy mendonin me djallëzi për njëri-tjetrin.

«Makut i djallit», — mendoi mysafiri me vete.

«Maçokëri», — mendoi tjetri për mysafirin.

\* \* \*

Në darkë njeriu me rroba bojë qielli nuk u ul në restorant, por në një sallë të vogël të veçantë. Porosia nuk u bë nga ai. Atë e solli vetë kamerieri: verë të zgjedhur «Kallmet», supë pule e biftek viçi. Ai hëngri me oreks, po nuk u largua nga lokali, derisa u mbyll restoranti dhe erdhi kryekamerieri.

— Sa bëjnë? — pyeti ai dhe futi dorën në xhep.

Po kryekamerieri, në vend të nxirrte bllokun e të bënte llogarinë, u ul në karrigen përballë dhe tha me intimitet:

— Ç'është ajo! Më pëlqyet mjaft si njeri, shoku i deleguar. Se njeriut nuk i hahet mishi, po njerëzillëku. E kemi drejtorin tonë burrë të zotin, po ç'e do, s'është njeri. Qimen ta bën tra.

Kryekamerieri u ngrit dhe solli një shishe verë tjetër. Ngritën një gotë në heshtje, pastaj edhe nga një tjetër për shëndetin e njëri-tjetrit. Solli edhe një shishe verë tjetër. Vera u shtoi oreksin fjalëve dhe biseda erdhi e u ngroh e u bë më intime.

— Rroftë sebepi, — tha kryekamerieri, duke ngritur gotën e verës.

— Rroftë shkaku, — korrigjoi mysafiri. — Kështu duhet të bëhet sipas shkencëtarit dhe gjuhëtarit Nasto, mikut tim të ngushtë që, në këto çaste, sapo mund të ketë mbarruar kumtesën në një simpozium në Holandë. — Pushoi një çast, pastaj tha me intimitet: — Eh, mor Xan, e di ti ç'është Holanda?

*Atje n'Holandë,  
në vendni e mullinjve...*

Këto dy vargje i këndoi shtruar. Xani vështronte mysafirin, sikur donte të kuptonte ç'ishte Holanda, po, në të

vërtetë, ai gëzohej që vera po e shkrinte të deleguarin si ata akujt që i shkrin në pranverë era e jugut atje në viset e Holandës.

Nga Holanda shoku i deleguar u hodh në një temë më të madhe, që s'kishte të bënte as me kontinentin tonë të Evropës dhe as me planetin, po me kometën Hallej, që ato ditë i ishte qasur Tokës në mënyrë kërcënuese dhe tani vazhdonte udhëtimin.

— Ikën, ikën, — tha ai.

— Ikën, ikën, — përsëriti Xani, duke menduar se edhe ky po ikte.

— T'i kishte rënë Hallej Tokës, — vazhdoi shoku i deleguar, — ti, Xan, do të ishte përzhitur si një shishqebap e ne të dy s'do të kishim fatin e madh të takoheshim bashkë.

— Po, po, nuk do ta kishim fatin.

— Hëm, e di ti, Xan, ç'është fati?

— Fati është i shkruar, — tha Xani si me druajtje.

— A, jo, jo, fati është edhe i shkruar, edhe i pashkruar. Ja, unë kam një studim që ndoshta më vonë, kur të kem kohë, do ta paraqes si punim shkencor. Pra, ti, Xan, kam një studim për Makiavelin. Për fatin ai thotë se edhe vetë njeriu e ka në dorë. Posi, e ka vetë njeriu në dorë. Ti, fjala vjen, mund të ishe bërë edhe kozmonaut dhe të ishe përzhitur jo në Tokë nga kometa, po atje lart. Por, duke e drejtuar vetë fatin, u bërë kryekamerier i këtij hoteli me nam. Megjithatë, Xan: :

— Si urdhëron, megjithatë, — përsëriti Xani.

— Edhe kozmonauti, edhe ti keni një ngjashmëri.

— Si urdhëron, ngjashmëri, — përsëriti Xani pa ditur ç'të thoshte po që t'ia bënte qejfin. Se atij ia kishte mësuar zanati që, edhe me njeriun çakërrqejf, të merrej vesh. Për këtë ose duhej të pinte dhe ai, ose duhej të priste që

t'i dilte atij tjetrit e pira. Prandaj rruga më e shkurtër i dukej t'ia bënte qejfin.

— Po e di ti cila është ngjashmëria midis kozmonautit dhe kamerierit? — vazhdoi mysafiri.

— Cila? — pyeti Xani.

— Ndërsa kozmonauti i vërtitet kozmosit, kamerieri u vërtitet klientëve. Njeriu vetë është një mikrokozmos, pra edhe kamerieri mund të quhet një mikrokozmonaut.

Kështu, shoku i deleguar, i stimuluar nga mikroorganizmat e verës, një copë herë të gjatë e tori fjalën rreth mikrokozmosit dhe mikrokozmonautëve. Pastaj i erdhi radha Xanit, i cili s'merrej as me kometa dhe as me raketa. Ai kishte interesa konkretë, ku deshi ta bënte veprimtar edhe këtë «të deleguar», që, edhe pse kishte dyshime, prapë mund ta shfrytëzonte të paktën si kallëp. «Në mos ka aq fuqi sa paraqitet, — mendoi Xani, — do të ketë miq e shokë. Pra prapë me interes jam. Sa për mendjen, ky duket si një kalë i hazdisur që s'ka rënë në pengëz. Pra, ky mund të ishte një nëpunës çunak që i merr gjërat lehtë dhe me lehtësi mund të prishë apo të ndreqë punë. Sido që të jetë, të përfitoj ç'të përfitoj, humbje s'kam.»

I qenë apo i paqenë, Xani i lëshoi atij me gotën e verës përpara të qena e të paqena.

Ai fliste, shoku i deleguar e dëgjonte dhe shtonte rralle e tek ndonjë fjalë si «vazhdo», «po», «hëm». Kryekamerieri i tregoi shokut të deleguar edhe disa gjëra intime të drejtorit, por ai vetëm në fund tha:

— Po të jenë kështu këto që thua, do të më hysh më thellë në zemër dhe, po më bëre mik, dije se kjo miqësi nuk të shkon kot. Por, po të mos jenë, dije se do të t'i nxjerr nga hunda shpifjet.

— I dashur mik, — tha këtë radhë me intimitet, — ti s'e ke njohur Xanin, po, me këtë rast, do të provosh se kush jam.

## KOMPROMETIMI VJEN VJEDHURAZI

Të nesërmen në mëngjes shoku i deleguar shkoi në ndërmarrjen tregtare dhe kërkoi drejtorin. Sapo i dha dorën, i tha:

— Shoku drejtor, jam një korrespondent që kam ardhur për çështjen e një letre që na kanë dërguar për ty. Përpara se të shkoj në instanca të tjera, dua të dëgjoj mendimin tuaj, ta diskutojmë, ta shqyrtojmë bashkë, pastaj, — dhe bëri me duar ca lëvizje, nga të cilat s'merrej vesh ç'donte të thoshte, — Pastaj...

— Urdhëroni, — tha drejtori. — Ato që di do t'jua them si janë.

Shoku i deleguar ndezi një cigare e, duke e thithur me ëndje, tha:

— Shoku drejtor, a është e vërtetë që në janar të këtij viti keni bërë një darkë me disa shokë dhe likuidimin e pjesës më të madhe të shpenzimeve s'e keni bërë akoma?

Drejtori hapi sytë dhe pa me habi njeriun që kishte përpara. Ndenji një copë herë në heshtje dhe, së fundi, lëshoi një «po» disi të vagët.

— Po pse, more shoku drejtor, kështu?!...

Drejtori, njeri punëtor dhe njeri i mirë, prapë nuk i kishte shpëtuar ndonjë komprometimi sado të vogël. U mat të thoshte të vërtetën, por edhe ajo iu duk e rëndë. Megjithatë në njëfarë mënyre ai u hodh në sulm që të mbrohej.

— E di unë kush m'i bën këto, — tha drejtori. — Megjithatë faji është imi, që nuk çova paratë dhe, për këtë, dëgjova këtë farë kamerieri, Xanin, që bëri çmos të mos m'i merrte. Po, ama, këtë gjë mua ma bëri doktor Shemshua, se i pushova të kunatën. Ai për mua shkruan letra dhe s'lë gjë pa thënë. Po, doktori është njeri i skandaleve. Para një jave në zyrën time u rrah me të kunatin e

s'lanë gjë pa i thënë njëri-tjetrit. Ai ha qyl te Xani, se, helbete, ia ka nevojën doktorit.

Shoku i deleguar nxori bllokun dhe mbajti shënimet përkatëse për doktor Shemshon. Pastaj vazhdoi:

— Është e vërtetë se jeni dënuar me gjobë nga inspektori shëndetësor, të cilën ka muaj të tërë që e shtyni dhe s'e paguani?

— Unë e kam kundërshtuar atë gjobë.

— Jo, — tha i sigurt shoku i deleguar, — ju s'keni dashur të paguani.

Ai u ngrit të ikte, por drejtori i tha:

— Në qoftë se do të më dëgjosh, më bëj një nder.

— Urdhëro, — iu përgjigj njeriu me syze të errëta.

— Kam disa ankime për Xanin dhe s'di kujt t'ia them.

Shokut të deleguar i doli në shteg ajo që i interesonte:

— Më mirë se mua s'ke kujt t'i ankoresh!

— Faleminderit, — iu përgjigj drejtori i gëzuar. —

Ai është një batakçi që s'e ka shokun.

— Si, more drejtor, lini njerëz batakçinj në poste kaq të rëndësishme të sferës së tregtisë, siç është kryekamerieri i lokalit më të mirë e më të madh të qytetit?

— Ashtu është, po ai ka miq.

— Pa më thuaj ç'janë këta miq.

— Ata që han qyl.

— Po ti vetë the se ke ngrënë.

— Të drejtë ke, — tha drejtori, i skuqur nga turpi.

— Po ti pse rri e mban sehir një batakçi?

— Nuk varet nga unë ai!

— Pse, nga kush varet një kamerier, përveçse nga drejtori i ushqimit social.

— Jo, jo, varet nga turizmi.

— Ashtu, ë? Mirë, merr pak Drejtorinë e Përgjithshme të Turizmit, t'i shohë ai miqësitë, — tha tjetri i sigurt dhe me inat.

Drejtori kërkoi në telefon Tiranën, po «korrespondenti» u ngrit e tha:

— Nuk kam kohë të pres, prandaj ti m'i shkruaj në një letër faktet konkrete që di për këtë batakçi, se pushimin ia bëjmë që andej.

U ngrit, i dha dorën dhe u nis të dilte jashtë, por drejtori i vente nga pas dhe, në fund të shkallëve, me druajtje, i tha:

— Një kafe s'do ta pimë bashkë?

— Do të kemi rast, — ia preu ai. Tani jam në krye të detyrës. Kur të presin një mijë punë e të zien koka nga telashet, pirja e kafes duket si lodër kalamajsh, ose si shprehje e koncentruar e dembelizmit. Kaq!

\* \* \*

Faktet për doktor Shemshon e joshën, prandaj ai shkoi menjëherë në spital. Pa përfilluar njeri, ai po hynte serioz në portën e spitalit ku prisnin edhe njerëz të tjerë.

— Ku shkon ti, shok? — u dëgjua një zë sapo kapërcëu pragun.

Ai vështroi rojën e tha pak nervoz:

— Kam punë!

— Punë kanë të gjithë. I sheh gjithë këta njerëz? Edhe këta kanë punë, kanë halle, po këtu ka shtëpia zot.

— Ata janë tjetër, unë jam tjetër, s'kam punë personale, po zyrtare, — tha me inat ai.

— Na vjen zotrote? — pyeti i nxehur portieri, ndenjtur mbi stol, duke thithur çibukun e mbushur me duhan gërxhall.


— Nga kometa Hallej, — tha me të tallur Llajni.

— Na kometa e sat ëme! — ia priti plaku, i papërmbajtur për romuzin që i lëshoi.



- Me kë talleh ti? — turfulloi Llajni nervoz.
- Me kë talleh ti! — thirri plaku.
- E di ç'të bëj unë?! — vazhdoi Llajni.
- Unë s'jam trembur na gjermëni, jo të trëmëm na ti, po largohu na porta.
- Dua doktor Shemshon, — vazhdoi Llajni.
- Shemshua është në operacion, prandaj m'u hiq qafe!
- Jam i deleguar, — vazhdoi Llajni.
- I deleguari i kometës Hallej, — tha plaku me qesëndi. — Ehu, sa të deleguar kemi parë na!
- Ti s'më njeh mua, — u përpoq Llajni të merrte veten.
- S'ka nevojë të të njoh. Unë njoh atë, — dhe plaku me çibuk tregoi rregulloren e vendosur në derën e spitalit.
- Prapë Llajni mori zjarr. Po plaku qe më i sertë, prandaj ia preu shkurt. U ngrit e mbylli derën.
- Ta rregulloj unë, — bërtiti me inat Llajni.
- Rregulloja asaj kometës, jo mua, o mynxyrëmadh, — iu përgjigj plaku me përçmim.
- Llajni i ktheu ngadalë krahët portës së spitalit e filloi të zbriste tatëpjetë rrugës.

## Kreu i tretë



### NE FRIGORIFERIN E DYQANIT TË BRETkosAVE Mbyllin kryekamerierin

Ai e mori vesh ngjarjen e mëngjesit, që kryekamerierin e hotel turizmit e kishin mbyllur në frigoriferin e dyqanit të shitjes së bretkosave, por, kur hyri në restorant për të ngrënë drekë, mendoi të mos i binte në sy fare.

Kryekamerieri u lëshua drejt tij, e zuri për krahu, e kaloi përmes sallës së mbushur me klientë dhe e futi në sallëzën e rezervuar. Dukej i shqetësuar, por përpiqej ta mbante veten. Herë shtirej sikur qeshte, herë sikur i tregonte diçka intime, po fjalët nuk i merreshin vesh.

Mysafiri u ul në tavolinë dhe ndezi cigaren.

— Urdhëro një «Durrësi» të Durrësit, — i tha kryekamerieri dhe, si e la paketën në tavolinë, iku t'i sillte darkën.

Menyja për të ishte e njohur. Por këtë darkë bifteku nuk erdhi në pjatë, por në pjatancë. Solli edhe peshk të skarës, raki dhe një shishe me verë «Kabërnët» të Lushnjës.

Ai hante i qetë. Herë pas here, kryekamerieri hynte dhe pyeste:

— Urdhëroni gjë tjetër?

Nga fundi i darkës ai i tha kryekamerierit.

— Peshku do ëmbëlsirën pas, — dhe e pa në sy.

Vuri re se ai u trondit, megjithëse u ngrit dhe solli në një pjatancë një copë kek, një copë tortë e një copë kompekai. Lokali po mbyllej, prandaj kamerieri solli edhe një shishe verë dhe u ul përballë tij. Çokitën gotat e verës dhe uruan njëri-tjetrin.

— I ligu është si qymyri, edhe po s'të dogji, prapë, ta nxin, — filloi bisedën kryekamerieri.

— Është, — iu përgjigj tjetri.

— Bile, i ligu është shumë i poshtër.

— Shumë i poshtër, — pasoi.

— Poshtërsitë e tij nuk i ngre kandari.

— Nuk i ngre.

«Me sa duket nuk ka marrë vesh gjë», — mendoi kryekamerieri, prandaj që t'i hapte bisedën, i tha:

— Konkretisht.

— Doemos konkretisht, joteorikisht, — e ngriti zërin tjetri.

— E di ç'më ngjau sot?

— Jo, — dhe bëri sikur u habit.

— Po ta them fiye e për pe dhe dua jo vetëm të më japësh një mendje, por edhe të më ndihmosh.

— Miku njihet që është mik, në të keq e në rrezik, — vazhdoi Llajni me ton serioz.

— Ashtu është. Të kesh një rrezik a një nevojë ti, unë hidhem në zjarr, për kokën e dy çunave që kam. Ja, mos i gjetsha sonte në shtëpi.

— E besoj, — tha. — Beja dhe zënia emin janë të tepërta. Hajtë të rrojnë çunat e u ngrëncim dasmën.

— Faleminderit, — tha kryekamerieri, duke vënë dorën në zemër. — Ta provosh e ta besosh.

— Do ta provojmë që sonte, — nxitoi të hidhte grepin mysafiri.

— Që sonte, që tani. Mos të kërcënon ndonjë hall?

— Jo. — tha shoku i deleguar. — Hall jo; por kam një nevojë. Edhe luani ka nevojë për miun, jo njeriu për njeriun.

— Miku për mikun, — vazhdoi Xani. — Ne jemi miq. Hap gojën ç'nevojë ke.

— Jo, nuk është ndonjë diçka e madhe. Po në mapon e qytetit më pëlqeu një stof për kostum. Vajta në postë, bëra një telegram, po, sa të më vijnë paratë, ndihmomë ti.

— Llaf është ky? Që tani, hap gojën!

— Ndoshta të bezdisa, por kjo posta jonë i bën veprimet si me breshkë.

— Mos më ofendo, po më thuaj sa para të duhen.

— E ku di unë, po nja 7-8 mijë lekë të vjetër, besoj se mjaftojnë.

— Më prit pesë minuta, — i tha kryekamerieri dhe doli jashtë.

Shoku i deleguar pinte verë dhe hante ëmbëlsira.

Kryekamerieri nuk u vonua, solli paratë dhe i la sipër tavolinës. Ngritën prapë gotat e verës dhe kryekamerieri hyri drejt e në temë:

— Sot më ka bërë një poshtërsi baxhanaku i drejtorit tonë.

— Poshtërsi? Ty, i dashur mik? Më thuaj, se di unë ç't'i bëj atij.

— Posiii... poshtërsi! Baxhanaku i drejtorit, njëfarë Hajrulla, është një kryedallaverexhi që s'e ka shokun. Gjashtë muaj më parë e denoncova se bënte dallavere në shitjen e peshkut. U bënë gati ta pushonin, po miku mik dhe

baxhanaku baxhanak. Megjithatë, me zor iu mbajtën këmbët, por iu mbajtën ama. Ai ma kishte vënë vath në vesh dhe, sot, kur vajta në dyqanin e peshkut, më tha:

— Në qoftë se do ndonjë peshk, hyr në frigorifer dhe zgjidhe, se ka ardhur krap i mirë. Ku dija gjë unë i shkreti. Hapa derën e frigoriferit dhe u futa të zgjidhja peshkun. Kur ... bramp, u mbyll dera. Më futi te bretkocat. Bërtita, po Hajrullai i poshtër mbylli edhe dyqanin e iku e më la aty.

Shoku i deleguar, si për të zhdukur buzëqeshjen që iu shfaq në fytyrë, tha:

— Jooo! Po ti ç'bëre, mor i dashur?

— Ç'bëra? Ç'të bëja! Të rrija duarkryq e të ngrija si krap i? Me shqelma, me bërryla, me se të mundja. Vazhdoi kështu, ku di unë sa vazhdoi, derisa shkallmova derën e dola në dyqan. Kur, ç'të shihja! Dyqani ishte mbyllur. Hajrullai nuk dukej gjëkund, po, ama, para vitrinës na! — dhe bashkoi katër gishtërinjtë me gishtin e madh, — mizëri. Vëllezër, thirra, lajmëroni policinë. Erdhi policia me Hajrullainë përpara, më hapën derën dhe, ja, shpëtova. E di që mund të vdisja atje? Mund të ngrija e të bëhesha tapanxhë?!

— Skandal, — tha tjetri.

— Skandal i madh, — përsëriti kryekamerieri. Po të mos isha i fortë e, po të isha ndonjë humbamento, do të isha bërë bretkocë e tani s'do më kishe në tavolinë, po atje, — dhe bëri me dorë në drejtim të perëndimit, si dukej, andej nga ishin varrezat e qytetit.

— Do ta hetoj çështjen, — i tha pa mundur të mban-te të qeshurën.

Kryekamerieri ndjeu tonin ironik të tjetrit, por nuk e dha veten.

— Megjithatë, hetimin do ta fillojmë që tani, — vazhdoi ai.

— Që tani, — tha kryekamerieri. — Në dispozicion më ke. Pyet të të përgjigjem.

— Ti the se e denoncove për dallavere.

— E denoncova se e meritonte për poshtërsitë që bënte.  
— Po atëherë pse vajte në dyqan?  
— Pse të mos veja?! Mos e kam të ndaluar unë që të ha peshk?

— Po në frigorifer pse u fute?

— Më gënjeu, i poshtri.

Shoku i deleguar, i rënduar nga të ngrënët, përtonte ta zgjaste bisedën, prandaj i tha:

— Kjo është për në gjyq.

— Për në gjyq as që diskutohet!

— Mua më ke me vete dhe nuk do të lë kusur, — tha shoku i deleguar.

Futi në xhep paratë dhe u ngrit. Doli në hollin e hotelit, po kryekamerieri nuk iu nda dhe e ndoqi nga pas deri në dhomë.

— Nesër na pret një ditë e re e mbushur me telashe, i dashur, — tha ai duke i zgjatur dorën si për ta hequr qafe. — Unë do të merrem seriozisht me punën tënde. Po tani le të pushojmë pak, se jemi të lodhur dhe në të gdhirë mendjen duhet ta kemi të freskët.

\* \* \*

Të nesërmen që në mëngjes kryekamerier Xani po e priste te dera e dhomës së hotelit.

— Ti do të bësh menjëherë denoncimin e ngjarjes, ndërsa unë do të bëj veprimet e mia atje, — dhe, duke ngritur gishtin lart, i dha të kuptonte se do të bisedonte me Tiranën.

Kryekamerieri ia përsëriti edhe disa herë ngjarjen dhe, herë duke shfryrë e sharë, herë duke mallkuar dhe u betuar, i lutej dhe i premtonte shokut të deleguar:

— Në qoftë se do të më ndihmosh për këtë, unë do të të blej ç'të duash ti, një frigorifer.

— Të më futësh brenda, — ia priti tjetri.

— Mos bëj shaka, unë e di që s'ke nevojë për frigorifer, ama, të të rekomandoj një vajzë të mirë, për këtë besoj se ke nevojë.

— Vajzë?! — tha i joshur. — Sa vajza më luten, po unë jam kararsëz.

— Po ti shihe një herë.

— I dashur mik, zor për manastirë, pa kallogjerë gjen sa të duash.

— Gjen, gjen, po varet çfarë kallogjerësh gjen, se, të kesh një nuse të bukur, të fisme, me një vjehërr parali, është një fat. Paraja ngre ujët përpjetë. Po edhe bukuria është pasuri.

— Më duket se po e shkel. Mos e tepro! Unë jam kundër parasë, prandaj na, merri edhe këto që më dhe mbrëmë, — dhe u mat të fuste dorën në xhep.


Ai ia mbajti dorën.

— Kështu, pra, mos më fol më për para, më fol edhe një herë për vajzën, për të cilën, ndoshta, e vlen të dëgjohet.

— Vajza është e kumatit tim dhe ka mbaruar Institutin e Lartë të Arteve. Punon në fshatin Dëllinjë, në shtëpinë e kulturës. I ati, domethënë im kumat, punon në komitet.

— Do ta studiojmë çështjen, — tha duke i dhënë dorën. — Tani do të shkoj të ndjek detyrat që kam dhe, sidomos, çështjen tënde.

# Kreu i katërt



## VON MÈHILL BETHOVEN

Ai ishte një njeri teveqel, që nuk zinte vend gjëkund. Bënë si bënë prindërit dhe e shtynë të mbaronte Teknikumin Bujqësor të Kavajës. Kur u kthye në fshat, meqë kishte shkollë të mesme bujqësore, e vunë përgjegjës të normave, po ai, pa filluar mirë punën, u tha:

— S'jam në vendin që më përshtatet mua!

Pas ca kohësh e bënë normist, po ai prapë tha: «S'jam në vendin që më përshtatet mua!» Edhe kur e lanë të merrrej gjoja me investimet, prapë ato fjalë ngrinte e lëshonte. Një ditë tha me zë të lartë:

— Do të bëhet elektrifikimi i fshatit. Kjo punë po, bën për mua.

E çuan në kurs elektrifikuesin e ardhshëm. Kur u bë



përrurimi i dritave, u duk sikur mbi supet e veta mbante tërë energjinë elektrike të hidrocentraleve tona. Dëllinja kishte një kabinë dhe ai mendonte se tani roli i tij këtu nga kjo kabinë do të rritej shumë. Mësuesit e fshatit i ngjijtën nofkën kryeenergjetiku i kooperativës. Kjo nofkë i pëlqeu dhe ai shumë herë bluante me vete: Cili duhet të vijë përpara, kryeagronomi i kooperativës apo kryeenergjetiku? Mendja i thoshte se, vërtet, kryeagronomi ka prodhimin bujqësor dhe kryeenergjetiku vetëm çelësat e kabinës, por ky i fundit ka të bëjë me industrinë dhe industria i prin bujqësisë. Sipas tij, ai i përkiste klasës punëtore fshatare. Sa për të, doemos, duhet të kishte edhe një klasë të tillë. Sa për kryeveterinerin, as që e diskutonte që e kishte nën vete, kurse kryezooteknikun s'e llogariste fare, sepse ai s'ishte gjë tjetër vetëm çoban me një copë diplomë. E ç'duhej diploma për të ushqyer bagëtinë? Bile, edhe çobani bënte një punë më të rëndë se kulloste bagëtitë në mal, kurse zootekniku në stallë.

Këtë kryeenergjetik që i përkiste klasës punëtore fshatare gjeti para kabinës shoku i deleguar kur po zbriste në fshat, atje te Luadhi i Çelos, duke tundur çelësat. Në fillim kryeenergjetiku e mori mysafirin si të dërguar të komisionit të elektrifikimit, dhe e ftoi menjëherë në shtëpi. Në kokë i lindën ca plane të tjera. Duke bërë mik këtë anëtar të komisionit qeveritar të elektrifikimit (për të qenë të saktë, duhet thënë se ky komision qe shkruar prej kohësh), ai si kryeenergjetik, që kishte njohur bazën dhe ishte rrahur me vaj e me uthull me vështirësitë e saj, mendja ia thoshte se kishte ardhur koha që përvojën e tij të madhe, të mbledhur si bleta nektarin, në gjirin e fshatarësisë kooperativiste, ta jepte në kryeqytet.

Llajni, duke e parë atë fytyrë plloçake e të buhavitur, me ata flokë të drejtë e të paqethur, që i zbrisnin deri mbi setrën e tij bojë jeshile me kuadrate të verdha, tha me seriozitet:

— E di që ndodhem përpara një habie, shoku kryeenergjetik!

— Habi, posi, — tha kryeenergjetiku, si për të habitur më shumë shokun e deleguar.

— More, ty të duket çudi habia ime, po ja që po ta them hapur, ti ke një ngjashmëri të çuditshme me Bethovenin.

Kryeenergjetiku qeshi hi, hi, hi,

— Hi, hi, hi, — bëri shoku i deleguar.

— Që jam nxënës i tij si kryeenergjetik, e di, — tha ai. Se vërtet ai shpiku llambën elektrike, po, pa këtë, — dhe tregoi me dorë kabinën pak më tej, — më thuaj, të lutem, si do të punonte llamba. Llambat janë sytë e kabinës, po, ama, kabina është zemra e elektrikut, — dhe prapë qeshi hi, hi, hi.

— A, i dashur shoku kryeenergjetik, ti Bethovenin e more për Edisonin. Jo, jo, ky është një kompozitor i famshëm gjerman, muzikant i dëgjuar në tërë botën dhe mua s'ma merr mendja të mos jenë partiturat e tij edhe këtu në fshatin tuaj.

— Më dashke të mirën, o shoku i deleguar, që më marrke mua për sazexhi, — dhe prapë qeshi hi, hi, hi.

— Jo, — tha shoku i deleguar. — Në të vërtetë është një fat i madh që ti ngjet si Bethoveni. Posiii, fat i madh. Pse, do të thuash, — vazhdoi shoku i deleguar, po këtu s'dinte ç'ti thoshte për fatin e madh, prandaj rrotulloi fjalët nëpër gojë dhe tha: — Posi, fat i madh!

Vështroi menjëherë marangozin e Dëllinjës që kishte ardhur të zihej me Mëhillin që i priste apo i lëshonte energjinë kur i tekej.

Shoku i deleguar e mori veten dhe vazhdoi:

— Që nuk je Bethoveni, kjo dihet, as i vëllai s'mund të jesh, se ata, ndjesë paçin, jetuan këtu e një shekull më parë, por, ama, i nipi mund të jesh.

— Hi, hi, hi, — qeshi teveqeli.

— Qesh, qesh, — tha shoku i deleguar me një ton serioz. — Po e sheh këtë kabinë që drejton ti, shoku kryeenergjitik?... Sikur ta merrnin vesh gjermanët se ti, nipi i Bethovenit, je këtu kryeenergjitik, do të shkulen nga ana e anës e do të vijnë këtu si turistë, për të të parë e për të të takuar. Do të bëhet si me Jerusalemin, me kryqëzatat. Kështu që këtu s'mjafton një kabinë për ta drejtuar, po duhet, në mos një hidrocentral, një termocentral i madh, po e po. Do të hapen hotele e restorante, do të bëhet e ç'do të bëhet, kurse ti, si kryeenergjitik, s'do të kesh kohë, jo t'i japësh drejtim energjisë elektrike, po as t'u japësh intervista të gjithë gazetarëve, bile s'do të kesh kohë as të dalësh në fotografi me të gjithë.

— Hi-hi-hi, — qeshi prapë ai.

— Mos qesh, o Bethoven kryeenergjitik. Po emrin si e ke?

— Mëhill, — i tha.

— Shumë bukur, o Von Mëhill Bethoven.

Marangozi lëshoi një romuz të thekur:

— Po ne, mor mik, mezi po e frenojmë si elektrikist. Me këto që thua ti, ai s'do t'i mbajë frenat fare. Apo s'është një sevdalli i marrosur.

Kryeenergjitiku qeshi: Hi-hi-hi!

\* \* \*

Shoku i deleguar, i shoqëruar nga kryeenergjitiku i Dëllinjës, u nis drejt klubit.

Jashtë po binte mbrëmja. Nga mali zbrisnin tufat e bagëtive të kooperativës. Tingujt e zileve dhe të këmborëve përhapeshin gjithë ngrohtësi në hapësirë.

— Simfonia e 9 e Bethovenit, — tha serioz shoku i deleguar.

Kryeenergjitiku e pa me habi mysafirin dhe, që të mos mbetej pa përgjigje, i lëshoi këto fjalë:

— 9-a s'është asgjë, por edhe 99-a është pak për Dëllinjën.

Malet mbi fshat, të praruara nga dielli, dalëngadalë po humbisnin dritën e tyre e po zymtoheshin. Mbi to po nxirrte diskun hëna, një hënë e plotë, e qetë, me ngjyrën e tunxhit.

— Bukur! — tha papritur shoku i deleguar duke nënqeshur lehtë.

— Hata! — vazhdoi kryeenergjitiku.

Ai e pa vëngër e tha me vete: «Ta rregulloj unë hatanë tënde», prandaj, duke lënë në një anë hënë e malet, zbriti në ca gjëra konkrete.

— Në gjirin e këtyre maleve, në livadhet e lëndinat e tyre kullosin bagëtitë tuaja, që e kanë mishin aq të shijshëm. «Mendje, merr fushat e malet, jashtë nga qyteti», thotë i madhi Naim.

Kryeenergjitiku shikonte mysafirin, që i dukej si një poet i madh, i frymëzuar.

— E di, e di atë «ku mërzen cjapi me zile», — tha kryeenergjitiku. — Atë e këndon im atë e unë i mbaj iso, që të lozë tepeleku i kokës.

— Është hera e parë, — tha me vete i joshur, — që bëhem mik me një shkrimtar. Ky është një fat për mua. Le të vijë Duneranka të marrë vesh se me ç'njerëz kam të bëj.

Por kryeenergjitikut as i shkonte ndër mend që ky shkrimtar, mik i tij, do t'i merrte mendjen Dunerankës së shtëpisë së kulturës, vajzës së adashit të tij, Asllan Lalës, që punonte atje në zyrat e komitetit. Kryeenergjitikut i shkrepë diçka në kokë. Pas klubit do ta çonte mysafirin në shtëpinë e kulturës. Po këtë mendim nuk e vazhdoi më gjatë, se shoku i deleguar tha:

— Bini, moj zile e këmborë, bini, po kryeenergjitiku ju vjen hakut! Apo jo? — i tha, duke u kthyer nga ai.

Kryeenergjitiku qeshi dhe iu përgjigj me mburrje shokut të deleguar:

— Mishi të piqet, hëlli të mos digjet, — dhe prapë qeshi: hi, hi, hi.

— Qenke si unë, materialist, — i tha mikut të tij shkrimtar. — Unë nuk u zë besë fjalëve. Po, po, nuk u zë besë fjalëve. Unë dua prova materiale. Si e kanë barinj të, kur u ha ujku ndonjë dele? Sjellin në fshat lëkurën dhe kockat.

— Ne nuk jemi ujç, miku im, — tha kryeenergjitiku. — Prandaj, si dëshmi, do t'i çojmë Dunerankës hellin bosh, që ta vendosë si zbukurim në shtëpinë e kulturës.

— Mos të duket gjë e vogël hëlli bosh? — tha mysafiri. — Ai hell mund të përfundojë nesër në objekt studiimi për turistët gjermanë, sepse ky është hëlli ku është pjekur mishi, me të cilin, në gjirin e kësaj natyre madhështore, është ushqyer Von Mëhill Bethoveni.

— Edhe kukureci, — tha pa iu përmbajtur gëzimit kryeenergjitiku.

— Kukureci domosdo. Po ku dinë turistët ç'është kukureci, bile as Bethoveni s'ka ngrënë kukurec. Këtë fat e ke vetëm ti. Po nuk më the, sa orë na ndajnë sonte nga ky fati yt i madh?

Kryeenergjitiku nuk i kuptoi mirë fjalët, po tha:

— Bëmë me fat, pa hidhmë në pleh. — Dhe, si të donte të provonte profecinë e fjalëve të tij, vazhdoi: — Urdhëroni një herë në klubin tonë. Ta fillojmë mikpritjen moderne në klub e, pastaj, ta vazhdojmë me popullorë, sipas zakoneve. Se unë, shoku i deleguar, jam njeri modern, që më ka zili gjithë fshati, që merr shembull gjithë fshati nga unë.

— Miku është budalla, — tha me të qeshur shoku i deleguar. — Ai nuk dihet kur vjen, veç sytë i ka në tavolinë e veshët në kuzhinë, kështu thotë një kolegu im, një poet i madh.

— Unë jam nismëtari i dritave të klubit me llamba neon, — tha kryeenergjitiku.

— Jo, more, pse s'thua se po fut modernen në tregti, — tha me ironi.

— Po, po, shoku i deleguar, kam dhënë kontributin tim.

Por, kur hynë në klub, dritat nuk ishin ndezur.

— Ndizi! — i tha bufetierit me ton urdhërues kryeenergjitiku.

— Për inat të diellit? — tha bufetieri.

— Jo për inat të diellit, por për nderin e mikut, — iu përgjigj Mëhilli i nxehur. — Mua më vijnë shokë nga Tirana për të parë elektrifikimin dhe ti më tregon diellin! Dritat që kam unë në zap, s'mund të krahasohen as me diellin, as me hënën, bile as me yjtë.

Banakieri, i cili ia njihte mirë kokën dhe mendjen Mëhillit, që bënte pjesë në gjërat argëtuese të klubit, i tha me romuz:

— Neonet përpara shkëlqimit tënd janë larg si drita e hënës me atë të diellit. Kurse për nga bukuria vetëm një ta kalon në plazh.

Mëhilli i ngazëllyer qeshi hi, hi, hi.

Banakieri lëvizi çelësin dhe dhoma u ndriçua. Drita e llambave neon ra mbi fytyrën e kryeenergjitikut, i cili zhigarepsi sytë.

— Raki me meze! — urdhëroi Mëhilli.

— Dopingo apo teke? — pyeti bufetieri me buzën në gaz.

— Me shishe, — iu përgjigj prerë Mëhilli.

\* \* \*

— Gota e parë për mirëseardhjen, — tha Mëhilli dhe e ngriti atë i pari.

— Dolli? — pyeti mysafiri.

— Jo, — tha kryeenergjitiku. — Këtu shëndet, atje dolli, — dhe bëri me dorë nga jashtë.

— Ku? — pyeti tjetri. — Në gjirin e natyrës?

— Jo, në gjirin e ngrohtë të familjes.

— Natyra është e madhe, — meditoi shoku i deleguar, i mbështjellë nga avujt e gotave të rakisë. Pra, natyra është e madhe, po edhe familja është një natyrë e vogël.

Në klub kishte hyrë kryeagronomi, po kryeenergjitiku nuk e kishte vënë re. Ai i foli, Mëhilli u ngrit në këmbë dhe e prezantoi:

— Është një miku im nga Tirana, — i tha kryeagronomit. — Kurse Taqoja është kryeagronomi i kooperativës sonë.

Shoku i deleguar buzëqeshi me përzemërsi. i shtriu dorën kryeagronomit e i tha:

— Agronomi, thoshte gjyshi im, ndjesë pastë, duhet të vdesë ose në vijën e plugut, ose në vijën e frontit.

Ata qeshën. Qeshi dhe kryeagronomi, se s'dinte ç'të bënte. Mëhilli donte ta ulte me zor kryeagronomin, por ai nuk pranoi. Në këto çaste i erdhi në ndihmë bufetieri:

— Merr një teke raki e meze sallatë, se kanë ardhur tranguj nga qyteti.

Kryeagronomi e kuptoi romuzin, prandaj vazhdoi:

— Ç'më mburresh me trangujt e qytetit kur kemi këtu në fshat.

— Do t'i shartojmë, — tha me seriozitet të shtirë bufetieri.

— Kushedi ç'lloj kastravecash do të na dalin, — tha kryeagronomi.

— Im gjysh, — tha miku i Mëhillit, — solli një herë ca fara trangulli nga Amerika, kur ishte atje si emigrant ekonomik. Po do ti që, kur e mbolli, fara degjeneroi e u bënë jo tranguj, po një lloj kungulli që me zor e hanin edhe bagëtitë.

Kryeagronomi nuk foli.

Intuita i erdhi në ndihmë shokut të deleguar të dyshonte në fjalët që këmbenin kryeagronomi me bufetierin. Ato ishin një romuz për të. Për të kapërcyer, tha me hijerëndësi:

— Njeriu që nuk di të bëjë shaka, nuk është serioz.

Vështroi me radhë fytyrat. U ndal tek ajo e bufetierit dhe i nguli sytë në fytyrën e tij të ngjallur, ku dukej sikur po i shpërthente dhjami mbi lëkurë. Në të pasqyrohej një ironi. «Qen bir qeni, talleh», — mendoi me vete mysafiri e, duke i ngulur sytë, qepallangritur tha:

— E njoh mirë unë zanatin tuaj, se më bie rasti të merrem. Mos pastroni vetëm tavolinat, ku klientët lënë mbeturinat, po pastroni edhe ndërgegjen. Kamarier i zoti është ai që di të kënaqë tri kategori: klientin, shtetin dhe veten.

Kryeagronomi u ngrit se nuk i pëlqeu të rrinte me këta njerëz të ngeshëm që bënë muhabete badihava me gotën e rakisë përpara, po banakierit fjalët e shokut të deleguar i ranë si një pikëpyetje e i ngjallën dyshim.





## Kreu i pestë

### DUNERANKA

— Unë, — tha shoku i deleguar, — detyrat e mia këtu në fshatin tuaj do t'i filloj nga shtëpia e kulturës. S'ke ç'bën, detyra, detyrë. Prandaj më ço atje, të mbarojmë punë e, pastaj, më ke në dispozicionin tënd, se më hyre në zemër.

Tamam në këtë kohë hyri në klub një djalë 15-16 vjeç, i cili seç i tha Mëhillit në vesh:

— Po, po, — i tha Mëhilli, — po tani do të kalojmë një herë nga shtëpia e kulturës ku shoqja Dunerankë do të na argëtojë pak e pastaj do të vijmë për darkë.

Shtëpia e kulturës e kooperativës së Dëllinjës ishte e re dhe e bukur, po më e re dhe më e bukur dukej Duneranka. Atë vit ishte përruar kjo shtëpi kulture dhe gërshtëren për të prerë shiritin për përrimin e saj e kishte mbajtur Duneranka, që sapo kishte ardhur nga Instituti i Arteve, ku kishte mbaruar degën e kulturës.

Duneranka e kujtonte si ngjarje të madhe mbajtjen e gërshtërës mbi tabakanë mbuluar me një copë të kuqe dhe kryetarin e komitetit ekzekutiv që e kishte marrë këtë gërshtërë, kishte prerë shiritin dhe u kishte thënë kooperativistëve :«Ta gëzoni shtëpinë e kulturës!». Pastaj ishte kthyer nga Duneranka e pati thënë: «Siç je e bukur ti, le të jetë edhe kjo shtëpi kulture ku do të punosh.» Ajo e dinte se ishte e bukur, po atëherë e mori këtë vlerësim edhe zyrtarisht nga kryetari, e kujtonte shpesh dhe kënaqej më shumë me veten e saj, sesa me shtëpinë e kulturës. Mirëpo shumë herë, duke dashur që të mos ia kalonte shtëpia e kulturës nga bukuria, e harronte kujdesjen për të e merrej me veten e saj. Edhe i ati, Asllan Lala, i kishte thënë që, të kesh para është fat, të jesh e bukur, është fat i madh. Në ato çaste, ajo nuk e dinte se po venin drejt saj dy fatinj, në mes të të cilëve ndodhej edhe fati i madh. Ndodhej, pra, shoku i deleguar që vinte nga Tirana, bashkë me fatin tjetër, kryeenergjitikun e kooperativës. Gjer tani ajo i buzëqeshte Mëhillit dhe ndahej me të duke përritur vetëm hi-hi-hi, siç e kishte zakon ky ekzemplar i rrallë që i përkiste «klasës punëtore fshatare».

Mysafiri nga Tirana i zgjati dorën i pari Dunerankës dhe i tha emrin:

— Llajn docent.

Mëhilli qeshi se fjalën docent e mori për doç.

— Gëzohem, — tha Duneranka.

— Shoqja drejtoreshë, — tha shpejt e shpejt Mëhilli, — ju prezantoj një mikun tim të ngushtë nga kryeqyteti. Në mes të punëve dhe të telasheve të shumta gjeti

pakëz kohë të më bëjë një vizitë edhe mua, këtu në Dëllinjën e bukur! — Dhe ai i joshur u pushtua nga mendimet dashurore për Dunerankën.

— Gëzohem, — tha prapë Duneranka me buzën në gaz.

— Gëzimi është i përbashkët, — tha Doci. — Ne, kur vijmë në gjirin tuaj, — dhe vështroi me ca sy të perënduar nga koka në fund trupin e Dunerankës, — pra, kur vijmë në gjirin tuaj, e ndiejmë veten të çliruar nga shkresat dhe relacionet, nga zyrtarizmi. Se ja, kemi marrë hijen e rëndë të zyrave, ndërkohë që ju merrni hijen e këtyre pllajave dhe lëndinave, të këtyre krojeve dhe livadheve. Bukuria e natyrës është bukuria më e madhe, po njeriu i zyrave nuk e pandeh se një bukuri e tillë mund të zbresë nga natyra dhe mund të futet këtu, midis sallave të kësaj shtëpie.

— Hi, hi, hi, — qeshi Mëhilli.

— Hi, hi, hi, — përsëriti të qeshurën e Mëhillit edhe Duneranka.

Vizita në shtëpinë e kulturës zgjati mjaft. Nja dy herë të tjera erdhi përsëri djali 14-15-vjeçar, që i thoshte Mëhillit diçka në vesh, po, më shumë se kryeenergjitiku, s'donte të largohej docenti Llajn nga kjo vizitë e këndshme, që, siç deklaroi më vonë, ishte fat që pati nderin të bënte këtë njohje në kohë të papërshtatshme.

Pasi pyeti për sallat e për stendat, për aktivitetet dhe për grupet folklorike, u ndal në mënyrë të veçantë te masovikja e institucionit kulturor të Dëllinjës. Po këtu u hap një kapitull i ri se Llajni u shtir sikur nuk e dinte se e kujt ishte ajo. Dhe kur mori vesh se Duneranka ishte vajza e vetme e adashit të tij, Asllan Lalës, biseda hyri në sferën familjare. Ai, domethënë Llajni, tha se e njihte të atin e saj si burrë të mirë. Për cilësitë e tij, ai do të nisej të bisedonte edhe me kryetarin e Komitetit Ekzekutiv

të KP të Rrethit, po e la për një herë tjetër takimin, sepse, me thjeshtësinë që e karakterizonte vetë Asllanin, kish-te ngulmuar që të mos shkonte te kryetari, por të vente të çlodhej në hotel.

— Do të vij, shoqja masovike, te miku dhe adashi im për vizitë. Do të vij me mikun dhe me shokun tim, Xanin, kryekamerierin e turizmit.

— Ua, — thirri Duneranka e gëzuar, — po unë atë e kam dajë.

— Aq më mirë, ti e ke dajë, unë shok të ngushtë, — — tha Llajni. — Do të vij se është turp të largohem nga qyteti juaj, pa bërë një vizitë tek adashi im. Mirësjellja kërkon mirësjellje. Babai juaj është një nga njerëzit e rrallë për mirësjellje dhe për rigorozitet në detyrë. Ai është një zbatues shembullor i Kodit të Punës. E pa që do të veja te kryetari dhe, menjëherë, me mirësjellje më tha të ngjitesha lart. Po, ama, edhe detyra detyrë. Kur i bëra vërejtje se s'duhej t'i linte njerëzit të ngjiteshin te kryetari, pa marrë identitetin e plotë dhe qëllimin e vizitës, kushdo qofshin ata, bëri autokritikë, posiii ... bëri autokritikë të singertë. Gjithë ai burrë, ndaj të cilit të dy jemi fëmijët e tij në moshë, — dhe vështroi ngultazi nga Duneranka, — bëri përpara meje autokritikë.

Largimi nga shtëpia e kulturës u bë në orët e vona të natës, por, përpara ndarjes, në librin e përshtypjeve ai la këtë shënim:

«Vizitova shtëpinë e bukur të kulturës në Dëllinjë. Më bëri përshtypje të madhe çdo gjë, po sidomos kuadrot e lartë që kanë ardhur të punojnë këtu nga qyteti, për ta bërë fshatin si qytet! Mirupafshim!» Në fund vuri një firmë të gjatë e të palexueshme, pranë së cilës rrinte si një mburojë e heshtur fjala Doc.

## MAJA E EVERESTIT DHE QAFJA E SQEPURIT

Të nesërmen në mëngjes Llajni shkoi prapë në shtëpinë e kulturës dhe u takua me Dunerankën:

— Më falni, kisha një pyetje, — i tha ai tërë për zemërsi.

— Urdhëroni, — iu përgjigj Duneranka e hutuar dhe e gëzuar. «Po sikur...» — tha me vete ajo.

— A keni në bibliotekë librin «Si u dorëzua Everesti»?

Duneranka pa me habi mysafirin e shquar. Çfarë mendonte ajo, çfarë pyeti ai. Se çfarë libra kishte në bibliotekë, ajo nuk e dinte, sepse as që kishte marrë mundimin t'i shihte, pale t'i lexonte, prandaj dhe Llajnit iu përgjigj:

— Na vjen shumë keq, po këtë libër nuk e kemi.

— Si është e mundur, — vazhdoi Llajni, — si është e mundur, kur ju vetë jeni maja Xhumulungma.

— Ë? — u habit Duneranka.

Në këtë kohë në derën e bibliotekës u duk fytyra plloçake e kryeenergjitikut. Ai po qeshte. Po këtë radhë e qeshura që më shumë një zgërdhirje, apo më mirë një skërmitje.

Llajni iu drejtua Mëhillit:

— E di ti, Von Mëhill, ç'është Xhumulungma?

— Xhu, xhu, xhu, — tha Mëhilli, pa larguar skërmitjen nga fytyra.

— Jo Xhu, xhu, xhu, po Xhumulungma.

— Xhu, xhu, xhu bëni ju, — tha me inat, por edhe me druajtje.

— Ne merremi me kulturë, — iu përgjigj shoku i deleguar. — Po të kishe lexuar ti librin «Si u dorëzua Everesti», do të ishe jo vetëm kryeenergjitik i fshatit, por edhe kryealpinist. Po, siç e lamë mbrëmë, meqë ti së shpej-

ti do të transferohesh në Tiranë, unë marr përsipër që kryealpiniste të bëj kryemasoviken e shtëpisë së kulturës. Që sot ne mund të ngjitemi të dy në majën e Sqepurit, që është maja më e lartë e tërë krahinës.

— Po mua s'do të më merrni me vete? — tha i pikëlluar Mëhilli.

— Për ty ka plane të tjera më të mëdha. Ty të pret kryeqyteti, të pret Drejtoria e Përgjithshme e Centraleve Elektrike.

— Vërtet! — tha Duneranka e skuqur. — Do të na e merrni Mëhillin? — dhe nga goja e saj, si pa dashje, shpëtuan fjalët: — Po mua?

— A! — u hodh Llajni. — Për ty kemi rezervuar një fat më të madh. Kur të takoheni të dy me Mëhillin në hotelin pesëmbëdhjetëkatësh, do t'i shtrëngoni dorën njëri-tjetrit si dy kuadro të ardhur nga baza në qendër. Por, ama, mos kujtoni se s'do t'ju marrë malli për fshatin.

— Po si të më marrë malli për fshatin, — pyeti me nxitim Duneranka, — kur unë jam, siç më shihni këtu në fshat?

— Ti, kryeenergjitik, shko një herë nga kabina elektrike, se miqësia miqësi, po puna punë. Në darkë do të vij prapë në shtëpinë tënde. More vesh? Ndërsa tani na lër të qetë të merremi me planet tona kulturore.

Mëhilli doli nga shtëpia e kulturës kokëvarur.

\* \* \*

Duneranka dhe Llajni u ngjitën në majën e Sqepurit. Gjatë rrugës ai i foli asaj gjerë e gjatë për pushtimin e Everestit. Dhe ata të dy, kur pushtuan majën e Sqepurit, lanë aty emblemën e tyre si alpinistë: një copë gur

shtufi, në të cilin, me majën e thikës, shënuan në mes të një zemre dy germa: Ll dhe D.

— Ç'është kjo zemër, — tha Duneranka, si për ta thelluar bisedën më shumë.

— Kjo është zemra e Sqepurit dhe zemra jonë, — tha Llajni.

Ata tani të pranëvendosur nuk soditnin natyrën, po zemrat e njëri-tjetrit. Llajni vështronte bardhësinë e gjoksit të saj të allçinjtë.

Papritur, që prapa një gëmushe, doli Mëhilli. Hapi duart dhe gojën pash më pash dhe nxori ca tinguj si zhurma:

— Xhu-xhu-xhu!

— Hi-hi-hi, — imitoi Llajni Mëhillin.

— Hi-hi-hi, — e shoqëroi Duneranka.

Pastaj që të tre zbritën në fshat. Duneranka ishte e gëzuar, se qe bërë alpiniste. Llajni qe i gëzuar, se kishte shënuar një rekord të ri në alpinizmin e tij, ndërsa Mëhilli ishte edhe i hidhëruar edhe i gëzuar. I hidhëruar se Duneranka, që po thellohej në planet kulturore, s'kishte kohë të merrej me të, dhe i gëzuar se ai do të transferohej në Tiranë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Centraleve Elektrike. Atëherë do ta merrte vesh mirë Duneranka se cilat ishin planet më të dobishme për të: ato të kulturës, apo ato të Mëhillit.

— Sonte do të studiojmë ndikimet e kometës Hallej mbi bagëtitë e Dëllinjës.

— Për Kashtën e Kumtrit e ke fjalën, shoku i deleguar? — pyeti Mëhilli.

— Ju që trashëgoni ndër deje gjak artistësh, nuk e kuptoni kollaj astronominë. Aristoteli i madh i ka ndarë prirjet e njerëzve në tre: në shpirtra shtazore, në shpirtra bimore dhe në shpirtra intelektuale.

— Po unë në cilin shpirt bëj pjesë? — pyeti Duneranka.

— Të rronte sot Aristoteli i madh, me siguri do t'i ndante njerëzit në katër shpirtra. I katërti do të ishte shpirti i Dunerankës, që do të ishte më vete dhe vetëm për një njeri.

— Sa keq! — tha Duneranka.

— Si sa keq. Nuk të pëlqen kjo që them unë?

— Jo, jo, sa keq që nuk rron Aristoteli.

— Nuk rron ai, po jemi ne, — tha serioz Llajni.

Qëndroi hijerëndë në këmbë, ndezi cigaren dhe filloi prapë të sodiste natyrën.

Pati edhe ndonjë në Dëllinjë që foli për këtë veprimtari të re që futi në programet e shtëpisë së kulturës Duneranka, po fshati s'ua kishte ngenë llafeve. Njerëzit ishin të zënë me punët e fushës.





## Kreu i gjashtë

### TRE TË DELEGUAR DHE NJË SHKRIMTAR

Papritur në fshatin Dëllinjë u mblodhën tre të deleguar. Pika që i bashkoi ishte shtëpia e kulturës. Njëri nga të deleguarit ishte nga rrethi. Ai vinte me sihariq se sillte flamurin që kishte fituar kjo shtëpi kulture në olimpiadën e estradave të zonës. Konkurrimi do të bëhej në fshatin Dëllinjë dhe aty do të paraqiteshin tri grupe estradash. Po në vend të tri grupeve, aty erdhën e u mblodhën tri të deleguar. Nga fshati fqinj erdhi e u paraqit një i deleguar i dytë. Ky në të vërtetë kishte shkuar në fshat për të bërë punën prodhuese, por, kur mori vesh se në Dëllinjë do të bëhej kjo ceremoni, e quajti pjesëmarrjen si detyrë të tij për të njohur më mirë realitetin, për të parë entu-

ziazmin e grupeve 'dhe domosdo përparimin e tyre. Domosdo pjesëmarrja e të deleguarit Llajn qe e padiskutueshme. Mirëpo ora 12 që ishte caktuar për ceremoninë ua prishi qejfin të deleguarve. Këtë qejfprishje e shkaktoi i pari kryetari i kooperativës, i cili tha me nervozizëm:

— Neve na digjet mjekra, ju kërkoni të ndizni cigaren. Njerëzit janë në punë, prandaj bëjeni vetë ceremoninë.

Mirëpo në vend të tij erdhi shkrimtari Bulo Mubo, që kishte marrë lejen krijuese.

Dunerankën s'e nxinte vendi nga gëzimi për mysafirët e shquar, por mbi të gjitha mendjen e kishte te Llajni. Mëhilli me një trastë në dorë rrinte pak mënjanë, por me sy ndiqte lëvizjet e Dunerankës. Po Mëhilli gjeti rast, i shkeli syrin Llajnit dhe i tregoi torbën.

— Domethënë, armatosur, — i tha Llajni.

— Ëhë! — iu përgjigj Mëhilli i ngazëlluar.

Si nuk erdhi njeri tjetër, filloi ceremonia. Në krye të sallës së bibliotekës doli i deleguari i rrethit. Po përballë tij, para një stende të madhe, rrinte impozant Llajni. Nëpunësi që bënte punën prodhuese kishte vendin e tij, prandaj vajti e ul në tavolinën e Dunerankës. Mëhilli me çantën në dorë rrinte te dera, ndërsa Duneranka sillej në mes të sallës.

— Shokë dhe shoqe, — tha i deleguari i rrethit.

— Shoqe dhe shokë, — tha me zë të ngritur Llajni.

— Po, po, shoqe dhe shokë, — shtoi shoku i ministrisë.

— Më falni, — vazhdoi i deleguari i rrethit. — Shoqe dhe shokë! Me një ndjenjë gëzimi të papërshkruar kam ardhur këtu t'i dorëzoj flamurin shtëpisë së kulturës të Dëllinjës për suksesin që arriti në olimpiadën e estradave të zonës. — Ai nxori nga çanta flamurin dhe diplomën ia dorëzoi Dunerankës.

Të tjerët duartrokritën. Duneranka tha:

— Jam tepër e emocionuar për këtë nder që na bëtë

dhe ju premtoj se në të ardhmen rezultatet do t'i çojmë akoma më përpara, duke e bërë model shtëpinë tonë të kulturës.

Duke thënë këto fjalë, ajo vërtitej dhe herë drejtohej nga i deleguari i rrethit, herë nga i deleguari i ministrisë, po nga Llajni qëndronte më shumë e buzëqeshte më fort.

Papritur u dëgjua zëri i Mëhillit:

— E po, gëzuar!

Njerëzit vështruan andej nga vinte zëri dhe panë Mëhillin që kishte nxjerrë nga torba një shishe rakië dhe me atë në dorë po i afrohej Dunerankës.

— Në tavolinë, — tha Llajni.

Pjesëmarrësit si me urdhër u mblodhën rreth tavolinës duke çuar secili karrigen e vet. U harrua çanta e të deleguarit të rrethit dhe vëmendja u përqendrua në torbën e Mëhillit.

— Ky është i deleguar për të qenë, — tha shkrimtari Bulo Mubo.

Mëhilli qeshi dhe filloi të nxjerrë nga torba edhe një shishe tjetër, disa gota dhe një qese letre me disa mezera.

Llajni mbushi gotën i pari dhe, i gjatë e elegant siç ishte, u imponoi edhe të tjerëve respekt.

Duneranka tërë shend tha:

— Fjalën e ka shoku Llajn. Është fat i madh që ndodhet në këtë ditë të gëzuar midis nesh.

Gotat trokitën. Llajni mori fjalën.

— Shokë!

Arti është një gjë e madhe. Ja, edhe një fotograf po nuk qe artist të bën një fotografi që jo veten që s'e njeh por të tremb. Ja, shikoni përgjegjësen e këtij institucioni kulturor, diplomanten e Institutit të Lartë të Arteve. Kur e shihni kështu, siç e kemi para sysh, ju gëzohet zemra. Por . . . , por . . . merrni dhe shihni fotografinë e letërnjoftimit dhe do të tronditeni.

Gjindjes i vajti mendja te fotografitë e letërnjoftimit.

Duneranka përdrodi kurmin në shenjë mohimi të fotografisë së letërnjoftimit dhe në shenjë demonstrimi të bukurisë së saj, në atë sallë ku këta njerëz të artit ishin prirur ndaj kësaj bukurie konkrete.

Llajni vështroi kurmin e Dunerankës dhe, duke ngulur sytë në sytë e saj lavroshë, vazhdoi:

— Sikur miku im, Shnajderi, të studionte kombinonë nga fotografitë, do të arrinte në konkluzione të pasakta dhe joshkencore për bukurinë e racës sonë, në gjirin e së cilës vegjetojnë specie të rralla si Duneranka. Sikur ai skulptori i lashtësisë të kishte parë Dunerankën, nuk do të gdhendte në mermer Dean dhe tani do të thoshim jo Dea e Butrintit po Duneranka e Dëllinjës.

Duneranka lëshoi një «a» të prerë, ndërsa Mëhilli qeshi hi, hi, hi. I deleguari i rrethit rrinte vrenjtur.

— Por edhe sikur, — vazhdoi Llajni, — të ndodhte kështu, prapë kjo do të ishte një fatkeqësi. Prandaj ju propozoj ta pimë këtë shëndet për Dunerankën që nuk e kemi mermer po në tavolinën tonë.

U pa të ngrihen gotat dhe u dëgjua trokitja e tyre. Po Llajni qëndronte hijerëndë me gotën në dorë të ngritur lart. Kur pushuan të tjerët, ai lëvizi nga vendi dhe filloi t'i takonte një për një e, duke trokitur gotën me secilin, thoshte me ton serioz:

— Suksese të reja!

— Të rroni sa maja e Sqepurit! — tha Mëhilli i ngazëllyer kur trokiti gotën me të.

— Së bashku me ju, — u përgjigj Llajni.

Kur trokiti gotën me Dunerankën, tha:

— Me fund për...

— Për Dunerankën e Butrintit, — tha shkrintari për fëmijë, Bulu Muboja.

— Për Dunerankën e Dëllinjës, — tha Llajni dhe e piu me fund.

Shoku i ministrisë bëri një vërejtje:

— Të paktën të kishin ardhur amatorët që fituan çmimin.

— More çfarë amatorë! Këtu duhej të ishte gjithë fshati, — tha Llajni. — Kjo është një ngjarje e madhe. Për këtë do të më shihni mua, — vazhdoi Llajni. — Ky është një faj, një gabim i pafalshëm.

I deleguari i rrethit, pasi kishte ngritur nja dy-tri gota, i bërë pak në qejf, tha:

— Vërejtja e shokut në fjalë është me vend. Po unë jam i sinqertë e nuk mund të mbaj gjë përbrenda. Se asëll-asëll, edhe shtëpia e kulturës e Dëllinjës nuk e meritonte flamurin, sepse ajo flamurin e fitoi aforfe.

— Aforfe! — tha i habitur shoku i ministrisë. — Ç'është këtu, olimpiadë konkurimi apo ndeshje futbollit?

— Duneranka i ka të gjitha kushtet që të fitojë edhe aforfe, — tha me ton bindës Llajni.

— Jam i sinqertë unë, o shoku në fjalë, — tha i deleguari i rrethit. — Dy trupat e tjera s'erdhën, po edhe grupi i Dëllinjës nuk e dha shfaqjen.

— Mirë ka bërë, — tha Llajni. — Tërë këto përgatitje që bëri shoqja Dunerankë nuk mund të dilnin në shesh të burrave pa qenë të tjerët. Konkurrim domethënë që ti të matësh forcat me të tjerët. A keni parë ndeshje boksi me një lojtar?

— E po, gëzuar me fund! — tha Mëhilli.

Gotat, si për të mbyllur muhabetin, u trokitën dhe të gjithë pinë me fund.

Biseda e konkurrimit mori fund, po ajo mori zjarr në drejtime të tjera. Ajo u fut në sferën e artit e të letërsisë.

— Për mendimin tim, — tha papritur Llajni, — «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» do të kishte fituar më shumë forcë po të quhej «Gjenerali i ushtrisë së ngordhur».

— Shumë bukur, — tha Duneranka.

Shoku i ministrisë pa me habi.

— Hi, hi, hi, — qeshi Mëhilli. — Po njerëzit nuk

ngordhin, — tha ai si të bënte një zbulim, — ata vdesin, bagëtitë ngordhin.

— A, jo, jo, bagëtitë s'i lëmë të ngordhin, se i therim dhe vihen në shërbim të njeriut në shumë drejtime. Konkretisht. Kjo shpatulla këtu, — dhe Llajni ngriti shpatullën e qengjit.

Ceremonia vazhdonte.

— Sa më i madh është Homeri, — tha shkrimtari, sikur të zbulonte një gjë të re.

— Po pse, Dantja si të duket? — tha shoku i rrethit.

— Shkrimtari që më pëlqen më shumë, — tha Duneranka si të donte të sundonte bisedën, — është, është ...

— Kush? — u dëgjuan zëra me një gojë, po të gjithë, duke pyetur, vështronin kurmin e saj.

— Duneranka, — tha Mëhilli.

Të gjithë qeshën.

— Jo, more Mëhill, jo. Unë nuk e kam shfaqur akoma talentin tim. Se ku ta shfaq, këtu në Dëllinjë?

— Ke të drejtë, moj Duneranka e Dëllinjës, — e mori fjalën Llajni. — Mbi ty, në radhë të parë, duhet të shkrijnë talentin skulptorët dhe piktorët. Pasi ta shkrijnë ata, atëherë del ti me talentin tënd dhe i errëson. Talenti ndjell talentin.

U ngrit imponant me gotë në dorë shkrimtari i letërsisë për fëmijë dhe tha:

— Talenti nuk është grip që të ngjitet. Atë ta dhuron natyra. Këtu në mes të kësaj natyre të mahnitshme dhe të fshatarësisë punëdashëse, unë po mbaroj novelën «Qeni i komshiut».

— Qeni i komshiut, — qeshi «hi-hi-hi» Mëhilli.

— Qeni i komshiut, titull i bukur, — tha shoku i rrethit.

— Qen bir qeni do të ishte më bukur, — tha Llajni.

— Po ju nuk e dini si është fundi tragjik i këtij qeni, — sqaroi shkrimtari.

— Si është? — pyeti Duneranka.

— Si i një qeni. Në fund edhe qenit i vjen ngordhja, — i dha përgjigje Llajni Dunerankës.

— Jo, jo, jam duke e menduar, — vazhdoi shkrimtari.

— Vazhdo ta mendosh, — tha Llajni dhe kafshoi kofshën. U mbllaçit pak si të merrte energji të reja nga proteinat e mishit e vazhdoi: — Ta zëmë se ky qengj i mjerë do të bëhej viktimë e parë e kometës Hallej këtu në Dëllinjë. Por... por... por... ne marrim masa dhe s'e lëmë këtë viktimë të dergjet në sipërfaqen e Tokës. Pra... pra... pra..., mishin e pjekur nga kometa ne nuk e shkojmë dëm, por e hamë me shije e qejf, sepse kështu vërtetojmë me prova konkrete se ajo, domethënë jo Duneranka, por kometa s'ka ç'të na bëjë. — Ai kafshoi mishin dhe fryu bulçitë. — Shokë! Duan të thonë se... se... mishi i pjekur nga kometa ka jone të radioaktivizuara. Po, ka dhe, në qoftë se ka, çfarë? Ka por... por ne kemi kryeenergjitikun, — dhe, me shpatullën e qengjit që e mbante si kobure në dorë, tregoi Mëhillin që rrinte i hutuar. Pastaj vazhdoi në mënyrë urdhërore: — Fol, bre, Von Mëhill Bethoven, se të erdhi radha.

— Fap, — tha Mëhilli duke përdredhur dorën, — Fap, fap, fap!

— Po! Bravo fap!

— Fap! — thirri Mëhilli. — Kometa vjen, po unë, fap dritat (e kishte fjalën për çelësin e kabinës). Dhe kometa ku do të bjerë? Ajo nuk shikon, — iu drejtua Dunerankës e vazhdoi: — Ke parë kometë qorre ti?

Në sallë shpërthyen të qeshura.

— More, ç'është këtu, estradë? — tha nëpunësi i ministrisë.

— A! — tha Llajni. — E shihni, more shokë, ku e ka burimin prapambetja e artit të estradës? Ka të drejtë ai shoku im, dhe unë bëj autokritikë. Po, po, ka të drejtë. Ai u përgatit të mbronte dizertacionin me temë: «Kontra-

diktat joantagoniste midis zhvillimit të estradave dhe pengesave burokratike dikasteriale.» E bëri dizertacionin njëqind e ca faqe, por unë s'e lejova, bile po e themi midis nesh e s'ka nevojë ta bëni për fjalë, e urdhërova. Befel ist befel!¹) Po tani që pashë realitetin me sy, do ta urdhëroj të shtojë një kapitull të ri.

— A ka mundësi të na thoni me mënyrë konfidenciale, — tha papritur shkrimtri Bulo Mubo, — cila do të jetë përmbajtja e kapitullit të ri?

— Posi, jo një kapitull, por disa, por unë shtoj me bindje absolute se një kapitull interesant do të ishte Makiaveli dhe estradat tona!

— Më keqkuptuat, — tha punonjësi i ministrisë që nuk po u jepte dum fjalëve, sepse avujt e rakisë, duke i pushuar hemisferat e trurit, e transformonin bisedën në mënyrë enigmatike.

Duneranka duartrokiti. Duartrokiti edhe Mëhilli. Shkrimtari Bulo Mubo, si të nxiste më tej frymëzimin e tij, ngriti një gotë me fund dhe u thellua në botën ëndërrimtare të talentit të tij.

Muza po më thërret të futem më thellë në këtë subjekt interesant që më doli papritur përpara, — mendoj me vete sikur të bënte një zbulim.

Shkrimtari Mulo Bulo filloi të ndërtonte subjektin në kokën e tij. Fshatari i thjeshtë, Mëhilli, merrej me studimet e mëdha të lëvizjeve ndërplanetare dhe konkretisht me kometat. Ai studion, eksperimenton dhe vërteton se gjer më sot astronomia me teleskopët e shumtë ka zbuluar se 1000 e ca kometa i vërtiten Tokës. Hallej është një ndër më të shquarat. Po bota e madhe dhe me interesa të gjerë e këtij fshatari e nxit atë të merret me Hallejn. Tregim i bukur fantastiko-shkencor, tha i joshur me vete. Sub-

---

1) Urdhëri është urdhër.



jekti u gjet, po personazhet: Mëhilli domosdo. Ai përfaqëson të riun që ka etje për shkencë. Po pse të mos jetë edhe Duneranka?! Ajo përfaqëson të renë intelektuale që e furnizon Mëhillin me librat më të rinj shkencorë që vijnë në bibliotekën e shtëpisë së kulturës. Në këto marrëdhënie intelektuale të zhvillimit lindin midis tyre edhe disa marrëdhënie të tjera. Tregimi mbyllet me një dasmë socialiste që bëhet këtu në shtëpinë e kulturës. Dhe, si të jetonte me fundin optimist të tregimit, mbushi gotën e tha:

— Epo, çifti të na trashëgohet.

— Faleminderit, — thanë me një gojë Llajni. Duneranka dhe Mëhilli.

Gota e rakisë e futi më thellë nga mendimet në meditim shkrimtarin Bulu Mubo. Ai nuk e kishte mendjen fare në zallamahinë që bënë të tjerët. Tani atë e shqetësonte diçka tjetër më serioze. Konflikti i tregimit iu duk pak i zbutur. Pra duhet të forcohet. Mendoj një herë që personazhi negativ që i pengonte marrëdhëniet e këtyre dy të rinjve të ishte i deleguari i rrethit. E vështroi atë. Ai ishte një djalë i shëndoshë, me dy mjekra nga dhjami dhe me syze bikonkave të vogla. Pas tyre sytë i dukeshin më të vegjël dhe strabizmi ia bënte më të çuditshëm dhe enigmatikë. Ai, në këto çaste observimi nga të tjerat, deshi të merrte një këngë. Murmuriste ca fjalë pa kuptim, po njeri s'e dëgjonte. Llajni me Dunerankën flisnin midis tyre gati me pëshpëshe, ndërsa nëpunësi i ministrisë rrinte i heshtur, i menduar e hijerëndë. Vështroi në krah dhe pa Mëhillin që hapte gojën e tij të madhe se rakia i ndillte gjumë. Hm, o personazh pozitiv që hap gojën si guhak, — mendoj aty për aty. Po në qoftë se Mëhillin rakia e fuste në gjumë, shkrimtarit Bulu Mubo ajo ia nxiste nervat, e bënte të papërmbajtur. Prandaj, pa arritur mirë të mendonte që ta ndryshonte personazhin kryesor duke e bërë një tip guhak e gjumash që pengonte Dunerankën, së cilës në tregim do t'ia vinte emrin Katerina, thirri:

— Jashtë gjumashët! Këtu shpërthen entuziazmi, kurse ky kërkon gjumë. Ju jap fjalën se këtë tip do ta kthej nga personazh pozitiv në negativ.

Si një erë e fortë që mposhte erërat e tjera që frynin në sallën e bibliotekës, u gritic Lljajni e tha:

— Ai që nget Mëhillin, ka të bëjë me mua, prandaj, duke pirë një dolli me fund për kryeenergjitik Mëhillin, më lind e drejta të urdhëroj për të prurë këtu sasira të tjera të konsiderueshme rakisë që kjo ceremoni të përfundojë nga negative në pozitive, — tha si për të parodizuar fjalët e shkrimtarit

— Rakinë që rrjedh pikë-pikë, pijeni pa frikë, u dëgjua zëri i shkrimtarit dhe, duke iu drejtuar Mëhillit, vazhdoi: — O veprimtar gjumash, të erdhi fati në derë që të shndërrohesh nga personazh negativ në personazh pozitiv. Përpara! — thirri dhe i dha dy shishe bosh në dorë.

Lljajni kërkoi t'i sillnin çantën e tij.

Duneranka nxitoi, e mori nga rafti ku e kishte vënë e ia solli Lljajnit. Ai e hapi dhe, duke nxjerrë jashtë ca fije letre të shkruara, iu drejtua shkrimtarit:

— Ti je shkrimtar i deklaruar, po unë jam i padeklaruar. Urdhëro lexo një fragment nga shënimet e mia të fundit në Holandë.

Shkrimtari mori fletët e letrave në dorë dhe me sy kurreshtarë filloi të lexonte:

«Anisambli Joko Ono».

Pasi mora pjesë në një grevë, u njoha me proletarin Kristians. Ai më ftoi në shtëpinë e tij dhe «gjatë darkës, e cila kaloi me një atmosferë të përzemërt e miqësore», tregoi këtë histori nga jeta e tij, të cilën unë e hodha në letër.

*«Vaiza ime gjashtëmbëdhjetëvjeçare është kaq elegante e kaq e hijshme, sa edhe papa i Romës, po të kalonte pranë, do të kthente kokën i mahnitur. Megjithatë deri ta-*

ni as ime shoqe e as unë ende s'e kemi përcaktuar se me çfarë i tërheq më shumë të rinjtë ajo: me huret e trupit të saj a me qilarin e vjetër që ngrihet në thellësi të kopshtit tonë.

Adhuresi i parë i vajzës sonë ishte një qaflesh i ri me flokë ca të gjatë sa konia jonë u tremb për vdekje dhe mend iku e frikësuar nga shtëpia kur ai shkeli për herë të parë pragun e derës sonë. Megjithëse balta në oborr ishte deri në gju, mysafiri ynë shprehu dëshirën të vizitonte menjëherë qilarin e vjetër.

— Po këtu s'paska pikë uji! Dhe vend paska boll! Dhe dritë elektrike paska! — thirri qafleshi duke përpjekur duart.

Ai hapi krahët, e përqafoi time bijë që rendi fill pas tij.

— Të adhuroj! — iu drejtua ai vajzës sime. — Ti do të jesh imja gjer në vdekje.

Por, vajmedet, ajo ishte e tij vetëm gjer të enjten, kur unë, pasi u ktheva në mbrëmje nga kinemaja me gruan, pashë para shtëpisë turmën e banorëve që banonin në rruçicën tonë. Ata rrinin duke zënë veshët me duar.

Kur, më në fund, çava grumbullin e njerëzve e hapa derën e qilarit, pashë atje atë qafleshin së bashku me katër lugetër të tjerë dhe vajzën time. Të gjithë dridhnin perçet e tyre, përplasnin duart mbi elektrokitarat me sa fuqi kishin dhe këndonin me ca zëra të egër.

Më në fund munda t'i bind «lugetërit» se pronari i qilarit isha unë vetë, ndaj u kërkova me këmbëngulje që të shporreshin së andejmi një sahat e më parë. Kur ata ikën, m'u duk vetja i shurdhuar, thua se kisha qëndruar plot një orë nën zhurmën e ndonjë aeroplani reaktiv katër-motorësh.

Aty për aty shkrova një lajmërim me germa të mëdha dhe e vara te dera e qilarit: «Ndalohet kategorikisht përdorimi i instrumenteve muzikore.»

—Ti qenke përbindësh, ti qenke i mallkuar, — tha ime bijë. — Po vazhdove edhe në të ardhmen të sillesh kështu, unë do të mbetem pa martuar. Ti do që zemra ime të pëlcase nga vuajtjet!

— Ose zemra jote, ose timpani i veshëve të mi!

Peregrini (më duket se kështu e quanin), një djalë i hollë e i gjatë, më leshtor se i pari, ishte kavalieri i dytë në jetë e vajzës sime që shfaqti dëshirën të shpëtonte zemrën e saj.

— Më duket pak si demode, — vërejti ime shoqe. —  
— Sikur më kujton ato personazhet e operetave të shekullit të kallar.

— Me një kitarist të paktën nuk ngjet, — i thashë unë.

Atë të mërkurë, së toku me gruan, vajtëm në një mbledhje të këshilit të prindërve. Por, pa mbaruar mirë mbledhjen, më thirrën në telefon.

— Ju flet inspektori i shoqatës së mbrojtjes së natyrës së gjallë, — dëgjova të më fliste një zë nga ana tjetër e telit. — Këtu ka ardhur një zonjë, më saktë, një amatore e kafshëve. Ankohet për ju që, pa autorizimin e autoriteteve, keni organizuar një kasaphanë në qilarin tuaj dhe po i therni derrat në mënyrën më barbare.

Kur arritëm në shtëpi, inspektori po na priste në kabinën e një kamioni të madh të mbyllur hermetikisht.

Kësaj here në qilarin e vjetër, së bashku me vajzën time, gjeta edhe dy-tri minifunde të tjera me një grup të vogël qafleshësh. Të gjithë kishin qëndruar te dritarja, kishin nxjerrë kryet përjashta e vështronin nga hëna dhe herë çirreshin e herë ulërinin si mushka të tërbuara.

Me të parë inspektorin me uniformën si të policit, ata u fshehën menjëherë në errësirë.

— Kjo s'është e ndershme! — bërtiti ime bijë të nesërmen në mëngjes dhe në zërin e saj tingëllonte diçka si prej ujku. — Peri nuk përdori instrumente muzikore!

— Ç'ishte nevoja? — kundërshtova unë. — Edhe kë-

shtu kishte zhurmë boll. Ti më mirë na thuaj me çfarë po merreshit.

— Peri kishte qejf të themelonte një kolektiv këngëtarësh me emrin «Avangard». Dhe ne do ta kishim krijuar sikur të mos kishe ardhur ti!..

Osberti, i cili mbante një xhaketë të madhe e të fëlliqur, ishte dashuria e tretë e vajzës sime. Ai u prezantua si përfaqësues i një drejtimi krejt të ri në art.

Kur u kthyem të shtunën nga një ndeshje futbollit, në kopsht mbretëronte qetësia, megjithëse pranë shtëpisë sonë qe mbledhur prapë trumba e fqinjëve.

— Kjo qetësi e tmerrshme është me të vërtetë e padurueshme, — tha një nëpunës i shoqërisë së gazit. — Asnjëri nga ne s'mund të ulet në tryezë për të ngrënë darkë: ne humbasim duke vrarë mendjen ç'do të përmbajë programi i tyre për ditën e sotme.

— Unë i pashë, — shpjegoi fqinja filateliste. — Para një ore ata u futën në qilar, por gjer tani s'kanë bërë asnjë zhurmë... Kjo është e hatashme... As «io-io», as «di-bi-bibi». Poshtë lajmërimit tim varej dhe ky tjetri: (Ansambli «Joko Ono nga Surbitoni: Lutemi mos na pengoni!»

Hapa derën e qilarit. Disa qafleshë të rinj qëndronin në gjunjë gjatë murit. Ime bijë, duke ecur këmbë e duar, vizatonte në dysheme vija të bardha me një copë të madhe shkumësi, ndërsa Osvaldi rrëshqiste prapa saj duke i fshirë vijat me gjoks.

— Ç'po ndodh këtu? — mezi m'u hap goja. — Mos keni luajtur?

— Jo, babi, jo! — m'u përgjigj ime bijë. — Jemi duke bërë provën e kompozitores së shquar japoneze Joko Ono. Kjo vepër është pa tinguj, pa zë, dhe titullohet «Skena me vija».

E quajta për detyrë t'i kërcënoja se do t'i shpija në çmendinë.

— Në qoftë se do të filloni t'u bini instrumenteve, nuk do të ndahem mirë me ju...

— As që kemi ndërmend t'u biem, — u përgjigj turbull Osvaldi. — Ne jemi ushtarë të muzikës pa tinguj, të muzikës që s'dëgjohet me veshë, autore e së cilës është Joko Ono.

— Bukur fort, sër, — vërejta unë, — por, megjithatë...

— Mos ia var atij, Osbert! Mos i vër veshin, se ai nuk merr vesh nga dynjaja, — tha ime bijë dhe shtoi: — Plaku beson vetëm në atë që lexon në «Deili telegraf». Jepi t'i lexojë.

Osvaldi rراسi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe, pasi nxori së andejmi një tufë artikujsh gazete, m'i dha t'i lexoj.

Vajta në kuzhinë dhe nisa të lexoja me zë:

«Mbrëmë për herë të parë Joko Ono demonstroi para londinezëve krijimet e veta. Muzika e saj s'ka asnjë tingull muzikor në kuptimin e pranueshëm të fjalës.

— Qenka feja vetë, — u hodh ime shoqe. — Të paktën do të na pushojnë veshët!...

«Joko Onoja filloi koncertin e saj me pjesën «Skena me vijat», vijova të lexoja.

«Por ja, «Skena me gërshërët» tërhiqte vëmendjen e përgjithshme. Recensuesi shkruante:

Në këtë pjesë Joko Onoja rrinte pa lëvizur, si një figurë japoneze, kurse spektatorët ngriheshin me radhë, në skenë dhe, me gërshërët që ishin afër Jako Onos, prisnin copa-copa fustanin e saj. Në fund të fundit, kompozitorja mbeti ashtu siç e kishte bërë e ëma. Atëherë asistenti i saj i vari në qafë pllakatën me mbishkrimin: «Ky trup është një gërvishtje e arsyes njerëzore.»

«Skena dhe gërshërët»? — klithi papritur ime shoqe. — Por vajza ime qenka e vetmja qenie e seksit femëror në atë qilar së bashku me ata të çmendur!...

— *Lakuriq?! ... Dhe me pllakatin varur në qafë?! —*  
— *tha nëpunësi i shoqërisë së gazit.*

*Mua sikur më mori era e më shpuri te qilari ynë. De-  
ra ishte hapur tej e tej.*

*Ansambli «Joko Ono» ishte zhdukur pa gjurmë. Në  
dysHEME qenë një palë gërshërë të mëdha dhe një grusht  
leckash...»*

Shkrimtari për fëmijë, kur e mbaroi së lexuari, filloi  
të qeshte me të madhe.

Llajni e pa dhe qeshi edhe vetë. Pandehu se qeshja  
e shkrimtarit ishte shenjë e pëlqimit të këtij fragmenti  
nga shkrimet e shkrimtarit të padeklaruar. Por, kur qesh-  
ja vazhdoi, Llajni kureshtar pyeti me padurim:

— Ç'ke që qesh?

— Si të mos qesh, — tha shkrimtari për fëmijë. Dhe,  
duke hapur çantën e tij, nxori një dosje.

— Ja, — tha duke iu drejtuar Llajnit me dosje të ha-  
pur. — Ja, shikoi këto fletë. Është i njëjti shkrim që na  
dhatë ju.

Llajni mbeti i hutuar, por, pa kaluar shumë çaste, tha:

— Le grandë espri se rankontrë!<sup>1)</sup>

Shkrimtari për fëmijë vazhdoi:

— Hiq katër rreshtat që shkruajnë se je takuar me  
proletarin Kristians, të tjerat janë të shkrimtarit anglez  
Mak Stivens.

— E ç'do të thotë kjo? — pyeti Llajni. — Mos vallë  
do të thuash se kemi të bëjmë me një plagjiaturë.

— Sigurisht, sigurisht, — vazhdoi shkrimtari. — Këto  
i kam përkthyer unë, bile ky tregim është botuar në «Hos-  
teni».

— «Hostenin» e bëjmë ne, — tha me ton të prerë Llaj-  
ni. — Po këtu ti, shoku shkrimtar, tregohesh metafizik.

---

1) Mendjet e mëdha puqen!

— Unë metafizik?! — foli i habitur prapë shkrimtari.

Po, — Llajni s'e la të vazhdonte më tej. Prandaj ngri-  
ti zërin e tha:

— Ashtu si vajta unë te proletari Kristians, po ashtu mund të ketë shkuar edhe shkrimtari anglez Mak Stivens. Ngjarjen, pasi ma ka treguar mua, ia ka treguar edhe atij. Domsdo njëlloj do ta shkruanim. Madje unë i propozova proletarit Kristians ta ndërronte emrin nga Kristians në Proletans. Këto i shkruan shkrimtari Mak? Nuk i shkruan! E po këto i ke në vazhdim të tregimit tim. — Llajni zgjati duart dhe i mori fletët që i kishte dhënë dhe i tha pre-  
rë:

— Kur t'i mbaroj shënimet e udhëtimit, do të t'i jap të gjitha, se kështu gjysma s'merren vesh, — dhe me nervozizëm i futi në çantën e tij.

— Po mua do të m'i japësh? — tha Duneranka.

— Pa diskutim, — vazhdoi ai dhe ngriti gotën duke thënë:

— Të pimë për shkrimtarin tonë të deklaruar!

\* \* \*

Kur dolën nga shtëpia e kulturës, ngjau një e papri-  
tur. Përballë, në krye të sheshit, nga një kamion ushtarak po zbrisnin ushtarë të armatosur, të cilët shpërndaheshin në shesh në formacion luftimi. Ushtarët po afroheshin drejt shtëpisë së kulturës me trupin të përkulur dhe me armët në dorë gati që të hapnin zjarr.



Llajni shtangu i pari. Pas tij edhe të tjerët. Duneranka lëshoi një «aaa». Përpara doli një oficer me revolver në dorë dhe thirri:

— Kaput komunisteshën!

— Javol, — u dëgjua zëra.

Llajni u drodh. Mëhilli qeshi hi, hi, hi. Duneranka u fsheh pas Llajnit. Shkrimtari për fëmijë deshi të këndon-te internacionalen, por as melodinë, as fjalët nuk i binin ndër mend. I deleguari i rrethit vështronte i habitur, ndërsa shoku i ministrisë, për çudi të të gjithëve, kishte vënë buzën në gaz.

Në këtë hutim të madh, diku nga sipër kamionit u dëgjua një zë nga një altoporlant dore:

— Popull i Dëllinjës, mos u trembni! S'janë gjermanë prej vërteti. Janë gjermanë të kinostudios, janë gjermanë filmi.

— Filmi, filmi, — tha shkrimtari, — po...

Llajni mori veten e tha:

— E, more ju, pse strukeni e hutoheni si minj nga gjermanët e filmit, sikur të ishin gjermanë të vërtetë?

Regjisorit i pëlqeu kjo skenë:

— Kamera!

Mirëpo Llajni iu turr oficerit dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, i rrëmbeu revolen nga dora.

— Stop! — u dëgjua zëri nervoz i regjisorit.

— Yxhym! — bërtiti Mëhilli.

— Bravo, Llajn, — tha Duneranka. — Tamam si partizan i vërtetë.

Po regjisorit ishte afruar pranë dhe tërë inat iu drejtua Llajnit:

— Më prishe filmin, mor budalla!

— Kujt i thua budalla? — thirri Mëhilli. — Vëllait tim?

— Ta tregoj unë, — tha me të nxehur Llajni.

— Kujt t'ia tregosh ti, sarhosh! — vazhdonte të bërtiste regjisori.

— Që tani jap urdhër të anulohet filmi dhe ti të shkosh nga sytë këmbët, — vazhdonte Llajni.

Po në këtë kohë dy nga artistët e filmit ishin afruar dhe po qeshnin:

— Ç'keni që qeshni? — u bërtiti atyre regjisori.

— Qeshim me Llajnin, — thanë ata me një gojë. — Nuk e njeh ti Llajnin, shoku regjisor. Ai është një birko Tirane e kushedi ç'horrlëqe ka ardhur të bëjë këtu.

Llajni u mat të fliste, lëshoi disa fjalë të shkëputura, po njeri s'e dëgjoi. U dëgjua përsëri zëri i regjisorit:

— Prapsohu!

Birboja filloi të zbriste tatëpjetë sheshit si i mendërosur. Pas tij venin Duneranka e shkrimtari.

Pak më tutje i deleguari i rrethit dhe shoku i ministrisë ecnin të turpëruar.

Mëhilli papritur hapi gojën si kamare dhe, duke u ulur në mes të sheshit, zbrazti ç'kishte në bark.



## Kreu i shtatë

### FATI SIPAS MAKIAVELIT

Shoku i deleguar u kthye nga fshati me ëndrra dhe me plane konkrete. Në hotel e pritë kryekamerier Xani.

— Si ia kaluat në bazë?

— Baza është e mrekullueshme. Të jep fuqi, të përtërin, të mëson dhe të bën më të vendosur në zbatimin e detyrave. Po dhe atje s'më lanë të qetë. M'u desh të luaj një rol të rëndësishëm në një film me të cilin po merret tërë kinostudioja. S'ke ç'bën!

— Po njerëzit e bazës si ishin? — pyeti kryekamerier Xani, duke aluduar për Dunerankën.

Por edhe shoku i deleguar tha me seriozitet:

— Ashtu siç më the, ti i dashur kryekamerier!

— Domethënë, nuk të gënjeva, — iu përgjigj.

— Përkundrazi, kur të vijë nevoja, do të kërkoj ndihmën tënde, — iu kundërpërgjigj.

Xani e ngjiti në dhomë shokun e deleguar.

Tani do të pushoj pak. Sonte do ta gdhij duke shkruar.

— Mos u lodh shumë, — i tha Xani.

— Detyra mbi të gjitha!

Xani zbriti me të shpejtë shkallët dhe shkoi tek i kunati në komitet t'i thoshte sihariqin. Në kohë bluante planet e së ardhmes. E vetmja trashëgimtare e Asllanit, do të martohej në Tiranë. Nesër-pasnesër, s'dihej se ç'bëhej me kunatin dhe shtëpia i mbetej së motrës, me një fjalë atij.

Ndërsa shoku i deleguar bluante në kokë ca plane të tjera më praktike, më konkrete, me afate shumë më të shkurtra. Ai atë natë as do të shkruante e as kishte ndër mend të shkruante, po do të shkonte mysafir në shtëpinë e Dunerankës, ku nuk duhej të vinte as Xani, as ndonjë tjetër. Këtë porosi ia kishte dhënë edhe Dunerankës.

U shtri në krevat i joshur.

\* \* \*

Një javë më parë ai rrinte te një derë e auditorit të degës së merceologjisë të Fakultetit ekonomik ku priste të hynte, për të dhënë provimin e materializmit dialektik.

Ky student që, sipas letërnjoftimit, quhej Asllan Raif Panajaja, thirrej Llajn nga shokët e kursit të tij, ndërsa një vit më parë, kur pati qenë student i Fakultetit të Filo-

logjisë, thirrej Leon. Ky Asllan Raif Panajaja ishte i biri i Alush Panajasë dhe Alushi i biri i Raifit plak. Po djali i Alushit doli në dritë atë ditë që plaku Raif u largua nga kjo botë. Pra, meqë gjysh e nip s'patën rastin të takoheshin, Alushi i vuri të birit emrin e të atit. Mirëpo gjyshi nga e ëma i vuri një emër tjetër, e quajti Asllan. Dy krushqit bënë pak sherr, po shamata u platit e në regjistër u shënuua me emrin Asllan Raif. Po gjyshi nga nëna e thërriste Asllan, ndërsa gjyshi nga babai Raif. Më vonë, kur u rrit, filloi të lëshonte lastarë e të zgjatej si plep kanadez, i pëlqeu një emër tjetër, e vetë u mbiquajt Raf Valone.

— He-he-hè! — tallej gjyshi nga e ëma. — Medemek, emër muderno.

Erdhi një kohë që pronari i emrit u lëkund edhe u quajt Luan. Po kur shkoi në shkollë të mesme me që s'mësoi dot anglisht u vetëquajt në anglisht: Llajn.

Pra tani njeriu me shumë emra priste të hynte në provim dhe çuditërisht, provimin e parë do ta jepte në vitin e dytë të fakultetit ku kishte ardhur. Si ishte bërë ky transferim?

## INTERMEXO

*Nuk është çudi që në kohën tonë ka njerëz që e ndjekin shkollën për modë, me një fjalë për të marrë një diplomë. Mirëpo prapë nuk duket e çuditshme që, pasi merr diplomën, ai s'është në gjendje të bëjë asgjë. Falë aftësisë së tyre, shumë herë ndërgegjja rëndon mbi prindërit, farefisninë dhe miqtë. Por nuk ka gjë më të rëndë, se të ma-*

rrësh diplomën për një specialitet dhe të mos jesh në gjendje ta ushtrosh, sepse s'je i aftë. Pra të kthehesh në një rrogëtar me diplomë. Ka nga ata njerëz që janë të paaftë, sepse — kaq ua pret, — thotë populli, — por ka edhe nga ata që janë bërë të paaftë jo se u mungon zgjuarsia, por i ka bërë të tillë kujdesi i tepruar. Në këtë valle dalin në krye prindërit, po futen farefisi, miq e shokë. U mësohen pedagogëve hollësitë më të mëdha të biografisë së tyre, krushqia e miqtë e shokët që kanë. T'i mbledhësh e t'i shkruash muhabetet, ndërhyrjet dhe fjalët e premtimet që bëhen mik pas miku e shok pas shoku mund të bësh volume më të mëdha se leksionet që do të japë provim i biri në fakultet. Po pse të lodhet fëmija. Tjetër se ai bredh pazarit, hyn klubeve e kafeneve si klient i rregullt dhe ovarda që gëzon simpatinë e kamerierëve dhe të bufetierëve. Mendjehetësia e një prindi ndaj fëmijës i kushton shtrenjtë jo vetëm shoqërisë, por në radhë të parë fëmijës së tij.

Këtë «fat» i përgatitën prindërit Llajnit dhe ky djalë i besoi më shumë fatit sesa punës.

\* \* \*

U hap dera dhe Llajni hyri në provim. Mori tezën dhe filloi të përgatitej. Kur u ngrit të fliste, pedagogu e pyeti:

— Cila është pyetja e parë?

— Rastësia dhe domosdoshmëria.

— Urdhëro, — tha një pedagog. — Foll!...

— Klasikët e marksizëm-leninizmit kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm duke përcaktuar drejt ç'është rastësia dhe ç'është domosdoshmëria, — filloi Llajni. — Pra, sikurse theksuam më lart, këta klasikë të marksizëm-leninizmit e kanë përcaktuar drejt. Shumëkush në botë mund të

thotë se fati është krijuar nga perëndia, në atë mënyrë, që njerëzit në asgjë të mos mundin të veprojnë me mençurinë e tyre, bile, për fatin, s'gjejnë asnjë lloj ilaçi. Nga kjo mund të arrinim në përfundimin se nuk ia vlen të merremi me fatin, ndaj duhet t'i dorëzohemi atij.

Dy pedagogët po dëgjonin me vëmendje, ndërsa Llajni vazhdonte:

— Fatin, shkruan një autor, unë e krahasoj me një nga ata lumenjtë e rrëmbyeshëm, të cilët, kur egërsohen, i përmbysin fushat, rrënojnë pyjet dhe ndërtesat, marrin dheun nga një anë dhe e përplasnin në anën tjetër. Çdo njeri ikën prej tyre, tërhiqet para fuqisë së tyre. Po në qoftë se këta lumenj janë të tillë, kjo nuk do të thotë se njerëzit në kohë të qetë, nuk mund të sigurohen me diga dhe penda në mënyrë që, kur lumenjtë të fryhen më vonë, të shkonin në ndonjë kanal dhe fuqia e tyre nuk do të ishte aq e përmbajtur e aq shkatërruese. E njëjta gjë ndodh edhe me fatin; fuqinë e vet e tregon atje ku nuk gjendet guximi i përgatitur, për t'i bërë ballë, e tregon atje ku nuk janë bërë diga e penda për ta ndaluar.

— More djalë, — tha njëri nga pedagogët, — ne të kërkojmë të na flasësh për domosdoshmërinë dhe rastësinë, jo për fatin.

— Shoku pedagog, unë kam bërë përgatitje të gjerë. Kam studiuar dhe literaturë tjetër. Ja, konkretisht, edhe mbrëmë kur bëra një ripërsëritje të lëndës, m'u desh të zgjeroja njohuritë e mia edhe me disa traktate të Nikolla Makiavelit.

Njëri nga pedagogët pa me habi. Tjetri tha:

— Mirë që ke studiuar, po këtu duhet t'u përmbahesh edhe leksioneve.

— Leksionet janë një gjë e vogël përpara njohurive që duhet të marrë njeriu, për të qenë i denjë të diplomohet nga ky fakultet.

U hap dera dhe brenda hyri një inspektor i shkollave

të larta në Ministrinë e Arsimit. Ngjau e papritura. Inspektori pyeti me habi:

— Po ti, Asllan, ç'bën këtu?

— Po jap materializmin dialektik,

— Duket që ka studiuar, por ka njohuri të shpërndara të pasistemuara, — tha njëri nga pedagogët.

— More, mirë për njohuritë, — vazhdoi inspektori, — po ti përsërite vitin e parë vjet në filologji, nga na dole në vitin e dytë këtu?

Këto shkoi në mendje Llajni tani që rrinte shtrirë.

Ditën e provimit, sipas fjalëve që kishin qarkulluar, ai priste që kometa Hallej t'i binte në qafë njeriut, ndërsa fati e solli që në këto çaste inspektori i Ministrisë së Arsimit po i binte në qafë Asllanit, Leonit, Llajnit.

«Qëllimi e justifikon mjetin, — mendoi Llajni duke u kapur pas këtyre fjalëve të Makiavelit, — Megjithatë, meditoi Llajni, «bëmë me fat dhe hidhmë në pleh», Përpara sonte, o fat!...»

«A ka ngritur diga dhe penda Duneranka, — mendoi me vete. — Duneranka jo e jo. Ajo më harliset se e gjeti fatin, po të shohim i ati, sa për kryekamerier Xanin, ai ngre të tilla, por unë ia rrëzoj se i ka prej kashte.»

Mendja i shkoi në ditën e nisjes.

— Provimet do t'i jap në sezonin tjetër. Tani do të nisem urgjent me një ekspeditë në Veri. Më ka ngarkuar Akademia. Me këto tema mund të bëhem edhe kandidat i shkencave. Ky është një fat i madh për mua, — u kishte thënë prindërve.

E ëma i dha të holla fshehurazi të atit, por edhe ai i dha të holla fshehurazi së ëmës.

Tani Llajni rrinte shtrirë dhe priste të errej për të shkuar atje ku i buzëqeshte fati.



## SKLLAVI I THINJUR I FESE

Asllan Lala rrinte në verandën e shtëpisë së tij, pinte duhan i menduar dhe me një shqetësim të brendshëm. Pjergullat bënin hije. Po binte mbrëmja. Kishte kohë që rrinte aty në verandë, me sytë drejtuar nga dera, e cila prishte të hapej nga çasti në çast e të hynte ai, fati i vajzës dhe i shtëpisë së tij.

Ky Asllan Lala që, edhe pse në letërnjoftim mbante shënimin «i pafë» dhe thoshte se nuk besonte perëndi, në brendësinë e shpirtit ruante të ndrydhur diçka të fshehtë, të mistershme, që s'ia thoshte dot me zë as vetes së tij. Ai pati marrë pjesë në prishjen e tyrbes së qytetit. Edhe këtë e quante fat. «Më shtyu fati, — thoshte i bindur me me veten e tij, — që atë pasdreke dola nga shtëpia dhe takova kryetarin e frontit.»

Kujtonte dialogun, pas dialogut veprimin dhe, pas veprimt, shpërblimin. Ja si kishte ndodhur. Dhe në këto çaste ai riprodhoi me vete atë skenë.

— Asllan, — e kishte pyetur kryetari i frontit, — a do të vish edhe ti me ne?

— Me gjithë qejf, — i pati thënë.

— Ne do të vemë të prishim tyrben e qytetit. Një shëmtim, Asllan. Ajo na rri atje në qendër si një varr. Aty mund të bëjmë një lulishte të bukur, të lozin kalamajtë, të rrinë pleqtë.

Fjala tyrbe i ra Asllanit në kokë si ca ra-ra të zgjatura, sikur iu shkundën trutë, por, prapë fati sipas tij e mësoi jo vetëm të mos fliste, po të shkonte i bindur pas kryetarit dhe të tjerëve.

Kur vajtën atje, ishin mbledhur një bylyk. Hoqi dhe ai një tjegull, objektivi i aparatit fotografik vështronte i qetë mbi grumbullin e madh të njerëzve, po të nesërmen

në fotografinë e një gazete, në mes të tyre, binte në sy Asllani. Kur u prish tyrbja, brenda në të nuk u gjetën kockat e nazarit, po kockat e një kali. Disa thanë se ishin kocka gomari, por, ama, fotografia i vleu Asllanit për shumë punë të tjera. Atë e ruan edhe sot e kësaj dite dhe jo një herë e ka përdorur.

Nuk i dhanë të drejtë studimi për në universitet Dunerankës, se e kishte mesataren tepër të ulët. Po Asllani nxori fotografinë në komitet dhe, shkrap. Kush do ta mësonte e do t'i rrinte në kokë Dunerankës? Unë që prishja tyrbet e xhamitë. Shkrap, shkrap, shkrap. Duneranka vajti në Institutin e Arteve. Po edhe aty shkrap me fotografinë. «Është nga një familje e mirë, prandaj ndihmojeni. Ja, shikojeni, — dhe fap nxora fotografinë.»

\* \* \*

Ky Asllan Lala, që e trumbetonte veten si një luftëtar të vendosur të prishjes së institucioneve fetare, fatit dhe ëndrrave u besonte shumë. Nga bota e përrallave, në mendjen e tij ishin ngulitur «tri fatitë» që i përfytyronte si gra, të cilat, ditën e tretë të lindjes së fëmijës, vinin natën te koka dhe përcaktonin fatin. Prandaj ai thoshte me bindje se çdo gjëje mund t'i shpëtosh, por fatit që të është caktuar, s'i shpëton dot. Edhe tani që Duneranka i shtiu në vesh me anën e s'ëmës gërmat D dhe Ll, që ata i kishin gdhendur si dy alpinistë modernë në majë të Sqepurit, tha:

— Dhe thonë pastaj se nuk i duhet besuar fatit! A nuk është fat ky? Vjen bir i botës nga Tirana dhe, këtu në Dëllinjë, gjen Dunerankën time. Kush e solli këtu atë kapedan? Kush, veç fatit? Domethënë vajzës sime i ishte shkruar fati që të martohej me këtë njeri. Bile, edhe në bririn e bua-

llit të ishte futur ajo, këtë fat kishte të shkruar. Sa u përpoq Mëhilli, por, kur s'është e shkruar, s'është e shkruar, dhe, shkrap.

Tringëlliu zilka në portën e avllisë, u hap dera dhe u duk silueta e Dunerankës me fustanin ngjyrë vishnje. Pas saj vinte Llajni, më i gjatë e më i bëshëm. Ata kaluan përmes oborrit. Te shkallët e verandës u doli përpara Asllani. Duneranka u hoq mënjanë dhe ata i zgjatën dorën njëri-tjetrit.

— Llajn, — tha mysafiri.

— Gëzohem që u njohëm, — iu përgjigj Asllani.

— Ne njihemi bashkë, — vazhdoi Llajni. — Nuk thuhet kot, — kritika është forcë lëvizëse e shoqërisë. Kritika na bëri ne që të njiheshim, të bëheshim miq. Madje, ai që të do, të kritikon.

— Ju lutem, ju lutem, — vazhdoi Asllani i emocionuar, por edhe i ngazëllyer.

— Kritika, a ilaç, a melhem, a balasam, — përforcoi Asllani mendimin e Llajnit.

Ra heshtja. Një bletë erdhi rrotull dhe, në atë qetësi, u ndie zukatja e saj. Ajo u soll një copë herë, sikur t'u mbante iso, pastaj vajti u ul në flokët e Llajnit.

— Sheqer, — tha Asllani.

— Mjaltë, — vazhdoi Llajni duke qeshur.

Asllani u mundua të largonte bletën. Ajo u shkëput nga flokët e Llajnit, po, si për t'u përforcuar mendimet për kritikën, shkoi e nguli thumbin në hundën e Llajnit.

— Bobo, ç'na gjeti, — thirri Duneranka gati me klijthje.

— Mbarësi, — vazhdoi t'i qetësonte viktimën dhe të bijën Asllani.

Llajni, në vend që të ndiente efektin e kritikës, ndjeu dhimbje. Hunda filloi t'i mpihej. Bleta ra përtokë, nën këmbët e Llajnit. Asllani hyri brenda dhe, sa të hapësh dhe

të mbyllësh sytë, erdhi me një monedhë argjendi të «Mbretërisë shqyptare».

— Fërkoje hundën, — i tha Asllani. — Është safi argjend, argjend nga të parët.

Llajni filloi të fërkonte hundën me monedhën e «Mbretërisë», po ajo s'bënte efekt e hunda po i fryhej gjithnjë e më shumë.

Si për t'ia humbur mendjen, Asllani pyeti mysafirin:

— Ku doni të rrimë, në verandë, në sallon, apo në dhomë?

— Ulemi pak këtu në verandë, — tha Llajni i shqetësuar dhe i nevikosur nga dhimbja.

Llajni u ul në një poltronë kashte, fërkonte hundën që vazhonte t'i skuqej e t'i fryhej. Asllani rrinte si ndër gjëmba. Erdhi e shoqja e Asllanit, po asnjë nuk e kishte mendjen për protokollin e përshëndetjes. Ajo kishte sjellë mbi një tabaka tri gliko arre dhe tri gota ujë.

— E ka bërë Duneranka me dorën e saj, — gënjeu Asllani se, në të vërtetë, ajo vetëm kishte qejf ta hante atë, madje, ata e fshihnin prej saj.

Po Llajni, i torturuar nga dhimbjet që po i përhapeshin në kokë, as që e kishte mendjen të glikoja, prandaj tha me nervozizëm e me një tron urdhërues:

— Raki!

— Raki! — urdhëroi Asllani me ton të lartë.

— Raki! — tha Duneranka, duke kryqëzuar duart.

E shoqja e Asllanit solli shishen e rakisë dhe tri gota. Llajni mori shishen, e mbushi gotën dhe e piu menjëherë, prapë e mbushi dhe... e piu, pas gotës së katërt, u duk sikur u qetësua.

— Fërkoje pak edhe hundën me raki, — i tha Asllani.

— Jo, jo, baba, më mirë ta futë hundën në raki, — tha Duneranka. — Kam parë unë kur balsamosin insekte.

Asllani e pa me inat të bijën.

\* \* \*

Pas ndonjë ore dhimbjet e mëdha sikur po i pushonin, po hunda e fryrë filloi t'i ngjante një domateje zemërkau. Sytë i dukeshin të vegjël, dhe, nën, hundë, goja si e një fëmije. Sidoqoftë Asllani s'e kishte mendjen te hunda.

— Hunda është organ i nuhatjes, — tha Llajni, duke e zënë atë me dorë, disi i qetësuar, — por nëna natyrë dërgon bletën dhe ta bën organ të dhimbjes dhe të shëmtimit. Në Kinë, hundët evropiane i kanë qejf shumë dhe, po ta kishin këtë hundën time sot, me siguri do ta vinin në Tempullin e Mrekullive.

Në këto çaste u dëgjua tringëllima e zilkës mbi portë, u hap dera dhe në të u duk silueta e Mëhillit që po hynte brenda. Asllani ktheu sytë me bezdi nga ai. Duneranka u duk sikur hungëriu, ndërsa Mëhilli kaloi i qetë përmes oborrit.

Mëhilli vinte me një zagarr të lidhur që e tërhiqte pas. Asllani u mat ta përzinte, po, në këto çaste, Llajni tha:

— O, Von Mëhill Bethoven! Më gjete pas erës!

Mëhilli qeshi hi, hi, hi, por, kur u afrua, vazhdoi të qeshte edhe më shumë.

— Shoku Llajn, nuk të njoha fare.

— Bleta që bën mjaltë, bën edhe zullume, — tha Llajni.

— Shoku Llajn, — vazhdoi Mëhilli, — sipas premtimit ju solla zagarrin. Fjala e dhënë nuk bëhet dysh.

— Ky është një fat i madh, të cilin do t'ua bëjmë të njohur turistëve, kur të vijnë te ti.

\* \* \*

Mëhilli me zagarrin rrinte më këmbë te shkallët e verandës.

— Sistemojeni pak këtë qenie të botës shtazore, — tha Llajni duke treguar me gisht zagarrin.

— Po unë ç'të bëj? — pyeti Mëhilli.

— Ti të shkosh të punosh, — i tha Llajni, — që, kur të ngjitemi në majën e Sqepurit si alpinistë, të vendosësh një rekord të ri kombëtar.

Mëhilli lëshoi rripin e zagarit nga dora. Asllani e mori zagarin dhe e shpuri në kasollen në fund të oborrit. Mëhilli ndenji edhe pak në këmbë, duke vështruar herë Dunerankën, herë hundën e Llajnit, pastaj, pa folur, ktheu shpinën dhe filloi të ecte ngadalë në oborrin me kalldrëm.

Në verandë ra qetësi. Mysafiri rrinte disi i vrenjtur dhe fytyrën ia mbulonte një hije enigmatike. Të zotin e shtëpisë kjo gjendje filloi ta mundonte. Priste të hapte bisedën mysafiri, por ai s'po hapte as gojën.

— Pse rrini kështu, i dashur mysafir? — i tha më së fundi i zoti i shtëpisë.

— Meditoj, — iu përgjigj Mysafiri.

— Ëë, — tha plot habi vendaliu.

— Meditoj për kometën Hallej.

I zoti i shtëpisë shtoi habinë dhe interesin për muhabetin e thellë që po bënte mysafiri, ndërsa mysafiri vetë, i papërmbajtur në krahët e fantazisë, vazhdoi:

— Këtë kometë zotrote jo e jo, por as unë, as Duneranka s'kemi për ta parë më. Se ajo një herë në 76 vjet i afrohet Tokës. Im gjysh atë e ka parë më 1910 në Çikago të Amerikës, ku kishte vajtur të ngrinte punëtorët në këmbë. Po e dini ju se ç'lidhje ka midis kometës Hallej dhe Dunerankës?

I zoti i shtëpisë pa prapë me habi fytyrën e mysafirit, sikur të donte të gjente në të të fshehtat e fjalëve që po thoshte dhe që lidheshin me Dunerankën e tij.

— Nuk e di ç'lidhje ka midis kometës Hallej dhe Dunerankës? Ta shpjegoj unë. — Dhe ai ia shpjegoi me ndihmën e rakisë.

Në rastin konkret Duneranka është Toka, ndërsa unë jam kometa Hallej, me një ndryshim që unë nuk jam 144 milionë kilometra larg, po vetëm 1 metër.

\* \* \*

Ato që dëgjoi atë natë Asllani nga goja e mysafirit, nuk ua besonte as veshëve të tij. Sidoqoftë ai u bind se gjërat ishin ashtu. Dhe këtë Asllani s'kishte si ta quante ndryshe veçse një fat të madh. Tani Llajni në sytë e Asllanit ishte një gazetar që, edhe pse paraqitej si studiues i folklorit të kometës Hallej, detyrat që kishte mbi shpatulla ky djalë i ri ishin më të pleksura. Ndërsa Llajni vazhdonte më tutje.

— Nuk është punë gazete, — i thoshte Asllanit, andej nga orët e mesit të natës, i stimuluar edhe më shumë nga avurjt e rakisë dhe i kënaqur nga shija e mezeve. — Nuk është punë gazete. Ne punojmë e përgatitemi në gazetë, po rrugën e kemi gjetkë. Këtu bëhet fjalë për jashtë shtetit. Këtë detyrë ka kohë që ma kanë ngarkuar, të martohem, po unë, të them të drejtën, jam njeri pak kararsëz. S'më mbushet mendja kollaj. Më kanë propozuar lloj-lloj vajzash të bukura, me shkollë, bile njërën edhe me para. Kishte një xhaxha në Amerikë, emigrant ekonomik. Më thanë merre, se s'ke ku gjen më të mirë. Një të bërë fejesën dhe hop, vjen çeku gjysmë milionë lek. Posiii... gjysmë milioni me të parë, se, më vonë, sa të doja unë. Ajo kishte mbaruar për anglisht, ndërsa e ëma ia kishte mësuar ujë frëngjishten. Me një fjalë vlente edhe për detyrën time. Se ja, shkon jashtë, në pritje të mëdha, gruaja flet herë frëngjisht, herë anglisht, si t'i vijë mbarë. Mirëpo jo që mua s'm'u mbush mendja për muaj të tërë. Kur pashë Dunerankën, sikur më bëri magji njeri.

— Është fati, — tha Asllani, — këtu e kishe të shkruar.

— Ke të drejtë. Fati është i shkruar dhe s'e ndërron dot as perëndia.

— Perëndia, — shqiptoi Asllani, pa ditur ç'të thoshte më tej.

— Po, po, perëndia, — vazhdoi tjetri.

— E po, në mos perëndia, një fuqi e mbinatyrshme.

— Është kjo fuqi e mbinatyrshme që më pruri mua në Dëllinjë, për të gjetur Dunerankën.

Asllani, ky skllav i thinjur i fesë, ndjeu një ngazëllim edhe më të madh në shpirt. Dhëndri i tij, me tërë atë kulturë e shkollë, ishte i një mendjeje me të. Megjithatë, i joshur nga fjalët që dëgjoi, nuk e la punën me kaq, po u përpoq ta betononte edhe më tej.

— Për para mos u bej merak. Unë kam menduar për Dunerankën, se një vajzë kam. Edhe atë ma kanë kërkuar shumë, bile na u vardis para ca kohe djali i një ministri që e kemi këtej, nga anët tona. Edhe ai e kërkonte se do të shkonte jashtë. Duneranka jo e jo, që s'desh, po as unë, dhe ime shoqe që hidhej përpjetë. Një tjetër, ç'të them, me përgjegjësi të madhe këtu, më erdhi në shtëpi, si për muhabet gjoja, po mendjen e kishte te Duneranka. E donte për djalin që qe specializuar në Francë për fizikë bërthamore, po, kur s'është fati, s'bëhet gjë. Bile, kur na erdhi e na tha Duneranka kështu e kështu, ime shoqe kryqëzoi duart dhe na tregoi ëndrrën që kishte parë.

— Po mua më pa në ëndërr? — tha Lljajni me qesëndi.

— Po, po, edhe mua më dalin ëndrrat një me një, — vazhdoi Asllani. — Pardje të pashë në ëndërr. Ja, tamam ti ishe. Sot po të shohim këtu përpara syve. Fati të shfaqet lloj-lloj formash. Të shfaqet edhe si dervish. Një herë mua m'u shfaq si breshkë. Ai qe fati im. Hë, si thua ti, t'i bija me shqëlma? Fatin s'e përze njeriu, se pastaj zemërohet ai dhe mjerë ti...

\* \* \*

Kulmi i gëzimit të Asllanit arriti nga ora dy pas mesnate, kur dhëndri i shpjegoi se emrin e kishin njëlloj. Se



Asllan në turqisht do të thotë Luan dhe Llajn anglisht do të thotë Luan. Pra, të dy ata kishin një emër: Luan. Të dy Luanët u përqaftuan dhe u puthën, duke ngritur dolli për njëri-tjetrin.

Po ndërsa luan Asllani mendonte për planet e ardhshme, luan Llajni mendonte se kur do ta dehte me raki vjehrrin që të bënte ca veprimtari kulturore në atë natë të këndshme atje në shtëpinë e bukur me pjergulla.

— Për ku rruga mbarë përgatiteni? — pyeti i vjehri dhëndrin.

— Për në Rejkjavik, — tha në mënyrë serioze shoku i deleguar.

Fjala Rejkjavik ra si një hutim mbi Asllanin. Ai e mori për Ravonik.

— Ku? — pyeti Asllani.

— Në kryeqytetin e Islandës. Këto janë gjëra të brendshme.

— Fjala jote në vesh të allahut, — tha Asllani. — Ja, — dhe tregoi gojën e tij, — kjo është pus.

— Pse kam besim të plotë, po ta them. Mos më shih mua të ri. Unë jam më i fshehtë se fshehtësia, por vjehrrin e kam baba dhe babait nuk i fshihet gjë. Këtë edukatë kam nga babai im.

— Të rrojë e ta kemi me ymër!

— I dashur baba, — tha shoku i deleguar, — a ka mundësi t'i jap disa porosi Dunerankës sime.

— Posiii, posiii! — por pastaj ndenji i menduar dhe tha: — Duke qenë edhe unë midis jush, bijtë e mi.

Llajni qeshi fort. Asllani rrinte i hutuar. Llajni vazhdonte të qeshte, duke mbajtur ijet. Më së fundi, pushoi.

— Ç'ke që qesh, mor... — por këtu u përmbajt se do t'i thoshte fjalën gomar.

— Si të mos qesh, — tha Llajni, — si të mos qesh!

— Si të qeshësh? — pyeti Asllani.

— Si të mos qesh. Po ti s'më lejon që me Dunerankën

tënde të flas një fjalë në shtëpinë tënde, kurse ajo, e zeza ajo, dëgjon shakatë e Mëhillit.

Asllani u vrenjt e tha:

— E di punën e Mëhillit.

Llajni qeshi si Mëhilli: Hi, hi, hi!

— Po Mëhilli bën nga pak dashuri me tët bijë.

— Si? — pyeti i çuditur Asllani.

— Shët! — tha Llajni.

— Unë e vras, — tha Asllani.

— Unë e marr për grua, — tha shoku i deleguar.

Ra një qetësi e madhe. Asllani rrinte i tronditur, Llajni rrinte i përgatitur.

— Brompt, — tha Llajni, — po do ta pimë me fund.

— Nuk pi raki, — tha Asllani.

— Për Dunerankën.

— Duneranka!... — tha Asllani, i nxehur nga provokacioni i Llajnit.

— Jo, — vazhdoi shoku i deleguar. — Duneranka është e shkëlqyeshme. Dhe ky shkëlqim, vjen se, në gjakun e saj, zien gjaku juaj fisnik.

— Oxhaku buxhak nuk bëhet, — theksoi Asllani.

— Si urdhëron, oxhaku buxhak nuk bëhet, — përsëriti mysafiri. — Prandaj të pimë tri gota me fund për oxhakun e Lalajve.

Asllani ra në mendime. Oxhaku i Lalajve po merrte një shkëlqim të ri dhe këtë shkëlqim po ia jepte vajza e tij e vetme, Duneranka.

— Po mirë, — tha Asllani.

— Po mirë, — vazhdoi Llajni.

— Po mirë, — tha dhe Duneranka. — Po celebrimin.

— Celebrimin? Kur të duash. Që nesër në mëngjes.

\* \* \*

Ata shkuan në zyrën e gjendjes civile të qytetit. Asllani kishte marrë me vete nja dy kuti llokume. Duneranka qe veshur me një fustan pranveror. Mbi supe kishte hedhur një triko bojë rozë me trëndafila të kuq. Ndërsa në këmbë një palë sandale të bardha. Llajnit, veshur me kostumin bojë qielli, i shkëlqente një këmishë e re e bardhë me erë bar molash.

Bashkë me ta ishin dy dëshmitarë: kryekamariet Xani dhe një mik tjetër që e kishte gjetur Xani, por, që asnjeri nuk i dinte as emrin, as ku punonte dhe as e kishte parë ndonjëherë, jo vetëm Duneranka, por edhe Asllani.

Ata po prisnin të gjithë në këmbë të emocionuar, derisa nëpunësja e gjendjes civile nxori përpara regjistrat dhe dokumentet e tjera. Ajo e vështroi çiftin që do të bënte celebrimin, pastaj të atin e vajzës, dëshmitarët e tha:

— Letërnjoftimet, ju lutem.

Kryekamerier Xani e nxori i pari dokumentin e identitetit e ia dha në dorë. Pas tij e nxori Asllani, Duneranka dhe dëshmitari tjetër i panjohur. Llajni po kërkonte nëpër xhepa. Të gjithë sytë i kishin përqendruar tek ai. Po Llajni, si futi disa herë duart nëpër xhepa, u kthye mënjanë dhe kontrolloi çantën. Kaloi edhe një copë herë në pritje dhe më në fund Llajni tha:

— Bobo, të më falni, po letërnjoftimin e kam harruar në Tiranë.

Në këtë kohë ngjau një e papritur. Prapa krahëve të tyre u dëgjua një zë:

— E kam unë!

Të gjithë kthyen kokën dhe, për habinë e tyre, panë Mëhillin që mbante në dorë letërnjoftimin e tij. Gëzimi u kthye në shamatë dhe në lutje. Shamatën Asllani dhe Xani

e bënë me Mëhillin, të cilin kërkonin ta zbonin me çdo kusht. Po nëpunësja e gjendjes civile u tha:

— Ai është qytetar si gjithë ju të tjerët dhe s'kemi të drejtë as unë, as ju ta zbojmë jashtë nga zyra e pushtetit.

— E po atëherë, si të bëjmë? — tha Xani.

Dhe pas Xanit pyeti Asllani:

— Si do të bëhet halli ynë?

— S'ka ndonjë hall këtu. Shoku të sjellë letërnjoftimin dhe vazhdojmë procedurën e caktuar.

— Mirë, — tha Asllani, — po a nuk mjaftojnë letërnjoftimet tona?

— Tuajat i keni për vete. Në qoftë se martoheni ju, atëherë po.

Asllani nxori nga xhepi fotografinë që tregonte në plan të parë atë vetë gjatë prishjes së tyrbes.

— E sheh këtë?

— S'më duhet fotografia, — tha nëpunësja e qetë.

— S'të duhet ty, po na duhet neve, — vazhdoi Xani serbes. — Ky është një nga ata që i kanë dhënë dërrmën fesë, kur të tjerët thoshin amin, o prift, amin, o hoxhë.

Ata u lutën e u hëngrën edhe një copë herë, derisa në zyrë hyri një çift i ri me dëshmitarët dhe ajo tha:

— Na falni, mos na pengoni! — dhe, duke iu drejtuar të tjerëve, vazhdoi: — Urdhëroni!

Kur dolën jashtë, Llajni tha me inat:

— Do të shihni ç'do t'i bëj unë kësaj injoranteje!

— Po tani si do të bëjmë? — pyeti Asllani.

Llajnit i erdhi rasti në dorë:

— Do të shkoj urgjent me taksi. Brenda ditës jam këtu:

— Shumë mirë, — tha Xani. — Ja ç'do të thotë të jesh njeri me mend.

Të gjithë shkuan tek agjencia dhe prenotuan taksinë. U përshëndetën me njëri-tjetrin dhe, kur taksia me Llajnin

u nis, secili, duke bërë me dorë, i dha urimin sipas mënyrës së tij:

— Të fala krushkut, — tha Asllani.

— Të fala shokëve, — tha Xani.

— Mirupafshim, i dashur, — tha Duneranka.

Prapa kurrizit të tyre u ndie një zë.

Mëhilli qeshte hi-hi-hi.

\* \* \*

Taksia nuk e çoi Llajnin në kryeqytet, por e la në mes të rrugës. Ai i tha shoferit:

— Paret janë paguar gjer në Tiranë. Unë do të zbres këtu, ç'të mbetet nga kjo pagesë, le të mbetet për ty.


— Faleminderit, — i tha shoferi i gëzuar dhe u nis drejt agjencisë së pasagjerëve për të zëvendësuar Llajnin në udhëtimet drejt Tiranës me katër udhëtarë të tjerë.

Tani Llajni ndalonte këtu me shumë arsye dhe qëllime.

PJESA E TRËTE



## Kreu i parë



### NJË RROTË NË SKENË

Përpara se të vinte këshilli artistik të shihte shfaqjen e re, regjisori urdhëroi që në cepin e djathtë të skenës të vendosej një rrotë qerreje.

— Përse na duhet kjo rrotë? — pyeti inspektori i skenës.

— E di unë, — iu përgjigj regjisori me ton të prerë.

Urdhri i regjisorit u vu në vend, po ai mbeti si pikëpyetje në mendjen e aktorëve e, sidomos, të inspektorit të skenës.

Në sallën e shfaqjes ku do të jepej prova çdo gjë ishte e rregullt. Aktorë dhe njerëz të tjerë ishin ulur nëpër vende dhe prisnin të vinte këshilli artistik.



Papritur, në sallë, si rrathët e një guri që bie në ujë të qetë, filloi të shpërndahej një mërmërimë. U përhap lajmi se do të vinte edhe një i deleguar nga qendra. Njerëzit u bënë edhe më kureshtarë. Përgjegjësi i propagandës u ngrit menjëherë nga vendi dhe shkoi te porta për të pritur të deleguarit.

Në mes të anëtarëve të këshillit spikaste njeriu me rroba bojë qielli. U ndien mërmërima dhe gjindja përqendroi sytë tek i deleguari. Llajni ndiente vështrimet dhe mori pamje më serioze.

Në rreshtin e parë të sallës u ulën anëtarët e këshillit artistik. Në mes rrinte njeriu me rroba bojë qielli.

U hap perdja dhe filloi shfaqja. Pjesëmarrësit herë shihnin në skenë dhe herë vështronin të deleguarin e qendrës. Ai nuk fliste. Nja dy herë lëshoi një «pësh», i cili u interpretua në shumë mënyra, por asnjeri nuk krijoi bindje ç'ishte ai «pësh» mohimi apo pohimi. Apo hem kështu dhe hem ashtu. Vetëm njëri tha me ngadalë që «pësh» zbërthehet në dy fjalë: po, që do të thotë, po, dhe eh që diçka do ndrequr.

Aktorët e filluan dhe e mbaruan shfaqjen me emocione. Po pjesa e dytë, me një fjalë mbledhja për të diskutuar e bërë vërejtje për këtë premierë të re të estradës u zhvillua me tension.

— Kush e do fjalën? — pyeti drejtori duke iu kthyer në radhë të parë të deleguarit nga qendra e pastaj anëtarëve të këshillit artistik dhe të ftuarve të tjerë.

Ra një heshtje. Ishte ajo heshtja e zakonshme që ndodh gati gjithmonë kur fillojnë diskutimet nëpër mbledhje. Më së fundi dikush e theu akullin.

— Me leje! — e mori fjalën anëtari më i vjetër i këshillit artistik.

— Urdhëro, — tha drejtori, i gëzuar.

— Mua shfaqja më pëlqen. Është një hap përpara dhe sjell freski në skenë. Më duket se aktorët kanë punuar

mirë dhe regjisori po ashtu. Kjo dëshmon se ne mund të bëjmë në të ardhmen shfaqje më të mira.

Pasi foli për rëndësinë e kësaj premiere, kaloi në një kapitull të veçantë: theksoi vlerën e gjinisë së estradës dhe dobinë që sjell ajo.

— Populli, — e ngriti tonin, duke i përqendruar sytë te i deleguari i qendrës, — pra populli e do estradën. Në të kaluarën në qytetin tonë s'ka pasur estradë, s'ka pasur, por ama tani ka, dhe, derisa ka, ajo duhet të lozë rolin e saj. — Pasi sqaroi dhe theksoi disa herë rolin e madh të estradave, u hodh në vërejtje konkrete: — Unë kam një vërejtje të rëndësishme. Përse duhet ajo rrota e qerres në skenë?

— Duhet, — tha regjisori, — jua them unë në fund.

— Për mua s'duhet, — ndërhyri i deleguari i seksionit të arsimit.

U ngrit menjëherë i deleguari i komitetit.

— Unë jam dakord me shokun parafolës. Diskutimi i tij më pëlqeu sepse ishte me nivel. Për sa u përket vërejtjeve konkrete, edhe unë jam dakord që të hiqet rrota e qerres. Unë nuk jam në një mendje me shokun regjisor, sepse, në fund të fundit, ç'tregon një rrotë qerreje në cepin e djathtë të skenës?! Mos vallë do të krijojë ambient fshati? Dakord! Qerrja duhet përdorur, por, mos vallë duhet të kapemi pas rrotës së qerres? Jo, jo, ju lutem mos e idealizoni rrotën e qerres. Se, në fund të fundit, rrota nuk është shpikja jonë, pra s'është e tabanit kombëtar. Rrota, bile edhe qerrja, janë që në kohën e Homerit. Ideja e rrotës ka lindur këtu e gjashtë mijë vjet të shkuar, kurse rrota me bisht, me disk e me rreze ka një moshë prej rreth katër mijë vjetësh.

— Jam dakord me shokun e komitetit, — tha një anëtar tjetër i këshillit. — Jam dakord se rrota jo vetëm nuk i shton gjë shfaqjes, por e rëndon. Ua heq vëmendjen spektatorëve nga problemet qendrore. Në shfaqje ajo duket si një gjë e tepërt që të bezdis, sepse, ku e dinë, fjala vjen, nxënë-

sit e shkollës së muzikës se ç'është rrota, vlerën dhe dobinë e saj? Apo mos doni të thoni se rrota e palyer bën gili-vili si violinë dhe nxënësve u kujtohet të akordojnë telat e violinave. Se edhe violina, po s'i akordove telat, gili-vili bën, si rrotë e palyer.

— A, të lutem, — tha një anëtar tjetër i këshillit artistik, amator skeqesh dhe punonjës në fidanishten e qytetit. — S'jam dakord me ju. Vërtet nxënësit e shkollës së muzikës nuk e dinë vlerën e rrotës, por të violinës e dinë. Por, ama, shfaqja, kur të vejë në fshat, do të bëjë efekt pozitiv. Kjo varet nga cilësia, ose, më mirë të them, nga gjendja e rrotës. Në qoftë se rrota do të jetë e cilësisë së parë, kushedi sa spektatorë fshatarë do ta shohin me zili, për ta pasur në qerren e tyre. Por, po të jetë, ta zëmë, e shkatërruar, këtyre kooperativistëve që mund të jenë, fjala vjen, të dalluar, do t'u vinte inat që kjo vegël njerëzore e dobishme është katandisur në këtë gjendje.

— Jo vetëm kaq, — tha i deleguari i komitetit, — por, po të jetë e prishur, ndikon keq sidomos te dembelët. E kam fjalën tek ata që nuk kujdesen për shfrytëzimin e rrotave në transport. Po, po, kështu do të ndodhë, sepse, kur një estradë s'është në gjendje të rregullojë një rrotë, si mund të presësh prej saj që të rregullojë ndërgjegjen, ta zëmë, të një njeriu që këmbët i ka në fshat dhe kokën në qytet. Prandaj në asnjë mënyrë të mos qëndrojë rrota në skenë.

— Mund edhe të qëndrojë, — e mori fjalën një anëtar tjetër këshilli, punonjës në ndërmarrjen komunale, — veç, nuk duhet të jetë një rrotë memece, por aktive.

— Ha, ha, ha, — qeshi me zë të lartë i deleguari i Komitetit.

— Ha, ha, ha! — u dëgjuan ca zëra të tjerë.

Mjekra e të deleguarit të komitetit filloi të lëvizte poshtë e lart me shpejtësi dhe në sallë u dëgjuan fjalët e tij me një ton komik:

— Po merreni me mend, more shokë, sikur kjo dreq rrotë nga skena të bjerë poshtë në sallë. Ha, ha, ha! — qeshi. — Në sallë do të bëhet komedi, ha, ha, ha!

— Jo, shoku Qamil, nuk e kam aty, — tha anëtari i këshillit me prejardhje nga ndërmarrrja komunale. — Mund të shoqërohet me një monolog.

— Me monolog! — thanë disa zëra të habitur.

— Monologu i rrotës! — tha i deleguari i seksionit. — E ç'monologzi mund të gjendet për një rrotë?

— Gjendet, gjendet, — tha komunalisti. — Ja, Taqoja që ka ardhur si vëzhgues në shfaqjen tonë është burim i pashtershëm anekdotash, bejtësh, parodish e kupletësh, nuk ma merr mendja të mos dijë edhe ndonjë monolog për rrotën.

Taqoja qeshi dhe fërkoj mjekrën me dorën e majtë. Pastaj, i gëzuar që iu dha rasti të shfaqte talentin e tij përpara një këshilli artistik, me zërin e tij si prej balte recitoi:

*Mbi dy rrota rri një rrotë.*

*Pyet mësuesja: — Kush e gjen?*

*— Ta them unë, — thotë Beni,*

*— ai është xhaxhi Eqrem.*

Në sallë shpërthyen të qeshura. Eqremi, që ishte drejtor i teatrit, bërtiti i nervozuar:

— More Taqo, estradë po na bën këtu? Po në estradë jam unë drejtor dhe nuk lejoj që tallja të bjerë mbi autoritetin, figurën, postin dhe emrin tim të nderuar. Vërtet unë ngas motocikletë, po s'jam nga ata që mendon ti. Prandaj ato fjalë merri prapë.

— Mos u ofendoni, shoku drejtor, — tha Taqoja, i pushtuar nga mërzia, sepse edhe një herë që iu dha rasti të shfaqte prirjet e tij, ra me dy këmbët brenda.

— Procesi i të folurit të Taqos, — tha i deleguari i

seksionit, — u vu në veprim pa marrë lejen e trurit, prandaj ti, shoku drejtor, nuk duhet t'i zemërohesh këtij proletari të punës mendore.

U ngrit autori më i vjetër i kolektivit të estradës që edhe pse ishte figurant e dilte në skenë me këtë funksion një herë në pesë vjet, ai, prapë ishte krenar sepse qe pjesëtar i trupës me të drejta vote të barabarta si të tjerët.

Aktori Pano Jano që ishte prapa kurrizit të të deleguarit, me rroba bojë qielli, kur e pa që figuranti u ngrit hijerëndë për të dhënë mendimet e veta, lëshoi një romuz:

— Ky mund të krahasohet me njeriun e 5-miliardtë që lindi këto ditë në botë, i cili do të mbahet mend si një ekzemplar i veçantë. Edhe kolegu ynë është një ekzemplar i veçantë sepse është njeriu që me një pesëvjeçar merr një rrogë nëpunësi për të dalë një minutë në skenë, bile edhe në këtë minutë ai nuk flet, por vetëm hyn nga një anë e skenës dhe del në anën tjetër.

— Interesant, — tha Llajni.

Antarët e këshillit artistik vështruan kuriozë folësin që u shfaq papritur në këtë mbledhje.

\* \* \*

Figuranti i estradës kishte një histori të çuditshme të jetës së tij. Ai kishte hyrë në skenën e teatrit dhe të estradës nga gazeta. Ca miq të babait të tij, me ndërhyrje dhe rekomandime se i kishte të tëra konditat dhe garancitë për të punuar në gazetë, e futën në këtë punë, gjithnjë të nisur t'i bënin një nder shokut të tyre. Në gazetë ndenji ndonjë vit dhe nuk shkroi dot asnjë rresht. Atëherë thanë të gjejnë një punë tjetër më të përshtatshme. U krijua trupa e teatrit dhe punën ia gjetën aty.

— E po në gazetë vërtet nuk shkëlqeu, po përvojë fitoi. Këtu në teatër atë përvojë mund ta shfrytëzojë! Në gazetë duhet të shkruajë vetë, kurse në teatër ky do të luajë ato që shkruajnë të tjerët.

Mirëpo ai nxori një pretendim. Nuk lexoj dot, sepse, kur i shoh gërmat, më bëjnë sytë miza-miza. Të ish alfabeti me një germë, atëherë po. Pretendimi, i tij u mor parasysh nga organizata profesionale, e cila i propozoi drejtorisë që të mos e largonte nga trupa, por ta mbante si figurant, se nga shtati dhe mimika ishte i përshtatshëm për këtë detyrë.

Që me shfaqjen e parë kur u duk në skenë, ai la nam. Që atëherë kanë kaluar shumë vjet. Ai ishte djalë i ri e i fuqishëm dhe ashtu kishte mbetur prapë, megjithëse tani po bëhej gati për të dalë në pension. Ai ishte prapë figurant, por jo në teatër, tani ishte në estradë.

Do të shfaqej drama «Nëna» e Gorkit. Regjisori dhe të gjithë këmbëngulnin që pjesa të luhej sipas parimeve të realizmit socialist. Por ai tha se me këto që na shpjegon regjisori mua koka më bën miza-miza, se teorinë s'para e kam qejf, prandaj ma thoni më konkretisht. Dhe regjisori i tha konkretisht se ai do të luante rolin e një xhandari carist që persekutonte Pavël Vllasovin. Kur të dalësh në skenë, duhet ta quash veten tamam xhandar dhe të veprosh me tërë fuqitë e tua. Këtë po, e kuptoj, tha figuranti. Dhe me të vërtetë, sa doli në skenë, i papërmbajtur filloi të godiste aktorin me sa fuqi që kishte dhe ku mundi. Aktori, i trembur se mos e vriste fare, rendi nëpër skenë, ndërsa figuranti, duke marrë yrysh të papërmbajtur, doli jashtë saj dhe ra në publik.

Drama u kthye në komedi dhe kjo i siguroi vendin në estradë. Po edhe këtu, nga ndonjë hall i madh, e nxirrnin shumë rrallë në skenë, se edhe si figurant do të ngatërronte prapë ndonjë gjë.

Tani ky aktor i estradës që mbahej mend si komik për

rolin e parë në teatër, duke marrë fjalën, në përshtatje me rolin e tij që kishte kryer gjatë afro 30 vjetëve, tha kaq:

— Bota me rrota, — dhe u ul.

Njerëzit qeshën. Lljajni tha:

— Qenka komik i madh!

— Jo bota me rrota, po sa rrota ka bota, — foli i nxehur, sa ta dëgjonin edhe të tjerët, aktori i cirkut, Vasillaq Paftali, tip i kundërt me figurantin e estradës që edhe në këto çaste krenohet se dha ndihmesën në këtë debat për rrotën në skenë.

Në goftë se figuranti ishte një përjashtim që për një minutë pune firmoste në bordero gjatë një pesëvjeçari, Vasillaqi ishte një njeri që s'rrinte një minutë i qetë. Ai nuk dallohej në trupën e estradës se ishte i vetmi njeri me mustaqe në kolektiv, por sepse ishte i gatshëm dhe i papërtuar për çdo gjë. Duke pasur pasion kalitjen fizike, bëri udhëtimin e parë prej katër ditësh nëpër lumin e Vjosës. Ndërtoi një trap dhe u nis nga ura e Përmetit. Njerëzit lanë punën dhe u grumbulluan të shihnin nisjen e Vasillaq Paftalit për të lundruar nëpër Vjosë deri në brigjet e Adriatikut. Trapi qëndronte i lidhur në një nga këmbët e urës. Ndërsa Vasillaqi, i veshur me rroba banje, me fytyrën ezmere, me mustaqe e flokë të zez, me trupin muskuloz, rrinte mbi urë e s'fliste.

Kureshtja i shtynte kalimtarët të qëndronin e të shihnin çdo të ngjiste. Papritur u dëgjua një zë:

— Vasillaq, na le pa punë!

Njerëzit kthyen kokën andej nga vinte zëri, po në këto çaste Vasillaqi u hodh në lumë si një notar i sprovuar. Mbi ujë u bë shkumë. Vasillaqi ishte zhdukur. Gjindja mbajti frymën. Pas ndonjë minute ai nxori kokën te cepi i trapit dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u ngjit sipër tij.

Njerëzit duartrokiten.

Vasillaqi e zgjidhi litarin nga direku i trapit dhe për-

shëndeti. Trapi rrëshqiti me shpejtësi mbi Vjosë. Mirëpo, pa bërë njëzet-tridhjetë metra, u përmbys. U dëgjua klithma e një gruaje:

— Vasillaq, u mbyte! Korba unë!

Ai doli nga ujët, rregulloi trapin dhe thirri sa mundi:

— Grua, shiko fëmijët, pa unë do të dal shëndoshë e mirë.

Lundrimin e kreu dhe kronika e atij udhëtimi nëpër Vjosë u pasqyrua në gazetatat e kohës. Kjo gjë i dha guxim e Vasillaqi filloi të merrej me akrobaci, me mundje, me vrapime. S'kaloi shumë kohë dhe atë e panë si aktor cirku, po tanimë jo në qytetin nga nisi udhëtimin mbi Vjosë. Në shfaqjen e cirkut merrte pjesë ai me dy vëllezërit, me djalin e vogël 7-vjeçar, me të shoqen dhe me një ari të zbutur.

Cirku i Vasillaqit ishte krejt me amatorë, po ja që në këtë diskutim për rrotën në skenë Vasillaq Paftali kishte ardhur me një pikëllim të madh në zemër, që nuk mund të mos e shprehte edhe në këtë mbledhje.

— Arti s'është punë rrote, — tha ai, — është punë pasioni. Më falni, se ju këtu keni hallin e rrotës, kurse unë kam hallin e ariut. Përfitoj nga rasti t'i njoftoj edhe shokut të ministrisë se ariu, Puçi im i famshëm, me të cilin punova 13 vjet, na la. Ai, që kur ishte i vogël dhe e mora ta zbutja, mësoi një zakon që i shpejtoi vdekjen. Sikurse thashë, mësoi një zakon, kërcente vazhdimisht kur e futnin në kafaz. E po, thashë, t'ia rritim kafazin për së larti. E rritëm. Por ai prapë kërcente. Domosdo deshi të përpiqte kokën në tavan. Nga ky shkak iu bë sinuzit. E mjekuan. I bënë incizion. Po ariu mori të tatëpjetën. Dhe ja, tani na la. Megjithatë unë punën nuk do ta lë përgjysmë. I premtoj shokut të ministrisë se do të gjej një ari tjetër, do ta zbut, do ta mësoj dhe do të vij të jap shfaqje edhe në Tiranë. Se unë nuk jam si ai shoku që s'dinte ç'të fliste e tha: «Bota me rrota.» Unë them se kjo botë ka shumë rrota, po si ky rrota ynë rrallë se gjen shokun.



Figuranti i estradës u nxeh dhe thirri me sa zë që kish-te:

— Mbjaj gojën! Ne përpigemi të japim mendimet tona për mbarëvajtjen e estradës dhe ti bën komedi.

Diskutimet ishin në kulmin e tyre. Për një çast u duk se po fitonte pala që ishte për heqjen e rrotës nga skena. Po ja, u ngrit regjisori dhe i hodhi prapë zjarrit benzinë:

— Nuk jam dakord me shokët diskutues që propozojnë të hiqet rrota nga skena. Shokë, po të thellohemi, do t'ia gjejmë domethënien këtij mjeti të shpikur nga mendja e dora e njeriut, që unë, me respektin më të madh, e kam vënë aty në cep.

Diskutimet morën zjarr. U sollën argumente të reja për rëndësinë e rrotës për zhvillimin e komunikacionit në botë. U rrahën mendime për të bukurën si kategori estetike dhe në cilën kategori hyn rrota, për dallimin midis humorit dhe satirës dhe a luan ndonjë rol kjo vegël në përcaktimin e ndarjes së këtyre dy nëngjinive. Tërë pjesëmarrësit ishin të elektrizuar dhe sekush kërkonte të dilte në fushën e betejës me armë të reja asgjësuese për kundërshtarin. Vetëm një anëtar i këshillit rrinte i heshtur dhe nuk fliste. Ky ishte kritiku Maksut Maksuti.

Drejtori i teatrit, i ndodhur midis dy zjarreve, u ngrit të vendoste qetësinë, prandaj, sikur të donte të gjente një pikëmbështetje ku të mbahej, rrotulloi sytë në sallë. Sytë e drejtorit u ndeshën me sytë e menduar të kritikut. Drejtori, duke marrë frymë i lehtësuar, tha me zë të lartë:

— Fjalën e ka kritiku ynë i nderuar!

Maksut Maksuti u ngrit me ngadalë dhe, hijerëndë, tha:

— Unë s'flas, meditoj!

— A ka mundësi ta vini meditimin tuaj në dobi të mbarëvajtjes së këshillit artistik? — iu drejtua atij i deleguari.

Në sallë ra qetësia.

Kritiku rrinte menduar e nuk fliste. Meditonte.

Pjesëtarët e mbledhjes e vështronin kureshtarë se nuk e merrnin dot me mend ç'meditonte ajo kokë e mbështjellë nga mjegulla e të panjohurave, nën ata flokë, që ngriheshin përpjetë, si furçë rroje. Kaluan disa çaste në heshtje, pastaj në sallë u dëgjuan disa fjalë, të cilat dukej sikur dilnin nga gryka e një shpelle që po hapej në botën e përrallave.

— Vendosja e rrotës në skenë nuk duhet marrë si një dukuri e rastit. Ajo kushtëzohet nga disa faktorë. — Ai mori një herë frymë thellë dhe vazhdoi: — Së pari, duhet parë se ç'pikësynim i ka vënë vetes regjisori; së dyti, nga çfarë premisash estetike është nisur, së treti, duhen parë rrethanat konkrete ku i duhet të veprojë. Me një fjalë, do të doja të thosha, pa analizuar shkaqet, nuk mund të gjykojmë pasojat. Një art i madh zgjon mendime të mëdha dhe me...

— Këto i lexuam dje në artikullin tuaj «Parimet estetike në poezinë e Mero Guçes», — u dëgjua një zë nga salla.

→ I kemi lexuar gjithnjë nga shoku Maksut Maksuti dhe do t'i lexojmë vazhdimisht, — u hodh i deleguari i seksionit të arsimit. — Pse, parime të reja do të nxjerrë ai në këtë shfaqje?

— Përsëritja është mëma e dijes, — tha i deleguari si për t'i hapur shteg diskutimit parimor të kritikut.

— Marrim një shembull. — vazhdoi kritikun, i stimuluar nga fjalët e të deleguarit. — Marrim një shembull konkret nga jeta jonë e përditshme, nga kjo shfaqje: Marrim rrotën në skenë. Do të doja të thosha se rrota edhe mund të vihet edhe s'mund të vihet. Nuk mund të gjykohet vënia ose heqja jo e një rrote, po edhe e një maje gjilpëre sipas dëshirave të njërit apo të tjetrit. Rrota është si rrokja. Ç'bëhet, vallë, me poezinë e mjerë, po të heqim ose të shtojmë rrokje sipas qejfit? — Kritikun pushoi, fshiu djer-sën me shami dhe, si u ul, tha: — Kaq për sot.

Pjesëmarrësit mbetën si në një boshllëk nga mbarimi i papritur i diskutimit të kritikut, që, në këtë çast, u duk si orakulli i Delfit.

— Po mirë, — e mori fjalën i deleguari i komitetit, — ju, shoku Maksut, si thoni: të lihet apo të hiqet rrota?

— Po ja, si mendoni ju, shoku i deleguar? — iu kundërpërgjigj me pyetje kritikui.

— Unë them të hiqet, — shqiptoi me seriozitet i deleguari i komitetit.

— Edhe unë them të hiqet, — tha kritikui.

— Po unë mund të themi të vihet, — shtoi i deleguari i komitetit.

— Po edhe unë mund të them të vihet.

Në sallë shpërthyen të qeshura.

— Me leje, — tha regjisori, — a ka mundësi të bëj një propozim?

— Të bësh dy, — u dëgjuan disa zëra njëherësh.

— Atëherë ta bëjmë me vota, — vazhdoi regjisori. —

— Kush është dakord që rrota të hiqet nga skena?

Shumë duar u ngritën me nervozizëm përprjetë. Regjisori numëroi dhe tha:

— Njëmbëdhjetë shokë janë që të hiqet. Po që të mos hiqet? — Prapë numëroi: — Dhjetë shokë janë të mos hiqet. Dakord, — vazhdoi regjisori. — Unë i bindem shumicës.

— Me leje, — tha një zë nga salla.

Njerëzit kthyen kokën. Fliste kritikui.

— Po ju, shoku regjisor, kujt ia jepni votën: heqjes apo lënies? se po të jetë se ia jepni heqjes, atëherë jemi dymbëdhjetë, po t'ia jepni lënies, atëherë jemi baras dhe duhet të shtojmë numrin e këshillit artistik me elementë të rinj.

— Unë i bindem shumicës, — tha prapë regjisori. — Rrotën do ta heq nga skena, sepse e kreu detyrën e saj.

Në fytyrat e pjesëmarrësve u duk një ndjenjë lehtë-

simi dhe kënaqësie. Këtë ndjenjë e shprehu edhe i deleguari dhe ora e murit, dy akrepat e së cilës, të gëzuar që shpëtuan nga kjo mbledhje e gjatë dhe e zjarhtë, u puthën mbi numrin 12. Regjisori priti disa sekonda dhe, kur pa se akrepi i madh po largohej si me përtesë nga akrepi i vogël, tha:

— Faleminderit për vërejtjet dhe diskutimet shumë të dobishme. Unë do ta heq rrotën, sepse ajo, tani që mbaroi mbledhja, nuk më hyn më në punë.

Të gjithëve fjalët e regjisorit u ranë si bombë duke shurdhuar tërë debatet e zjarrra për rrotën. Vetëm kritiku s'fliste. Ai mendonte.

Po në këto çaste u ngrit njeriu me rroba bojë qielli.

— Mua shfaqja më pëlqeu. E mrekullueshme. Ja, me këtë numër të konkurroni pa frikë në Shkodër në «Ditët e satirës dhe të humorit». Suksesin e keni të padiskutueshëm. Vetëm kam një vërejtje.

Të gjithë përqendruan vëmendjen më shumë mbi njeriun që e shihnin për herë të parë e ishte shfaqur kaq papritur në këtë mbledhje të këshillit artistik.

— Pra, sikurse theksova, kam një vërejtje: Ju keni vënë një skeç për gjuetinë, dakord. Nuk më thoni kush e shkruan?

— Unë, — tha një nga anëtarët e këshillit artistik.

— Bukur! Po ti a je gjahtar vetë?

— Jo, jo, gjahtar s'jam.

— Epo atëherë, mor shok, si merr guximin e bën një skeç për gjuetinë?

— Kam dajën gjahtar, — u përgjigj ai si i zënë ngushtë.

— Daja dakord, po gjuetia nuk është punë farefisnie, ajo sot është shkencë. Kështu që skeçi yt del si në komunitetin primitiv. E di ti, fjala vjen, ç'është gjuetia me çues, me imitim, me flamuj etj?

Autori i skeçit rrinte në këmbë pak i turpëruar për

mungesat e theksuara që kishte në lëmin e shkencës së gjuetisë.

I deleguari vazhdoi me ton serioz:

— Para disa ditësh organizova një gjueti të fortë me metodat më të përparuara dhe, natyrisht, edhe rezultatet ishin të shkëlqyera.

— E çfarë vratë? — pyeti anëtari i këshillit artistik që punonte në komunale.

— Çfarë vrava? Derra të egër, bile edhe ndonjë çakall. Të shkosh në gjueti e të mos vrasësh, është turp. Po të më ndodhte mua një herë të mos vrisja, do ta thyeja e do ta bëja copë çiften. Kështu që skeçin do ta kishe bërë më mirë po të merrje edhe ti pjesë si amator në gjuetitë e mia. Madje u duhet thënë edhe atyre të Radio-Televizionit të vijnë.

— Unë vij me gjithë qejf, — tha autori i skeçit.

— Mirë, atëherë, kur të kem rast, do të të lajmëroj.

— Bile pas vrasjes së gjahut, mund të organizojmë edhe një piknik me trupën e estradës suaj. Besoj se e hani mishin e derrit të egër.

Në sallë u ndie murmurimë.

— Kam përshtypjen, — vazhdoi i deleguari i qendrës, — që regjisori është njeri i talentuar, por është pak i pleshtfrevënës.

Njerëzit hapën sytë, heshtja u bë më e thellë. Fjala që kishte thënë njeriu me rroba beharore ngjalli habi. Po ai këtë habi deshë të shkaktonte, prandaj e përsëriti më me kompetencë atë fjalë.

— Po, po, pleshtfrevënës. Mos u habitni. Kjo është shqip dhe zëvendëson fjalë skrupuloz. Pse do të përdorim këtë fjalë të huaj kur mund të përdorim tonën? Në studimet e mia unë skrupulozin e quaj me plot gojën njeri që i vë pleshtit fre. Sepse kështu është skrupulozi.

— Po në rastin konkret regjisorit a mund t'i themi rrotëfrevënës? — pyeti drejtori.


— Ky është një kapitull tjetër, — ia priti i deleguari, — që nuk e kam parashikuar në studimet e mia.

I deleguari i qendrës pushoi një copë herë e pastaj tha:

— Me sa dihet, në kolektivin tuaj, ku punët shkojnë mrekulli, keni dy probleme: çështjen e rrotës dhe çështjen e ariut. Të dyja do t'i zgjidhni me forcat tuaja, por, po të keni nevojë, edhe ne, si ministri, do t'ju ndihmojmë.

\* \* \*

Në kohën kur i deleguari bënte vërejtje në këshillin artistik për skeçin e gjuetisë, drejt Tiranës ishin nisur e udhëtonin Asllani me Dunerankën, me dëshirën dhe mallin e madh që i kishte marrë për dhëndrin e tyre. Atë natë rastësia e solli që ata të flinin në një hotel.



## Kreu i dytë

### DY LUANËT NË NJË DHOMË

Asnjërit nga të dy Luanët, pale Dunerankës, nuk i shkonte ndër mend se atë natë do të flinin në të njëjtën dhomë, por pa u takuar me njëri-tjetrin. Asllani me Dunerankën ishin nisur për te dhëndri në kryeqytet, se qenë bërë merak.

*Ndonjë lajm a ndonjë letër  
vallë pse s'dërgon?*

Kështu i thoshte Asllani herë pas here së bijës, i frymëzuar nga kënga popullore e kurbetit që pati dëgjuar në të ritë e tij në dasma e gostira.

Ndërsa e bija, si për t'u bërë sfidë vargjeve të të atit, vazhdonte:

*Se aty ku je ti,  
aty jam unë,  
aty ku jeta ndrin më shumë.*

Po Asllanit nuk ia merrte mendjen poezia. Ai, si njeri praktik, kishte gjetur një mall të mirë dhe këtë s'do ta linte t'i ikte nga dora. Prandaj mori edhe rrugën për në kryeqytet. Mirëpo, si i thonë fjalës, makina është rrotë dhe ja si të merr e të shpie aty ku do ti, po ashtu të lë rrugës e s'i bëhet vonë. Këtë fat patën edhe Asllani me Dunerankën. Për të qenë të saktë, makina nuk i la rrugës, po në mes të rrugës. Madje ata, asaj mbrëmjeje, udhëtuan edhe nja dy orë nëpër terr, derisa arritën në qytetin që kishin më pranë.

\* \* \*

«Vende s'ka.» Këto ishin fjalët e para të mikpritjes në qytet, të cilat nuk i dëgjuan me gojë, por i lexuan me shkrim në sportelin e hotelit.

Asllanit këto fjalë sikur i nxitën kujtesën dhe ai solli ndër mend të kunatin, kryekamariet Xanin, i cili luante një rol të ndjeshëm në hotelin më të madh të qytetit të tyre. Ai thoshte gjithnjë: «Për mikun nuk duhet të përdoret asnjëherë fjala s'ka, po shprehja popullore për mikun ka dhe qumësht dallëndysheje.»

— Jemi jabanxhinj, — iu lut sportelistit pas ndonjë ore, kur ai hyri hijerëndë në hollin e hotelit dhe nxori portretin e tij si në një fotografi që prapa banakut. Pritësi nuk foli se kruante dhëmbët me një dorë, ndërsa me dorën tjetër bëri me gisht drejt tabelës që rrinte mbi kokën e tij



si një kërcënim dhe ultimatum që klientët të mos e shqetësonin, po ta linin të lirë të kruante dhëmbët.

Lutja e Asllanit «jemi jabanxhinj» u përsërit edhe nja dy herë, por sportelisti nuk foli. Nga goja e tij u dëgjuan dy gromësira të forta dhe, mbi banak, u ndie erë alkooli dhe hudhrash.

Megjithatë Asllani nuk u mërzit. Ai, në jetën e tij të nëpunësisë, durimin ia kishte nënshtruar jo punës, por fjalës shumë kuptimplote për të «Qengji i butë pi dy nëna». Me këtë mënyrë durimi ai kishte mposhtur shefa e përgjegjës e, kur i kërkonin llogari, ai heshte, madje, edhe kur i bërtisnin, ai prapë heshte. Të folurit është argjend, po të heshturit është flori.

Sportelisti ishte abrash nga goja, po tjetri ishte nëpunësi «qengji i butë pi dy nëna». Prandaj u ul në një kolltuk të sallonit të hotelit dhe i tha vetes «rri». Do të vijë një çast që ky sportelist abrash, që ka qejf të përkëdhelë tërë ditën të bijën e rrushit, domosdo do të bjerë në prehrin e bakshishit «Vende s'ka».

As Asllanit, as Dunerankës nuk i shkonte ndër mend se vendin për ta e kishte prenotuar dhëndri i tij dhe i fejuari i saj. Madje këtu nuk diskutohej sa për të futur kokën, por në dhomën më të mirë të hotelit. Atë natë sportelisti i «vendeve s'ka» kishte marrë porosi të prerë nga drejtori i estradës jo për një vend, por për një dhomë të rezervuar, komode, të qetë dhe pa njeri tjetër brenda.

## SOFIJE BARBULLUSHI DHE E BIJA

Drejtori i estradës atë natë nuk e la në asnjë mënyrë të deleguarin të ndahej prej tij. Madje, për t'ia bërë më

mirë nderet, në darkë mori edhe redaktorin e gazetës lokale, Thimio Thimin.

Drejtori i prezantoi të shoqen me këto fjalë:

— Shoqja Sofije, modhista më e mirë e qytetit.

— Sofija Loren, — tha i deleguari duke vështruar nga koka gjer te këmbët modhistrën më të mirë të qytetit, si të donte të verifikonte fjalët e bashkëshortit të saj, jo vetëm nëpërmjet veshjes që kishte ajo, por, edhe mbi çfarë konstrukti anatomik rrinin ato petka të prera nga dora e saj.

— I dashur mik, — vazhdoi drejtori i estradës, si për t'i vënë kokë bisedës. — Sofija Loreni do ta kishte për nder të ishte kliente e Sofije Barbullushit, sepse shprehja që thoshin latinët «mens sana in corporis sana»<sup>1)</sup> do të për-kthehej në gjuhën praktike dhe konkrete shqipe: «Trup i bukur në fustan të bukur.»

Të gjithë qeshën, kurse modhista më e mirë e qytetit falënderoi me kokë.

— Ndërsa kjo, — tha drejtori, — është vajza e shtëpisë sonë, e bija e modhistrës më të mirë të qytetit, Katjusha, laborante e shkëlqyer në dyqanin optik.

— Gëzohem, — tha i deleguari dhe bëri elozhin e parë. — Për mua kjo është një surprizë. Jam përpara jo një nëne dhe një bije, po përpara dy motrave, njëra më e re dhe më e bukur se tjetra.

Gjindja u bë edhe më gazmore nga këto fjalë, por më vonë u bë edhe më e ngrohtë. Ose, më mirë, siç do ta përcaktonte të nesërmen gojarisht redaktori i gazetës lokale, «pritja kaloi në atmosferë të përzemërt e miqësore».

---

1) Mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë.

\* \* \*

Më së fundi nëpunësi «ri» u përfill nga përkëdhelësi i bijës së rrushit dhe ra në prehrin e ryshfetit. Nga ora një e natës i lëshoi dhomën. Kështu që, njëri nga të dy, ose i ati, ose e bija, pati nderin të flinte në krevatin e rezervuar për Llajnin. Ky ishte nderi i parë dhe ndoshta i fundit që u bënte Llajni. Por asnjëra palë s'ishte e ndërgjegjshme për këtë. Duneranka pëlqeu perdet e mëdha të ballkonit dhe i tha të atit:

— Ja, një palë perde të tilla më duhen për në dhomën e gjumit. Krijojnë një fantazi dhe unë do të dukem si një nimfë në liqenin e mjellmave.

Asllani nuk dëgjonte më të bijën. Ai, sa vuri kokën në jastëk. filloi të gërhiste si një gjym me gështenja kur zien.

\* \* \*

Gdhiu një ditë e re mbi qytet. Njerëzit dolën rrugëve dhe sekush shkante në punën e tij.

Dolën në rrugë dhe Asllani me Dunerankën. Doli në rrugë edhe Llajni i përcjellë nga shoqja e drejtorit, Sofija, dhe vajza e tij, Katjusha. Llajni ndihej i gëzuar. Në gëzimin e tij, për të përcjellë të deleguarin, deri tek agjencia e pasagjerëve prej nga do të nisej, nuk mundi të merrte pjesë drejtori i estradës, sepse atë mbrëmje do të jepnin premierë dhe duhej rregulluar detyrimisht skeçi i gjue-tisë, i cili mbante erë tavoline, jo pylli. Aq më tepër që kjo vërejtje bëhej nga një i deleguar që tani ishte miku i shtëpisë së tij, në mos më shumë.

Mirëpo në gëzimin e këtij mëngjesi Llajni pati një surprizë. Sa doli në kthesën e ëmbëltores «Bukuria», u

ndodh papritur ballë për ballë me Asllanin dhe Dunerankën.

— Llajn, — thirri Duneranka.

— O, — tha Llajni, — ç'po më shohin sytë — dhe, si të donte të prezantonte të dy palët, thirri: — Motra!

E shoqja dhe e bija e drejtorit të estradës pandehën se vajza që tha Llajn ishte e motra, ndërsa Duneranka pandehu se motra ishte vajza, që shoqëronte Llajnin.

Ata i dhanë dorën njëri-tjetrit duke vështruar sipas mënyrës së vet motrën e Llajnit. Duneranka me Asllanin menduan se vajza e shoqëruar me Llajnin qe e motra, dhe tjetra, po të ishte e ëma, pra ishte edhe krushka e tyre. Ndërsa modhista Sofija mendoi se, po të ishte i ati i motrës së Llajnit burri, do të ish një gjë e pëlqyeshme, sepse pikësynimet që filluan në mbrëmje që «ky bandill të bëhet dhëndri ynë», siç i tha modhista Sofije burrit të saj drejtor, tani po hynin në njohje familjare. Ndryshe nga dy palët, Llajni thuri të tjera plane operative, prandaj tha:

— Urdhëroni në pastiçeri.

Kur arritën te dera e pastiçerisë, Llajni mbajti këmbët. Edhe Asllani mbajti këmbët.

Llajni tha:

— Damat hyjnë të parat.

— Domosdo, kavalierët në fund, — vazhdoi Asllani. Në fillim hyri modhista me të bijën, pastaj Duneranka. Ndërsa Asllani me Llajnin, duke hyrë të fundit, shkëmbyen këto fjalë:

— Vjehri im i dashur. Nuk është koha tani t'ia themi motrës dhe tezes sime fejesën tonë, sepse ka ardhur për tjetër krushqi: do të presim fjalën me palën tjetër. Pra, sa të shpallet fejesa e motrës, menjëherë edhe jona. Dy gëzime njëherësh. Ju hani nga një ëmbëlsirë dhe bëni sikur s'dini gjë, se tezja është një llafazane e madhe e gjysmë e luajtur e, po mori vesh se jam fejuar pa fjalën e saj dhe pa fejuar, sipas zakonisht, time motër, ka rrezik të na bëjë

skandal e ta prishë fejesën tonë. Prandaj thua ja mënjanë e me marifet Dunerankës, se edhe ajo do të gëzohet për kunatën e saj që i fejohej. Kunata në shtëpi, është si lugat i zi, thotë im atë.

Asllani e dëgjoi me vëmendje e hutim Llajnin. Një dyshim i lindi, po përsëri u besoi fjalëve të dhëndrit.

— Po ne si të bëjmë tani? — pyeti Asllani.

— Ju më prisni në stacionin e autobusëve. Mbarojmë këtë punë këtu, vijmë e vazhdojmë atë tjetrën atje. Ne që përgatitemi për diplomaci, s'na ka hije që punët tona t'i bëjmë si antidiplomatë.

Asllanit i pëlqyen fjalët e dhëndrit, prandaj qeshi. Me zë të lartë qeshi edhe Llajni.

\* \* \*

Si hëngrën ëmbëlsirën e pinë gotat e ujit, Asllani i bëri me shenjë së bijës e tha:

— Na falni pak se do të dalim për një punë të vogël.

— Shko vetëm ti, baba, — tha Duneranka, — unë do të rri këtu.

— Jo, jo, bashkë, — vazhdoi Asllani. — Bashkë erdhëm, bashkë shkojmë e bashkë vijmë. Ndahemi të bashkuar.

— Ndahemi të bashkuar, — përsëriti modhistrat Sofije.

Asllani me Dunerankën u ngritën e u dhanë dorën. Duneranka dukej e mërzhitur, po i ati e pa me inat dhe ajo u nis e heshtur pas tij.

Llajni i vështroi që prapa vitrinës së ëmbëltores edhe një copë herë duke ecur e, kur morën kthesën, u kthye nga Sofija që ishte ulur në karrigen për krah tij e i tha:

— Ime motër është beqare, bëhet shumë xheloze po

më pa me vajza të tjera. S'ke ç'i bën. «Shershe la fam», —  
— tha frëngjisht.

Sofija qeshi, ndërsa Katjusha tha:

— Ui, mësje. Vu parle franse!

— No, — u përgjigj Llajni, — shpik inglish!

Katjusha qeshi. Sofija, e joshur, ndiqte me adhurim bisedën në gjuhë të huaj të çiftit. Me siguri shumë shpejt do të bashkoheshin për të ecur krah për krah njëri-tjetrit në rrugët e gjëra të jetës.

— Kamarier, — thirri Llajni. — Më sill edhe mua një dopio ponç. — Ju, zonjushë, ç'dëshironi?

— Akulllore, — tha Katjusha e turpëruar.

— Mua një kompekaj, — vazhdoi Sofija.

— Kompekaj s'ka, por trigona ose tullumba.

— Tullumba, tullumba, — tha Sofija, — po jo të tha-ta, me sherbet.

— Mamaja i bën tullumbat shumë të mira, sa të lë-pish gishtërinjtë, — sqaroi Katjusha.

— Gëzohem, — tha Llajni, — po do të keni rast t'i provoni sa të mira i bën ime motër.

Biseda kaloi në lëmin e ëmbëlsirave që gatuate me mjeshtëri modhista Sofije.

— Mamaja, — tha Katjusha, — e bën bumbashanë, që thonë se është ëmbëlsira që ia bënte Vasiliqia e bukur Ali pashë Tepelenës, njëqind herë më të mirë se ajo.

— Ime motër, — tha Llajni, — preferon ëmbëlsirat moderne Eklerin, fjala vjen, ajo e gatuan dhe e servir me rhum të ndezur.

— Ekleri është një lloj shëndetlije, — sqaroi Sofija. — Po ndërsa ju e shërbeni me rhum të ndezur, ne i shër-bejmë me sherbet të ftohtë.

— Mamaja bën shumë mirë ballokumin.

Llajni piu ponçin, porositi edhe një tjetër, edhe një tjetër, si të donte ta shoqëronte listën e ëmbëlsirave që i servirte teorikisht modhista dhe që ia sqaronte prakti-

kisht e bija, e cila ishte shumë e specializuar, sidomos në sektorin e konsumit të ëmbëlsirave.

Ndërsa ato vazhdonin të demonstironin aftësitë e tyre në fushën e ëmbëlsirave, Llajni tha:

— Do të më pëlqente shumë të vazhdonim këtë bisedë, e cila më duket më e ëmbël se ëmbëlsirat tuaja që bëni me aq mjeshtëri, po kush e dëgjon motrën, sa për atë tjetrin, që është daja im, me të merrem vesh.

— Po si të bëjmë, — pyeti Sofija.

— Si të bëjmë, — vazhdoi Llajni. — Për të bërë mund të bëjmë ndonjë gjë, po edhe unë s'kam shumë kohë, se së shpejti mund të vijë vetura të më çojë në Rrëshen. Telshe të mëdha, këtej fejohej ime motër, andej më presin në Rrëshen. Me ju s'më ndahet zemra!

— Sa keq që do të na ikni kaq shpejt, — tha Sofija.

— Ikim shpejt që të vijmë shpejt. Sa mirë që u kujtova, — vazhdoi Llajni, sikur zbuloi diçka të re. — Për të ndenjtur edhe pak me ju, i duhet thënë sime motre se erdhi vetura dhe u nisa urgjent krejt papritur.

— Shumë mirë, — tha Katjusha.

— Shumë mirë, — përsëriti edhe e ëma.

— Atëherë kush duhet t'i lajmërojë? — tha Llajni. — Se, po të shkoj unë, ç'u mor vesh? Ime motër, nga malli që ka për mua, do të më ndjekë pas derisa të hipi në makinë.

— Po shkoj unë t'i lajmëroj, — tha Katjusha. — Po ku t'i gjej?

— Për t'i gjetur mua më lanë një adresë, — sqaroi Llajni. — Mund t'i gjesh tek agjencia e pasagjerëve.

— Atëherë po shkoj unë, — tha Sofija sikur edhe ajo nga ana e saj të kishte bërë një zbulim.

— Bukur, — tha Llajni. — Kamarier, edhe një dopio ponç. Pra, do t'i thoni kështu: Erdha t'ju lajmëroj se miku i ngushtë i burrit tim dhe njeriu juaj i shtëpisë, u nis krejt në mënyrë të papritur dhe urgjente në zonat e Veriut.

Pasnesër në mëngjes ta prisni domosdo në shtëpi. Të mos largoheni në asnjë mënyrë nga shtëpia që të mos ngatërroheni.

Sofija u ngrit. Llajni i dha porosinë e fundit:

— Asnjë fjalë më shumë ose më pak. Të mos e prisim dasmën për një limua.

Sofija shkoi me qejf ta zbatonte porosinë e dhëndrit të saj, që tashmë priste me padurim sa të shpallte fejesën. Por aq më mirë, se do të bënte muhabet me krushqinë e re. Kjo ishte një ditë e lumtur për Sofijen dhe këtë lumturi, sikurse ia shtiu në vesh i shoqi, e sollën dy gjëra të çuditshme të premierës së re: rrota në skenë dhe skeçi për gjuetinë.

Njërën porosi Sofija e kreu me sukses. Krushkën e bukur dhe krushkun namuzli i gjeti në stacionin e autobusëve. Por dëshira e saj nuk mbeti përgjysmë, sepse ata, sa morën vesh lajmin, u mërzitën dhe s'donin jo të bënin muhabet, po as të rrinin në asnjë vend.

— Pasnesër në mëngjes ta prisni gjallë a vdekur në shtëpi, — përsëriti ajo, si të donte të hynte me çdo kusht në muhabetet e saj, por as njëri, as tjetri s'e kishin mendjen. Prandaj, pa ç'pa, u dha dorën, gjithnjë e nisur nga porosia e dhëndrit se mos, duke ndërhyrë, mund të prishte punë. Mirëpo, kur u kthye në ëmbëltoare, mbeti e shtan-gur, se nuk u besonte as syve të saj.

Llajni dhe Katjusha ishin zhdukur.





## Kreu i tretë

### HALLË XHEMILJA SHIKON FILXHANIN

Atë e bijë e pritën Llajnin gjithë ditën, sipas lajmit që morën në agjenci, se ai do të vinte të pasnesërmen, gjallë a vdekur. Por ai nuk erdhi as gjallë, as vdekur.

Të nesërmen në mëngjes Asllani shkoi në zyrë me pensionet e së bijës se duhet të bënte çmos për ta gjetur në telefon. Por edhe ajo vetë nuk ndenji duarkryq. Shkoi te komshia e tyre, plaka Xhemo. Ajo njihej si llafazania e tërë mëhallës, po kohët e fundit ishte bërë uloke e s'dilte as te pragu i shtëpisë. Megjithatë, edhe pse këmbët e lanë, fuqinë e mori më shumë goja.

— Hallë Xhemo, — i tha Duneranka, kur hyri në shtëpinë e saj e u përshëndosh te shtrati. — Erdha të pi

një kafe me ty, se e kam pjekur taze dhe është kafe Bra-  
zili.

— Më rrofsh, moj bijë, — i tha e gëzuar plaka më shu-  
më e etur për muhabet sesa për kafe.

Kur Duneranka bëri kafën dhe e pinë, duke i marrë  
filxhanët, i tha:

— Hallë Xhemo, pa ma shih një herë filxhanin.

— Moj bijë, po edhe ti që je me shkollë ke qejf ta  
këndoj filxhanin? Po s'ju mjaftojnë tërë ato libra që kën-  
doni? — tha me qesëndi.

— Hallë Xhemo, librat janë libra, po edhe filxhani  
është filxhan. Atë që thotë filxhani, s'e thonë librat.

— Eh! — tha prapë plaka. — Po yt atë prishi tyrben.  
S'ka javë që dervishi i saj të mos më shfaqet në ëndërr.

— Të shfaqet në ëndërr? Po si të shfaqet, moj hallë  
Xhemo?

— Tek Asllani e ka mendjen. Ai që u bë Asllan me  
mua, kur të vijë në këtë botë, nuk do të jetë as mi. Do ta  
futim në katran e do ta ziejnë.

— Mos, moj hallë, po ti nuk i thua se ai është burrë  
i mirë e se kryetari i frontit e mori me vete për të prishur  
tyrben?

— I them, moj bijë, i them, po gjynahu nuk lahet me  
llafe.

Duneranka e mori filxhanin që kishte lënë mbi tavo-  
linë e ia dha në dorë hallë Xhemos.

Ajo, si e pa një copë herë me vëmendje, duke e rrotu-  
lluar herë djathtas e herë majtas, foli e menduar:

— Ke një njeri që të do shumë, të do, po halli që ke  
një hasm që kërkon ta prishë këtë dashuri. Llafet janë shu-  
më, me atë hasmin që ke, bashkohet edhe një tjetër, po  
s'ka ç'të bën. Ti je e bukur dhe bukurinë tënde ta kanë  
zili edhe shoqet. Ti prapë do të marrësh një burrë të pa-  
shëm, të mirë. Mirëpo burri yt s'është këtu. Ai është në  
një rrugë, por ama mendjen e ka te ti.

Dunerankës i pëlqeu fjala e hallë Xhemos, prandaj filloi ta pyeste edhe më shumë.

— Po unë si i dukem burrit, hallë Xhemo?

— E bukur, shumë e bukur, — i tha ajo. — Ai lot menç për ty. Po edhe ti duhet të dish ta lozësh mendsh, — i tha hallë Xhemoja.

— E ç'të bëj unë? — pyeti Duneranka me kureshtje dhe me etjen për të vënë në jetë këtë mësim të hallë Xhemos.

— Sille këtu, t'i shtie fall unë, pa e bëj atë pizeveng që të shkallojë fare për ty.

— Po ku e di ti që e kam gjetur unë burrin, moj hallë? — vazhdoi Duneranka.

— Unë nuk e di, moj e Bukura e Dheut, po ma thotë filxhani.

— Sa e mirë je, moj hallë Xhemo. Po unë kam ardhur të më thuash kur do të vijë!..

— Që të ta them kur të vijë, më thuaj kur të ka thënë se do të vijë.

— Më tha të martën në mëngjes se këtë të enjte gjallë a vdekur do të ishte në shtëpinë tonë.

— Si the, moj, të martën? — pyeti hallë Xhemoja.

— Po, të martën më tha se do të vinte të enjten.

— Epo e marta ka një sahat të lig.

— E si, nuk do të vijë më?!

— Mos u bë merak, — e qetësoi plaka. — Atë e bëj unë që të vijë duke kërcyer me një këmbë.

— Po ma bëre këtë, unë nuk e di se ç'do të bëj për ty!..

— Ke hak, se femra e bukurira ka shumë, moj e Bukura e Dheut, e mashkullit ia marrin mendtë.

Këto fjalë ia shtuan xhelozinë Dunerankës. Po plaka Xhemo, për t'i nxitur edhe më tepër zilinë ndaj saj, që dinte kaq mirë t'ia gjente me filxhan dertet, i tha me qesëndi:

— Cingunllëku i tyt eti është haram. Ja si del. Ti do

të ishe fejuar e martuar, po njerëzia e dinë që është cingun.

— Sa për atë, mos pyet, — vazhdoi Duneranka me inat. — Ai është cingun, po s'jam unë cingune. Ja tregoj unë cingunllëkun atij.

Që atë ditë, çdo pasdreke Duneranka shkonte te plaka Xhemo e kthehej vonë, saqë detyrohej edhe i ati ta priste te dera.

— Kur dëgjoj llafin tënd, moj hallë Xhemo, — i thosh-te Duneranka, — sikur shoh atë, prandaj kaq shumë më merr malli për ty, sa mezi duroj të vijë të rrimë bashkë.

— Kjo dëfton se ai ka mall për ty, po është i zënë me punë, bile edhe ai i ziu s'duron, po punë qeverie, moj bijë. Dhe asëll-asëll, ai punon shumë se të ka në zemër ty. Një burrë që ka një nuse të mirë bëhet me krahë, prandaj mos u mërzit. Mallin e nxjerrim bashkë.

\* \* \*

— A ke dashuruar ndonjëherë, moj hallë Xhemo? —  
— e pyeti një herë Duneranka.

— Për mua janë vrarë njëzet e kusur shpirt, — tha ajo.

— Po unë, moj hallë Xhemo, nuk të pyes a ke qenë në luftë, po a ke dashuruar.

— Po edhe unë nuk të flas për luftë, por për sevdanë. Sevdata në ato kohë nuk ishte si sot, e do, s'e do, e merr, s'e merr... Mua më rrëmbeu kauri se e desha, ama edhe ai, rahmet pastë e i ndrittë nuri atje ku i dergjen kockat, më desh, sa për mua la kokën. Më mori e më çoi atje sipër në mal, në vathën ku mbanin kopetë e deleve në behar, se në dimër i zbriste poshtë nga Myzeqeja, rahmet

pastë im atë. Ato janë tri ditët më të mira që kam parë në këtë dynja. Pas tri ditëve erdhën vëllezërit, më gjetën dhe e vranë në sytë e mi. E vranë e më muarnë mua. Po gjaku ndolli gjakun. I ati i tij vrau vëllanë e madh. Vëllai i vogël vrau të atin e tij. U ngrit vëllai tjetër vrau vëllanë tim të vogël. Vazhdoi dyfeku i hasmërisë sa u shuan meshkujt në të dy shtëpitë tona. Ato tri ditë hapën njëzet e kusur varre. Unë mbeta kërcure. Ishin të tjera kohë, moj bijë. Kjo ishte sevdaja ime, që më shoji me shtëpi e me katandi. Shkuan shumë vite e rrodhi shumë ujë. S'desha të martohem, por një dajiu im u bë sebeb e më dha te një burrë i ve me gjashtë fëmijë. Fëmijët nuk rrojtën, katër vdiqën pa u rritur mirë, dy të tjerët ikën në kurbet e s'u kthyen më. Burri ishte goxha plak e vdiq në moshë të shkuar, po unë mbeta si kërcure duke u rropatur nëpër shtëpitë e botës si hyzmeqare. Ishin kohë të tjera atëherë, moj bijë, s'janë si sot.

Plaka Xhemo fliste me dhimbje për jetën e saj. Ajo, përpara syve të Dunerankës tani nuk ishte as fallxhore, as llafazane, po një njeri që kishte vuajtur tërë jetën.

Duneranka ndjeu një të dridhur në trup. Atë ditë as plaka Xhemo, as ajo vetë nuk kërkuan të shtinin më në fall.

\* \* \*

— Hallë Xhemo, moj hallë Xhemo, — mbrëmë e kam parë në ëndërr, — i tha Duneranka sa hyri në derë.

— Shumë mirë. Njime ai të kujton. Njime do ta sjell unë.

— Sille një sahat e më parë, hallë Xhemo.

— E po që ta sjell, duhet t'ia këndoj.

— Po këndoja, moj hallë Xhemo, këndoja!

— Do t'ia kënoj, moj e Bukura e Dheut, po kënimi nuk bëhet me duar bosh.

— Tamam si në librin «Një mijë e një net», — tha Duneranka.

— Ato defteret i kënoni ju mirë, unë kam kënimet e mia.

— Hallë Xhemo, mos bëj shaka me mua.

— Jo, moj, jo, nuk bëj shaka. Po hë se më hutove, ma thuaj mua një herë si e pe në ëndërr.

— E pashë sikur ishim në një ballo e kërcenim pa pushim, bile, unë, ndonjëherë nuk kërcëja, po fluturoja.

— Po ai ç'bënte kur fluturoje ti?

— Mendohej të më zinte për fustani, po s'e arrinte dot.

— Mirë, po ç'lloj rrobash kishte veshur?

— Rroba? Rrobat s'i mbaj mend, — tha Duneranka.

— Po këpucët si i kishte, s'ia mban mend? Të vjetra apo të reja?

— Të reja.

— Të reja? S'është mirë puna.

— Jo, jo, më duket se i kishte të vjetra.

— E, po qenë të vjetra, puna është shumë mirë. Këpuca e vjetër në ëndërr tregon mirësi, tregon rrugë, tregon se ai do të vijë.

## S U A R E J A

Shqetësimi i modhistrës Sofije për zhdukjen e së bijës nga ëmbëltorja u kthye në një gëzim të dyfishtë. Vajza u gjet shëndoshë e mirë dhe parashikimi që ajo të fejohej me djalin nga Tirana u realizua.

Të nesërmen në mëngjes, modhista Sofije me të shoqin dhe vajzën shkuan në zyrën e gjendjes civile bashkë me dy dëshmitarë e dhëndrin e tyre. Bënë celebrimin, hëngrën llokumet dhe uruan njëri-tjetrin: «Çifti të na trashgohet.»

Atë natë Llajni me Katjushën u kthyen në shtëpi pas mesit të natës. Të nesërmen në mëngjes Llajni u nis duke thënë:

— Detyra, detyrë!

— Ndahemi të bashkuar, — tha Sofija pa e përmbajtur gëzimin.

— Tani kemi përpara një aksion tjetër të rëndësishëm, — u tha gazetari Thimio Thimi.

— Domosdo, — u përgjigj modhista Sofije. — Darka e fejesës duhet bërë që të mbahet mend.

— Ne do të bëjmë një darkë për barkun e shën Mërisë, — tha drejtori. — Mendoj se do ta bëjmë me miqtë, me një fjalë kjo darkë do të jetë si provat gjenerale, kurse me krushqit do të bëhet premiera.

Drejtori i estradës u ul në tavolinën e kuzhinës të shtëpisë së tij për të hartuar një akt tjetër, do të formulonte një ftesë për miqtë e shokët që do të merrnin pjesë në darkën që do të bëhej me këtë rast.

Sofijen s'e nxinte vendi. Ajo hynte e dilte në kuzhinë, ndërsa i shoqi pinte duhan, mendonte dhe shkruante. Më së fundi i tha së shoqes:

— Ja edhe ftesën e kam gati.

— Pa ma lexo pak, — vazhdoi modhista Sofije.

— «Ftesë, — filloi të lexonte i shoqi. — Me rastin e fejesës së vajzës sonë ju ftojme të merrni pjesë në darkën që do të organizohet nesër mbrëma në orën 20.<sup>30</sup>.»

— I, i, i, — tha modhista Sofije. — Darkë! Fjalë tjetër s'gjen, darkë organizojnë të gjithë.

— Mos u mërzit, Sofi. Varianti tjetër është: «Banketi

për nder të fejesës së vajzës sonë do të shkëlqejë nga pjesëmarrja juaj.»

— Bukur, — tha modhistrja Sofije, — po fjala banket është e zakonshme, tjetër.

— Atëherë, ta vëmë koktej, — tha i shoqi.

— Koktej?! ... Kjo fjalë më duket si amaretë. Është varfëri.

— E po atëherë, si ta vëmë? «Donomaja për nder të fejesës».

— Anadollak, — foli e nxehur modhistrja Sofije.

— E gjeta, — thirri i shoqi. — «Manifestimi për nder të fejesës së vajzës sonë do të jetë i papërshtatues në qoftë se do të na nderoni me pjesëmarrjen...»

— Fjala manifestim më duket e bukur, po mos vallë të ftuarit na e kuptojnë se do ta bëjmë pa kuzhinë?...

— E po si ta vëmë, «Ditët e satirës dhe të humorit...»?

— E vëmë karnaval, — vazhdoi modhistrja Sofije e papërmbytur.

— E gjeta, e gjeta, thirri prapë i shoqi, — ta vëmë suare.

— Suare, po, po, suare. Sa emër i bukur, sa kujtime kam nga im gjysh. Ai ishte mjeshtër i suareve, dhe atje unë kam mësuar dancin. Eh, gjysh, që nuk rron më, të shohësh suarenë e sat mbese kur fejon të bijën.

— Atëherë të bëjmë listën e të ftuarve.

— Bukur, — tha modhistrja Sofije.

— Bukur, — vazhdoi i shoqi.

— Kjo është një suare moderne në qytet, prandaj s'kemi pse lajmërojmë të na vijnë nga fshati.

— Po fshatarët janë gjyshë dhe gjyshja e Katjushës, xhaxhai dhe xhaxhesha, janë babai dhe nëna jote.

— A, të lutem, — tha modhistrja Sofije, — ata vërtet janë nga Kryemëdhenj, po banojnë në qytetin e Rrogzhi-nës. Mos i ngatërro gjërat.

— Mirë pra, si të bëjmë?



— Hiq qytetarët e Rrogozhinës, nga të tjerët ftojme vetëm nga një përfaqësues. Nga fshati vetëm një.

— Cilin? — pyeti i shoqi.

— Cilin, njeriun që respektoj më shumë, vjehrrin tim të dashur dhe babanë tënd që punon në bufenë e Mamina-sit. Bën një rrugë e dy punë, edhe gëzohet, edhe gatuan.

Ata u hëngrën një copë herë, mirëpo, me gjithë heqjen e fshatarëve, lista u mbingarkua me qytetarë që s'i nxinte dot shtëpia.

— Të seleksionojmë ndonjë, — tha i zoti i shtëpisë.

— Të seleksionojmë, po cilin? Të gjithë duhet të jenë, sepse secili ka vendin e nderin e vet.

— Ja p.sh. të heqim drejtorin e filarmonisë, të cilit s'i kemi vajtur asnjëherë dhe as na ka ardhur ndonjëherë.

— Ha, ha, ha, ç'na the, — u hodh e shoqja. — Po drejtori i filarmonisë është lezeti i darkës.

— Atëherë të heqim drejtorin e shtëpisë së kulturës.

— Ha, ha, ha, — ironizoi prapë e shoqja. — Të heqim burrin më simpatik të qytetit.

— E po atëherë të heqim përgjegjësën e rrobaqepësisë speciale për burra.

— E, sipas teje, të vijë vetëm përgjegjësja e rrobaqepësisë speciale për gra! Kjo punë do të bëhet me lezet. Po e di ti që përgjegjësën e burrave e kemi edhe kryetar të komitetit profesional.

— Mirëpo kë të heqim, s'ka vend.

— Vendin e gjej unë, mos u bëj merak, po të jetë sa për një burrë e përgjegjës. Burrë për burrë unë i lutem vjehrrit tim. I them: i dashur vjehrr, për hir të nuses sate sakrifiko sonte dhe, ai, jo do ta pranojë me gjithë qejf, po do të gatujë edhe më mirë, se s'do ta ketë mendjen më dysh në kuzhinë o në tavolinë.

— Bukur, — vazhdoi i shoqi, — atëherë të heqim këngëtarin Qani Firifiu.

— A mund të kuptohet suareja pa këngëtarin Firifiu?

Po ti ke të drejtë, se je fshatar. Po «La dona e mobile» kush do ta këndojë?

Si u rrahën e u stërrahën mendimet, u vendos unanimitet që të hiqej dera e dhomës së pritjes e tavolinat të vazhdonin edhe në korridor.

## MËHILLI NIS TË DËRGUARIN E TIJ

Ndërkohë që në familjen e drejtorit të estradës po përgatitej darka përpara fejesës, në shtëpinë me avlli, të veshur me pjergulla, të Asllan Lalës hyri një burrë i shkurter, me një kapelë të zezë pa strehë dhe me një bastun në dorë.

Gjethet e mëdha të pjergullave shushurin nga era e asaj mbrëmjeje pranverore.

Asllani doli dhe e priti në verandë. Të dy burrat u përshëndoshën dhe u ulën secili në një poltronë kashte.

— Merhaba, — i tha burri me kapelë të zezë, duke vënë dorën në zemër.

— Ejvallah, — ia ktheu Asllani.

Burri me kapelë të zezë nuk dëgjonte mirë nga veshët, aq më tepër se edhe frynte erë e fëshfërinin fletët e hardhive.

— Ç'e mirë të solli? — pyeti Asllani.

— Të mira paç e gjetsh ngahera.

— Të rrosh, — ia ktheu Asllani.

— Lepe, — iu përgjigj burri me kapelë të zezë duke vënë dorën te veshi për të dëgjuar ç'thoshte i zoti i shtëpisë.

— Të rrosh, të rrosh, — tha Asllani.

— A, po, — tha burri, — me gjithë ju bashkë.

- Ç'kemi ndonjë të re? — pyeti prapë Asllani.
- Të rejat e të mirat i kam sjellë me vete.
- Urdhëro e fol!
- Kam ardhur të kërkoj dorën e vajzës sate për nipin.
- Dorën e vajzës sime! — tha Asllani i çuditur.
- Po, po, — tha plaku. — Ne të dy jemi me adetet e vjetra. Krushqia na shkon.
- Po nuk e ditke ti që ajo është e fejuar në Tiranë?
- Kam marrë vesh një gjysmë llafi, po, me sa më thanë, ajo punë s'u mbarua e u la përgjysmë.
- Kush të tha? — pyeti Asllani me një lloj mospërfilljeje. — Se unë s'di gjë.
- Po atë e di gjithë pazari. Plaka Xhemo, gjersa më tha edhe mua, s'ka lënë njeri pa ia thënë.
- Këto janë muhabetë badiava, — shtoi Asllani gjysmë i nxehur.
- Dale, dale, mos u nxito. Ma jep cucën tënde ta marr nuse për tim nip.
- Cilin ke nip zotrote?
- Nuk e njeh ti nipin tim, po e njeh jot bijë.
- Ime bijë?! . . .
- Po, po, Mëhillin e njeh.
- Thotë një fjalë e moçme, — tha Asllani me përbuzje. — Atë s'e qasin në fshat, kurse ai kërkon të bijën e priftit.
- Më dëgjo mua, or Asllan, — tha plaku. — Jepja çupën Mëhillit e mblidh mendjen. Të dy një kokë kanë, një feste duan.
- Çupa është e fejuar, prandaj ti mblidh mendjen, — vazhdoi më i nxehur Asllani.
- Ti bëj si të duash, po gazi i botës mos u bëj. Ai stan atë bulmet ka, — tha plaku dhe u ngrit.
- Asllani s'luajti nga vendi. Ai vështronte me inat siluetën e plakut që lëvizte nëpër terr si një hije laramane nën pjergulla.

## Kreu i katërt



### **DHËNDRI TË MERR VAJZËN, TË MERR EDHE KREVATIN**

— Suareja po i zhvillon punimet me sukses të plotë,  
— tha gazetar Thimio Thimi duke marrë fjalën për të ngri-  
tur dollinë e rastit.

Mirëpo gazetari nuk i parashikoi dot përfundimet e  
plota e të suksesshme. Kjo mungesë parashikimi erdhi, në  
radhë të parë, nga organizatorët e suaresë.

— Pjesëmarrja u tejkalua, — vazhdoi gazetari, — dhe  
kjo dëshmon se ne kemi forca dhe rezerva të pashtershme  
për sa u përket miqve dhe shokëve.

— Si një diell që ngroh gjithmonë, ashtu erdhi edhe në këtë shtëpi dhëndri që na ngrohu të gjithë, — tha libretisti i estradës, Dilo Foka. Ai, atë natë, kishte ardhur nga kryeqyteti ku po vazhdonte kursin pasuniversitar në degën e kritikës letrare.

Meqenëse parashikimi i pjesëmarrësve u tejkalua për arsye se një pjesë shokësh e miqsh të drejtorit erdhën pa ftesë, madje një tufë shoqesh të modhistrës erdhën edhe me peshqeshe, ajo e pa të udhës që në asnjë mënyrë të mos largoheshin. Atëherë u gjet një rrugë tjetër praktike. U zbraz edhe dhoma e gjumit.

— Dhëndri jo vetëm që ta merr çupën, po të heq edhe krevatin, — tha këngëtari Qani Firifiu, — bile pa qenë prezent këtu shoku dhëndër. Sa për gjyshin që erdhi nga bufeja e Maminasit, ai e vendosi selinë e tij te komshiu përballë. Meqenëse ai zhvendosi komshiu nga kuzhina, komshiu me të shoqen dhe dy fëmijët u vendosën në tavolinën kryesore të miqve.

Në fillim fjalët e dollitë ishin të rralla, por, për t'i dhënë zjarr suaresë, modhistrata Sofije urdhëroi me zë të lartë:

— Të lozim kadrilen!

U dëgjuan duartrokitje që tregonin miratim të fjalëve të modhistrës.

Po doli një vështirësi e paparashikuar. Vendi ishte i ngushtë. Mirëpo, këngëtarit Qani Firifiu i erdhi një mendim në kokë. Dhe, që të mos e mbante brenda vetes e t'u vinte në ndihmë pjesëmarrësve të suaresë, tha:

— Kadrilja mund të luhet në korridor, ndërsa napoloni mbi tavolinë.

Gjindja duartrokiti.

Modhistrata Sofije me të shoqin dolën të parët në korridor dhe, duke u zënë allabraca, nisën kadrilen. Pas tyre rendën të tjerët. Orkestra u ngjit në shkallët e apartamentit.

— Në këtë gëzim kaq të madh na mungon kryesori, — tha drejtori i filarmonisë, — domethënë dhëndri.

— Ai nuk mundi të marrë pjesë, sepse u nis urgjent për në Tiranë, — sqaroi gjindjen vjehri i ri. — Po kjo sonte është suare për ne, kur të vijne krushqit, atëherë ajo është tjetër punë.

— Edhe një të drejtë e kishte, — vazhdoi modhista Sofije. — Si do të vinte ai pa krushkun e krushkën, pa mo-trat e vëllezërit e tij? Prandaj sonte për nderin e tij bëjmë qejf ne.

— Ku punon dhëndri? — pyeti përgjegjësi i roboqep-sisë speciale të burrave.

— Në Komitetin e Arteve dhe të Kulturës. Ai thotë se është inspektor, në të vërtetë ai zëvendëson drejtorin e kulturës, i cili mungon. Për këtë janë bërë propozimet, po ju e dini, burokracia bën të vetën.

— Si e quajnë dhëndrin? — pyeti këngëtari Qani Firifiu, kur mbaroi së kënduari këngën «O sole mio».

— Ne i themi Llajn, po origjinal e ka Liman, Liman Panajoti, kandidat i shkencave, — shtoi ai nga vetja.

— Aheng, more, aheng, — bërtiti drejtori i filarmo-nisë. — Ne kemi ardhur për gëzim, jo për t'u bërë bio-grafinë njerëzve.

Kadrilen e filloi prapë modhista Sofije me drejtorin e filarmonisë. Po s'qe e thënë të vazhdonte loja gjer në fund, se, një shkallë sipër, prapa orkestrës, u pa fytyra e hakërryer e komshiut të katit të sipërm, kandidatit të shken-cave merceologjike, Limoz Bletasit.

— Të tjerë fejohen, të tjerë gëzohen, të tjerë tër-bohen, — thirri ai. — Po gdhin e ne po lozim mendsh!

Orkestra pushoi dhe ra njëfarë qetësie, po, në këtë çast, nga shkallët po ngjitej komshiu i tyre, Mehalim Gjoza, çakërrqejf. Ai thirri:

— Kush e prish ahengun, dënohet me një dopio raki.

Njerëzit qeshën. Limoz Bletasi u mat të fliste, po e

pa se nuk e hante dot me çakërrqejfin e Mehalim. Ai ngjitej përpjetë shkallëve duke u grindur me vete.

— Durim edhe pak, o shoku Limoz, se së shpejti na merr dhëndri në mes të Tiranës.

\* \* \*

Kur u kthye prapë letra e tretë që mbante adresën «Shokut Liman Panajoti, Komiteti i Arteve dhe i Kulturës, Tiranë» me shënimin «personi nuk gjendet», drejtori i estradës, me trupën, po hipte në autobus për të dhënë shfaqje në kryeqytet. Po kësaj radhe, domosdo, ai shoqërohej nga modhistrat Sofije dhe laborantja Katjusha, të cilat nuk do të jepnin shfaqje, por do t'u jepnin kënaqësi krushqve. Kjo kënaqësi vinte se modhistrat Sofije, jo vetëm do t'u bënte të njohur atyre të bijën, por edhe mjeshtërinë e saj, me fustanet e modës së fundit që mbushnin një valixhe, dhe me ëmbëlsirat me emrat më të çuditshëm që mbushnin një borsetë të madhe.

Trupa zuri vend në hotel «Peza», ndërsa drejtori me familjen e tij në hotel «Tirana».

Libretisti i estradës që e konsideronte veten kryeqytetas, si të donte t'i bënte një surprizë drejtorit të tij, shkoi atë mbrëmje në Komitetin e Kulturës dhe të Arteve për të gjetur dhëndrin, po, si dha e mori me nëpunësin e shërbimit për adresën e shtëpisë së shokut Liman, nuk mundi ta gjente. Madje, më keq akoma, nëpunësi i shërbimit i tha se njeri me emër të tillë nuk gjendej në komitet.

— Ju jeni në riorganizim, — theksoi libretisti, — dhe akoma s'e njihni njëri-tjetrin.

— Unë njoh një Liman, — tha nëpunësi, si për ta sqaruar më mirë libretistin. — Ai vërtet merret me kulturën, po është përgjegjës i vatrës së kulturës në Bërxull.

## DY NJERËZ KËRKOJNË NJË TË TRETË

Dy njerëz ka ditë që sillen nëpër Tiranë.

Sa gdhin mëngjesi, ata kapërcejnë pragun e hotelit, shkojnë nëpër zyra e ministrira. Kthehen në hotel dhe duken si dy sekserë të ethshëm që përpiqen të blejnë apo të shesin një mall. Dhe vërtetë duan të gjejnë një mall të humbur, një fat që u erdhi në derën e shtëpisë e që s'ditën ta mbanin. Këta dy njerëz janë Asllani dhe Duneranka.

Kanë pyetur, ku s'kanë pyetur. Në fillim nisën nga ministritë, apo edhe më lart, po atje nuk ekzistonte ndonjë njeri me emrin Llajn. Kështu dalëngadalë e zbritën pazarin dhe arritën gjer në këshillat e lagjeve e në ndër-marrje. Sado që me kërkime s'bënin e s'gjenin gjë, prapë nuk i humbisnin shpresat.

Një herë ranë në një të quajtur «Llajn». Por, kur vajtën e gjetën këtë Llajn, mbetën të habitur. Para tyre qëndronte një djalë i shkurtër, thatim, me mustaqe, me njërin sy jeshil e me tjetrin të zi. Ai nuk ishte as djalë ministri, as i ndonjë nëpunësi të lartë, po këpucar në Ndërmarrjen Komunale të Riparim-Shërbimeve. Llajni i shkurtër, pa ditur se ç'kishte bërë adashi i tij i gjatë, e pëlqeu Dunerankën, prandaj iu qep asaj, sa ajo s'dinte ku të futej me të atin. Një natë, nën ballkonin e dhomës së hotelit ku flinin, dëgjuan një moledi kënge. Fjalët erdhën të qarta, të shtruara e me mallëngjim.

*Vare veten me kollare, o Dimo...*

Dunerankës iu drodh kurmi. I ati, në shtratin tjetër, gërhiste dhe e bezdiste Dunerankën që donte të dëgjonte këngën. Ajo u ngrit e doli në ballkon. Atëherë kënga mori zjarr:

*U bu-bu, i mjeri unë për ty, u bu-bu!...*



\* \* \*

Prapë ranë në gjurmët e një Llajni, po, në të vërtetë, kur e gjetën, mësuan se ai e kishte emrin Llano. Dhe, atë ditë që i vajtën në shtëpi, ai martonte të birin. Llanoja i sajdisi mysafirët, bile i quajti krushq.

Si s'gjetën Llajnin, gjetën një fallxhore. Dhe fallxhorja ua gjeti fatin.

— Ti ke një njeri që e do, por ai të do më shumë. Ke kismet e fat të madh. Ai njeriu që të do është këtu rrotull. E kërkon ti, të kërkon ai. Po ai ka një rrugë të gjatë. I vijnë edhe ca para, bile shumë para, po s'dihet nga i merr. Po ke edhe hasëm, një hasëm që të ka zili fatin.

Dhe me të vërtetë ato që tha fallxhorja dolën.

## VETURA E ZËVENDESMINISTRIT

Të nesërmen në mëngjes sa kapërcyen pragun e hotelit, përpara u doli ai që kërkonin: Llajni vetë. I gjatë, i veshur me rrobat bojë qielli, me syzet e zeza dhe me çantën nën sjetull, vinte drejt tyre.

— Llajn, — thirri Duneranka.

— Llajn, — thirri edhe Asllani.

Llajni thirri:

— Gëzim i madh!

Duke shtrënguar duart e duke u përçafuar, u tha:

— Sa ju kam pritur!... Sa mirë bëtë që erdhët. Ja, do t'ju dërgoja edhe telegram.

Hynë në barin e hotelit.

— Tri uiski, tri limonada dhe tri kafe. Ej, ti, Ladi, — vazhdoi t'i thoshte kamerierit kur po ikte, — mua uiskin ma bëj dopio dhe me pak akull.

Duke përpjekur gotat, Llajni tha:

— Nuk do të vonohemi shumë, se të tre bashkë do të shkojmë në ministri. Atje më pret zëvendësministri. Helbete, punë, pasaporta, e të tjera e të tjera.

— Gëzohem, — tha Asllani.

— Faleminderit, — iu përgjigj Llajni.

Duneranka, që ishte bërë flakë e kuqe, përdridhte me dorë një kaçurrel.

\* \* \*

Kur arritën në ministri, Llajni tha me habi dhe me keqardhje:

— Sa keq, sa keq! Vetura e zëvendësministrit nuk qenka!

Asllani dhe Duneranka shihnin me habi fytyrën plot hijeshi të Llajnit.

— Tani, — tha ai, — do të shkojmë të tre në shtëpi të njihemi me babanë dhe mamanë. Se dhe ata kanë pritur e janë bërë merak.

Ecën një copë herë nëpër një shetitore. Pastaj u kthyen në një rrugë të ngushtë. Nga fundi i saj, para tyre u shfaq një shtëpi me një portë të madhe të hekurt e me avllë. Sipër, mbi mure dhe mbi portë dukeshin degët e pemëve të çelura. Llajni qëndroi përpara portës e u tha:

— Prisni një minutë sa t'i lajmëroj prindërit që të mos u vijë si e papritur.

— Posii! — tha Asllani. — Fjalë me mend.

— Sa i edukuar je! — tha Duneranka.

Llajni shtyu portën e hekurt dhe u fut brenda. Asllani shihte degët e pemëve dhe i krahasonte me kopshtin e tij.

\* \* \*

Kaloi një copë herë. Llajni s'po dukej. Më së fundi u hap edhe dera e nga brenda doli një plak, pak i kërrusur e i veshur me një palë rroba ushtarake të zbardhura. Pamja e tij sikur i befasoi, por Asllani tha me vete: «Ky mund të jetë, në mos gjyshi, ndonjë mysafir, apo ndonjë që ka ardhur të qajë ndonjë hall.

— Cilin kërkoni? — pyeti plaku.

— Llajnin, — iu përgjigjën të dy me një gojë.

— Cilin Llajn?

— Llajnin tonë.

— Këtu, — tha plaka, — s'ka Llajn. Po ta doni Xhemalin, po. Ai është përgjegjësi ynë.

— Po pse ç'është këtu? — pyeti Asllani.

— Nuk e ditke, mor shok? Këtu është fidanishtja e luleve.

Ata hynë brenda të hutuar. Llajni kishte dalë nga porta tjetër e ishte zhdukur.

## LIMANI I DASMAVE

Emri Liman nuk ka të bëjë fare me atë vend ku qëndrojnë anijet, me një fjalë me portin. Ky është një emër arab disi i rrallë në vendin tonë që herë thirret edhe Limo. Po Limani i Bërxullit edhe se nuk ishte port, tek ai rrinin e shkarkoheshin shumë miq e shokë. Liman Panajoti ishte një fizarmonicist i zoti, të cilin, pasi kishte mbaruar shkollën e kulturës, e kishin emëruar në këtë vatër kulture. Po për të shpirti ishte fizarmonika. Prandaj edhe

shokët e miqtë e tij shkonin dhe e kërkonin ku të ishte për ta marrë nëpër dasma. Kur i binte ai fizarmonikës, thoshin, kërcenin jo njerëzit, por edhe trarët e shtëpisë, prandaj Limani njihej dhe, kur drejtori i estradës, pas informacionit që i dha libretisti, filloi të interesohej, që te njeriu i parë që pyeti mori këtë përgjigje:

— Për Limanin e dasmave e ke fjalën? Atë e gjen ose në dasma, ose në restorantin e hotel «Arbërisë» çdo mbrëmje. Ja, ç'është sot, e martë, atë, me siguri e ke sonte atje, se të martën nuk ka dasma.

\* \* \*

Ndërsa në sallën e estradës trupa shfaqte premierën me skeçin për gjuetinë e derrave që vërejtjet e të deleguarit ia kishin thelluar përmbajtjen, drejtori i trupës bashkë me modhistrën Sofija dhe laborante Katjusha kishin zënë një tavolinë në restorantin e hotel «Arbërisë». Meqë sezoni i gjuetisë së derrave të egër nuk kishte filluar dhe restoranti i specializuar s'ishte hapur ende, ata porositën nga një shishqebab derri të butë. Mirëpo, meqenëse hotel «Arbëria» nuk mban mish derri, kamerieri u ktheu derrin me viç, paçka se në çdo vend viçi bëhet ka dhe vetëm në restorant kau bëhet viç. Kur të shihni në ndonjë meny shishqebab kau, lajmëroni autorin që të ndërhyjë për të bërë shtesat përkatëse në tekstet kulinare që bëhen në shkollën e kuzhinierëve.

Drejtori i estradës dhe familja, duke ngrënë shishqebapin e viçit, mendonin për vërejtjebërësin e skeçit të gjuetisë që tashmë ishte njeriu i familjes së tyre.

Atë natë, me gjithë interesimin e drejtorit dhe të libretistit, nëpërmjet kamerierëve, Limani i dasmave nuk u duk në lokal.

\* \* \*

Shfaqja kishte sukses, madje, për t'u plotësuar kërkesat e spektatorëve, i propozuan trupës që ta jepte në pallatin e sporteve «Partizani», po drejtori s'e kishte mendjen aty.

— Megjithatë, — thoshte libretisti, — fakti që njerëzit e mirëpresin skeçin e gjuetisë, kjo tregon se vërejtjet e të deleguarit qenë me vend.

Në mëngjesin e ditës së dytë drejtori bashkë me libretistin hipën në një taksi dhe u nisën për në Bërxull.

\* \* \*

Vatra e kulturës ishte mbi një kodër të rrethuar me pemë. Në fushë poshtë punonin vajza e gra, po tingujt e fizarmonikës dëgjoheshin deri aty.

— Bjeri, dhëndri Liman, bjeri! — tha libretisti, — Po ti s'e di se po të vjen vjehri. — Në kodër frynte një fllad i lehtë dhe pemët fëshfërinin. Ishte koha e luleve, kur era shpërndante polenin për të lidhur kokrrat. Edhe kjo është një lloj martesë e pemëve, ndryshe nga e njerëzve që mund të bëhet në çdo kohë, e tyrja bëhet vetëm në pranverë. Po s'arritën pemët ta bëjnë, atëherë ato mbeten shterpa. Kokrrat, me gjithë dëshirën që mund të kenë për t'u lidhur, degjenerojnë, marrin formë të shëmtuara, bëhen mistrece e bien. Kur era nuk bën dot punën e saj, u vjen në ndihmë bleta.

Njeriu, si pjesë e natyrës, megjithëse e transformon atë, nuk mund të mos e kopjojë dhe nuk mund t'u shpëtojë në njëfarë mënyre ligjeve të saj. Edhe në këtë udhëtim të këtij mëngjesi të bukur, në qoftë se drejtori ishte era, libretisti ishte bleta.

Në këtë natyrë të përtërirë pas atij dimri të gjatë, vjeh-  
rri po kërkonte dhëndrin. Pas dimrit vjen behari, mendon-  
te drejtori.

Fizarmonika binte. Era frynte. Lulet e pemëve përkë-  
dheleshin me njëra-tjetrën.

\* \* \*

Para syve të tyre, në fund të sallës së madhe të shfaqje-  
ve, panë siluetën e një njeriu të përkulur mbi fizarmonikë.  
Ai i binte e këndonte ngadalë duke goditur me këmbë dyshe-  
menë sipas ritmit.

Ai nuk e kishte mendjen, po i binte fizarmonikës e kën-  
donte:

*Syçka si ato të tuat  
nuk gjenden në dynja,  
am ai që i ka shijuar  
se ve tjera nuk ka.*

— Kush është Limani, — tha drejtori i estradës si të  
donte të shkëpuste djalin nga fizarmonika.

Ai ngriti kokën disi i hutuar nga njerëzit që pa e s'i  
kishte ndier derisa ishin afruar pranë tij:

Ai hoqi duart nga tastiera e tha:

— Urdhëro!

— Kush është Limani këtu? — pyeti prapë drejtori.

— Unë, — tha djali dhe, duke hequr fizarmonikën nga  
duart, u ngrit në këmbë.

Para tyre qëndronte një djalë i shkurtër, pak ezmer  
me fytyrë pikaloshë me një palë syze të errëta.

— Syzet janë si të tija, — mendoi drejtori i estradës;  
— bile edhe flokët. Po pse më duket kaq i shkurtër.

— Urdhëroni, — tha prapë djaloshi.

— Ne kërkojmë Liman Panajotin, — sqaroi libretisti i estradës.

— Unë jam; — tha prapë djali.

— Ti!? — tha drejtori i estradës me autoritet si të kishte para një vartës që kishte bërë gabim dhe e kishte thërrur t'i kënkonte llogari.

— Në qoftë se doni Liman Panajotin, jam unë, në qoftë se doni Liman Keçiun, ai është tjetër. Shoku Liman është kryetari i kooperativës, burrë në prag të pensionit.

— Jo, jo, nuk duam të kooperativës, — vazhdoi sqarimin libretisti, — po të kulturës.

Drejtori rrinte i hutuar dhe me mëdyshje. Të jetë ky? Dhëndri im? Një herë mendoi se mos e kishte fajin rakia që kishte pirë bashkë me të. Mirë atë natë, — mendoi, — po të nesërmen, më doli, apo s'më doli pija. Hej, bela, o punë. Mblodhi mendjen se tani ishte esëll e s'kishte punë rakië dhe e pyeti:

— Me kë je i fejuar ti, djalosh?

— Unë i fejuar? — pyeti i çuditur.

— Po, po, ti, — tha libretisti i estradës.

— Bile jo i fejuar, po edhe i celebruar, — vazhdoi drejtori.

— Unë i celebruar?! — vazhdoi të habitej djaloshi.

— Po, ti, — tha prapë drejtori, — ja, nxirre letërnjoftimin e shihe vetë.

— Letërnjoftimin? — pyeti djaloshi. — Pse ta nxjerr, mos jeni policë ju? Nuk kam.

— Po çfarë ke? — tha libretisti i estradës, si për t'i zbuluar gënjeshtërinë. — Pasaportë për të dalë jashtë shtetit?

Drejtori u kthye nga libretisti e i tha:

— More, po është ky apo s'është ky? A e mban mend ti fytyrën?

— Fytyrën? — vazhdoi libretisti.

— Fytyrën, se ti në darkë në shtëpi me ne, ngrite për të njëqind dollari.

— A jo, jo, shoku drejtor, në darkë mua s'më more, more gazetar Thimion. Në suare po, atje ngrita dolli për shëndetin e dhëndrit, po dhëndri mungonte. Unë dhëndrin e marrja me mend kur pija rakinë. Pastaj, siç e ka rakia, ajo më mori mendtë mua. Unë kaq mbaj mend. Më tutje s'di ç'të them.

Drejtori u kthye nga djaloshi dhe e pyeti me inat:

— Po ty nuk të thërrasin Llajn?

— Mua Llajn? Jo, mua shokët më thërrasin Dockë.

— Dockë, e ç'domethënë Dockë? — shtyu më tutje pyetjen libretisti.

— Dockë më thonë, se jam i shkurtër e i shpejtë, ja, — dhe djaloshi bëri me dorë nga dritarja poshtë. — Docka mund të gjejmë nëpër rrënjët e atyre pemëve.

Jashtë frynte erë. Martoheshinulet.

## MAGJI APO ALIBI

Pas suksesit që pati shfaqja në pallatin e sportit «Partizani», drejtori ishte krejt i bindur se do të arrinte edhe suksesin tjetër aq të dëshiruar, do të gjente dhëndrin e tij.

Drejtori i estradës shkoi prapë pasdreke në qendrën kulturore të Bërxullit. Po këtë radhë, përveç libretistit, ishte i përforcuar dhe me ekspertë të tjerë të fuqishëm, siç ishin modhistrat Sofije dhe laborantja e shkëlqyer e dyqanit optik. Ato domosdo do të jepnin ndihmesën e tyre në identifikimin a ishte dhëndri i tyre Limani i dasmave.

Taksia doli nga Tirana dhe filloi të rendte me të katra në rrugën e asfaltuar ku anash saj ca punëtorë prisnin ple-



pa. Kjo bënte që, sa herë vetura priste vrapin, të bezdisej veçanërisht drejtori:

— Edhe një rrugë me asfalt të bësh me veturë; — tha ai duke medituuar, — e do gjesh pengesa, jo më të martosh një çupë, të bësh një dasmë.

Modhistrat Sofije me të bijën dëgjonin. Makina prapë ndalonte dhe drejtori prapë vazhdonte:

— Martesa është bashkimi i ligjshëm i një burri dhe i një gruaje për të krijuar familjen.

— Ligjërisht kjo punë është konsakruar, — shtoi libretisti, — tani pritet vetëm bashkimi.

— Njeriu ka edhe keqkuptime në jetë, — ndërmori prapë ai fjalën. — Sepse jeta është multiformë, por çështja është se duhet të kapesësh pas hallkës kryesore.

Modhistrat Sofije, e dëgjonte të shoqin me indiferentizëm, sepse ishte mësuar me filozofimet e tij. Por edhe ai sa herë shafqte ndonjë mendim që e konsideronte deduksionin filozofik ose frut të analizës dhe sintezës së një dukurie të caktuar dhe e shoqja nuk reagoonte, e kishte në majë të gjuhës shprehjen: «Ku filozofia, pa ku Sofija.» Mirëpo edhe e shoqja nuk mbetej prapa. Edhe ajo e kishte në majë të gjuhës kundërpërgjigjen «Pika, o Ahmet, me kë bëj muhabet.»

Frytet e këtyre kontradiktave joantagoniste në gjirin e ngrohtë të kësaj familjeje filloi dalëngadalë t'i vilte pjella e tyre, Katjusha. Ajo, që kur ishte fëmijë, duke mos ditur kujt t'ia dëgjonte fjalën, kujt jo, filloi t'ua bënte qejfin të dyve. Në fillim ndiente në veten e saj një bezdi e neveri të brendshme e i dukej vetja sikur ndahej më dysh, sepse tjetër mendonte, tjetër thoshte me fjalë, po, më vonë, u mësua me këtë gjë dhe s'i bënte më përshtypje. Kur bisdat trasheshin në sytë e saj, ajo largohej nga ata. Por edhe ata nuk e linin në harresë mungesën e saj. Prandaj secili nga prindërit, veç e veç, i shprehnin mllefën për njërit-tjetrin.

Ai i thoshte së bijës:

— Jot ëmë e ka trurin sa të një pule, prandaj s'ka si ta njohë dialektikën.

Ajo i thoshte së bijës:

— Yt atë është një calik që më një brimë i bie fyellit.

Ajo i thoshte të atit:

— Sa është maja e gjilpërës, aq e ka mendjen Sofija.

Ajo i thoshte së ëmës:

— Ai është një papagall.

Kur i ati qortonte të bijën, hidhej e ëma dhe e mbron-te ose e kundërta.

Në qoftë se «filozofi», me dialektikën e tij, e «ndizte zjarrin», modhistrat Sofije, me llafet e saj, i «hidhte benzinë». Prandaj të dy, për inat të njëri-tjetrit, plotësonin tekat e së bijës.

Thonë që karakteri i njeriut fillon e formohet gjer në moshën tre vjeç. Thonë se formohet edhe në moshën njëzet e shtatë vjeç. Rëndësi ka mjedisi ku formohet ky karakter. Një mendjelehtësi në familje merr përmasa të tilla në jetën e fëmijës sa është vështirë se korrigjohen. Sigurisht edhe në gjirin e familjes ka kontradikta, po tërë çështja është se ato nuk përballohen me mendjelehtësi, me inat dhe me egoizëm, aq më tepër në sy të fëmijëve.

Tani pjella e këtij bashkimi të ligjshëm për të formuar familjen nuk ishte më as tre vjeç, as njëzetetë vjeç, po rendte drejt të tridhjetave.

\* \* \*

— Ky është Limani, — u tha ai së shoqes dhe së bijës kur i shpuri përpara fizarmonicistit, i cili ishte duke bërë prova. — Dhe kjo, — vazhdoi ai, — është letërnjofti-

mi i saj. — Duke e hapur në faqen e katërt, lexoi «Shënime për ndryshime në gjendjen civile». — Ja, — dhe, duke ia afruar letërnjoftimin fizarmonicistit, vazhdoi leximin: «Martuar me sh. Liman Panajoti.»

— I kujt është ky letërnjoftim? — pyeti fizarmonicisti.

— I kujt duhet të jetë, përveç se i sime bije.

Limani i dasmave mori letërnjoftimin në dorë. Pa një herë fotografinë e saj, pa edhe Katjushën e tha i habitur:

— Unë i martuar?!... Unë po martoj të tjerët, prandaj më thonë edhe Limani i dasmave.

Modhistrat Sofije shihte këtë Liman me habi, me kurreshtje dhe me dyshim. Prandaj iu kthye të shoqit e i tha:

— Jo, ç'ne ky? Ku Limani ynë, pa ku ky!

E bija e vështronte këtë Liman, që s'kishte rroba bojë qielli e syze të errëta, që s'ishte i gjatë e me flokë të zez, po me një palë pantallona kafe, me një golf bezhë e me fytyrë të rrumbullakët, sy bojë qielli e trup të shkur-tër e rondokop.

Limani i dasmave ishte Limani i vogël i një vatre kul-ture fshati dhe ai në asnjë mënyrë nuk ishte Limani, dhëndri i tyre i mirë, i pashëm dhe me pozitë.

\* \* \*

Ata morën rrugën tatëpjetë. Drejtori i estradës i tha së shoqes:

— Po ti nuk e pe atë drejt letërnjoftim?

— Unë nuk e martoja time bijë me letërnjoftimin, po me dhëndrin. Atë e pashë dhe më pëlqeu. Po kjo, ja, më thertë mua, — dhe vuri pëllëmbën e dorës te qafa, — më thertë mua, është magji.

— Kjo mund të jetë një hipnozë, — kundërshtoi i sho-qi me dialektikën e tij. — Në kohët e vjetra me anën e hipnozës janë bërë...

— Kjo mund të jetë një alibi, — tha i menduar libretisti.

— Pse alibi? — kundërshtoi drejtori. — Kjo mund të jetë një telepati.

E vërteta ishte se kjo nuk mund të ishte as magji dhe as alibi. Llajni kishte bërë celebrimin me letërnjoftimin e humbur të Liman Panajotit. Por asnjërit prej të katërve nuk i shkoi ndër mend kjo gjë. Madje, edhe kur ata u kujtuan t'i kërkonin letërnjoftimin, ai shkoi te një dollap që ishte në fund të dhomës, nxori që atje xhaketën dhe, duke marrë nga xhepi portofolin, e hapi e u dha letërnjoftimin. Ata lexonin emrin, mbiemrin, panë fotografinë, lexuan edhe emrin e nëpunësit të gjendjes civile që kishte firmosur letërnjoftimin. U ndalën me vëmendje te faqja e katërt, në krye të së cilës shkruante: «Shënime për ndryshimin e gjendjes civile». Më poshtë faqja ishte bosh. E krahasuan këtë faqe me atë të letërnjoftimit të Katjushës. Ishte e qartë. Katjusha ishte martuar me Liman Panajotin. Këtë e vërtetonte edhe vula, edhe firma e nëpunësit të gjendjes civile.

## EPILOG

As vetë Llajni nuk ishte i ndërgjegjshëm se si po i realizohej dëshira e tij për të shkuar jashtë shtetit. Po prapë, thoshte me vete, jam njeri me fat. Edhe kur tregonte për kujtimet që kishte nga Holanda apo vende të tjera e gjente njerëz e mjedise që e dëgjonin me kureshtje, i krijohej një përshtypje e pashpjegueshme që sikur me të vërtetë kishte qenë. Ai i tregonte këto episode me një bindje dhe siguri të tillë, sa e dëgjonin me kureshtje e gati të sugjestionuar e, ndoshta, edhe me zili, siç ishte fjala vjen Duneranka apo adashi i tij Asllan. Sa për Mëhillin nuk diskutohej.

Ai kishte një zë të çuditshëm. Në dy-tri fjalët e para të dukej sikur ishte monoton, po shumë shpejt ai të bënte për vete sa kishe qejf ta dëgjoje. Ai kishte një aftësi imituese të çuditshme.

Mos vallë ky njeri ishte një «personalitet paranojat?» Në qoftë se do të ishte i tillë, nuk do t'i hyhej nga autori këtij mundimi. Ç'është «personaliteti paranojat»? Ky është një tip që, ndoshta pa e gjykuar thellë, mund të të ngjallë humor, bile edhe të pakrahasueshëm, po, në themel, ai bart një trishtim, sepse ai është një tip patologjik që kërkon trajtim joletrar, por mjekësor.

Autori ka njohur një tip të tillë në një klinikë psikiatrike dhe njohja ndodhi për shkak të një pyetjeje të rastësishme. Ai ishte një njeri krejt normal, prandaj, ndoshta pa u menduar, e pyeta:

— Po ju pse keni ardhur këtu?

— Unë? — tha ai. — Ja, të tregoj pse kam ardhur këtu. Papritur, një ditë m'u duk vetja sikur isha mbret i Lushnjës. M'u duk një gjë e pabesueshme. Megjithatë në mendje më rrinte pyetja: A jam apo s'jam mbret i Lushnjës. Herë-herë më dukej vetja se nuk isha dhe qetësohesha, por prapë më bëhej sikur dikush më thoshte se je mbret i Lushnjës. Jam apo s'jam? E po, në qoftë se unë isha mbret i Lushnjës, s'mund të rrija atje, prandaj erdha këtu.

— Po tani si e ndien veten?

— Rrallë më thotë ndonjëherë mendja se jam mbret i Lushnjës. Po këtë e di më mirë profesori, për të cilin kam krijuar një respekt dhe bindje të plotë se do të ma zgjidhë drejt dilemën time.

\* \* \*

Mirëpo atëherë ç'është ky personazhi ynë kryesor? Mos është një tip budalla? Kjo, edhe sikur ta merrte guximin ta thoshte autori, do të ishte e pabesueshme. Heroi ynë është një njeri që, jo që s'ka të bëjë me debilin, përkundrazi ka mundësi të tilla që të krijojë një personalitet të vetin dinjitoz në shoqëri. Fatkeqësia e tij është se ai rrugën e jetës e ka zgjidhur në mënyrë të shtrembër.

Duke ecur nëpër këtë rrugë, për të kuptuar se ku ka arritur, logjika e kërkon të tregojmë se nga është nisur. Dhe pikënisjen e këtij udhëtimi në jetë, duhet ta gjejmë në familje.

Alush Panajaja, i biri i Rauf Panajasë, u martua në moshë të madhe me Firdesin, bijën e vetme të bufetier Zenun Zenunit. Dhe nga kjo martesë, pas katër vajzave, patën vetëm një djalë, të cilin e konsideronin trashëgimtarin e denjë të tyre.

Dobësinë më të madhe i ati e kishte për djalin. Po, në qoftë se ai e quante të zgjuar, e shoqja s'ishte dakord me të shoqin dhe fëmijën e quante gjeni.

— Ai, — thoshte ajo, — ngjashmërinë e fytyrës e ka marrë nga Panajatë, ndërsa si gjeni ngjet nga Zenunët.

I shoqi s'ishte dakord me këtë përcaktim dhe nevrikosej.

— Im atë, bufetier Zenun Zenuni, — vazhdonte e shoqja, — pa shkollë dhe u bë i famshëm, po të kishte shkollë, — thellohej më tej ajo, — me siguri do të ishte ndonjë shpikës i madh.

Dhe filizi i tyre rritej.

Në moshën 5-6 vjeç, sa vinte një mysafir në shtëpi, djali i thoshte:

— Na jep një cigare ta ndezim.

Kur ndizte cigaren, i ati thoshte me mburrje:

— Është shumë i zhvilluar për moshën që ka.

— Sa me elegancë e mban cigaren, — vazhdonte e ëma.

Mysafirë, i zënë ngushtë, vazhdonte:

— T'ju rrojë e me jetë të gjatë!

— Tregoi xhaxhit ç'do të bëhesh kur të rritesh, — thoshte prapë e ëma.

— E di vetë!

— Ç'përgjigje e mrekullueshme, si prej diplomati, — ndërhynte shpejt e shpejt e ëma.

— Sa modest që është, — vazhdonte i ati.

Me këtë zhvillim të madh në familje ai u ul në bankat e shkollës.

\* \* \*

Skandali u krijua nga një gjë farë e vogël. Alushi u mërzi se mësuesja i tërhoqi vërejtje djalit. Mërzitjen e çoi më tej e shoqja. Ajo vajti dhe u zu me mësuesen.

— Këtë që i the djalit, që të jetë i vëmendshëm në mësim, ta marrësh prapë ti, mësuese. Ai nuk është fëmijë sidokudo!

— Fëmija juaj është tepër i shpërqëndruar në mësim, prandaj duhet të punojmë bashkë për ta korrigjuar.

— Ti s'mund ta kuptosh djalin tim. — Dhe, duke u nxehur më shumë e pa e përmbajtur veten, i tha mësueses: — Ai nuk mund të durojë mësimin e një idioeteje.

Pas kësaj përplasi derën dhe shkoi u ankua në drejtorin, ndërsa Alushi vajti në seksionin e arsimit dhe në ministri. Ndërsa djali s'vajti asgjekundi, as në shkollë. Alushi vazhdoi të kërkonte të drejtën për ofendimin që i ishte bërë fëmijës së tij. Ndërsa e shoqja vazhdonte të thoshte kudo:

— Po ma prishin djalin dhe njeri nuk na dëgjon, se mësuesja është krushka e shokut Fejzi. Po ne do ta kërkojmë gjersa të dalë e drejta në shesh.

\* \* \*

Kur dy vjehrrat, dy vjehrrit dhe dy të fejuarat e tij vazhdonin kërkimet e tyre, ai vazhdonte disa kërkime të tjera. Ishte i bindur se do të shkonte jashtë shtetit. Dhe kjo bindje e tij, që zuri fill me udhëtimin e parë për në qytetin me katër porta, po i forcohej përditë e më shumë.

Atë ditë, kur doli nga dera e pasme e fidanishtes së luleve dhe hyri për të pirë një birrë në bufe «Riviera», njo-hu një shok të ri. Ai pinte birrën më këmbë, pranë një tavoline pa karrige, kur një djalë i ri, gati moshatar me të, me një veshje ndoshta edhe më elegante se e Llajnit, erdhi me një gotë konjak në dorë dhe i tha:

— A mund ta pi këtu me ju?

— Urdhëroni! — tha Llajni.



— Ne njihemi bashkë, — vazhdoi mysafiri, — bile jemi edhe tanët.

— Si? — pyeti Llajni.

— A e ke kushëri ti Alush Panajanë? — i tha mysafiri.

— Jo, — tha Llajni. — Unë e kam baba.

— E di edhe punën e trashëgimit nga fisi i babait Alush. Ti Alushin tjetër e ke nga yt atë, unë e kam nga e shoqja.

Biseda me kushëririn e ri u ngroh. Ata vazhduan të porositnin konjak herë njëri, herë tjetri.

— E di babanë, pa ata janë dy kushërinj me emrin tuaj. Po në qoftë se nga ai trashëgim Alushi s'mori gjë, nga e shoqja i ka dyert të hapura për të marrë aq sa s'ta pret mendja.

Llajnit i pëlqeu kushëririn i së shoqes së kushuririt. Ata vazhduan të pinin e të trokisnin gotat për shëndetin e njëri-tjetrit.

— Sa mirë që u njohëm, — i tha Llajnit tjetri. — Unë së shpejti do të shkoj për të marrë këtë pasuri, po ti e di, të shkosh vetë, është edhe mërzi. Kur ke një shok si ti, e aq më tepër kushëri, çdo gjë bëhet më e këndshme.

— Si nuk jemi njohur bashkë më parë? — i tha Llajni.

— Jo, unë të kam njohur dhe kam dashur të të flas, po më dukesh pak mendjemadh.

— Unë mendjemadh? — tha Llajni.

— Përshtypjen kështu ta krijon, po sot u binda se je djalë i mirë.

Po në qoftë se Llajni ishte paraqitur si mbledhës i folklorit të kometës Hallej, ky tjetri na u paraqit me një profesion tjetër më të çuditshëm.

— Me se merresh? — pyeti Llajni mikun me të cilin po pinin konjak.

— Me astrologji, — tha tjetri serioz.

— Me astrologji?! — pyeti Llajni i çuditur.

— E!... Çudi të duket? Unë shkruaj oroskopë.

— Po me luftën e yjeve nuk merresh? — i tha Llajni me njëfarë ironie.

— Jo, mbledh folklorin për luftën e yjeve, — ia preu tjetri për t'i thyer hundën ironisë.

— Unë bëra shaka, — u tërhoq Llajni.

— Ti bëj shaka me të tjerët, jo me mua, — i tha miku i konjakut. — Oroskopët e mi parashikojnë fatin tënd si në pëllëmbën e dorës.

Llajni rrinte i heshtur dhe i hutuar.

— Usta, edhe dy dopio.

— Unë s'pi, — tha Llajni me njëfarë druajtjeje.

— Ti të than piten, jo s'pi konjakun, — vazhdoi tjetri me ton urdhërues.

Banakieri mbushi konjakun. Mysafiri urdhëroi:

— Me fund!

Gotat u zbrazën. Mysafiri urdhëroi prapë:

— Edhe dy dopio të tjera!

## INTERMEXO PËR FALLXHIUN E QIELLIT

Njeriu i lashtë mendonte se atje «lart» thureshin fatet e tij, e pra, atje, pikërisht atje duhet të arrinte t'i mësonte, t'i lexonte duke përdorur shenjat «kuptimplote» të një alfabeti të veçantë të çuditshëm, fantastik, shenja që i mendonte vetë dhe i pranonte si bartëse të të vërtetave. Kështu lindi astrologjia. Në fillim, nga zbulimi astrologjik, u bënë zbulime me vlerë shkencore. Kur bënte hapat e parë, astrologjia i solli njeriut mjaft të dhëna të vyera dhe duhet theksuar se ajo vuri gurin themeltar të astronomisë.

Më pas, astrologjia e humbi rrugën e dijes, u hodh në misticizëm, në magji, në një mjet të fantazisë të drejtuar nga bestytnitë e çuditshme të pabazuara asgjëkundi veçse te dogma të errëta, thënie dhe hamendje krejt misterioze.

Shpjegimi me astrologji i fatit është një absurditet i plotë. Mirëpo astrologjia ende lëvrohet në botë, sepse kudo gjenden njerëz që besojnë, u pëlqen të kapen pas saj. Janë njerëz të paditur që i tremben së panjohurës, janë njerëz të prirur të besojnë, ta bëjnë veten të prirur nga bestytnitë

Astrologu vizaton skica të ndërlikuara, shkruan tekste plot parashikim, shkruan pra oroskopë, nxjerr përfundime, të dhëna prej orakulli për fatin e karakterin e një njeriu që ka lindur në një vit, ditë e orë të caktuar.

Astrologu pra është një «fallxhi» i qiellit që shfrytëzon padijen, bestytnitë e rrënjosura në ndërgjegjen e njerëzve për traditë. Ai shfrytëzon shkathtësisht frikën nga e ardhmja, tërësinë e ëndrrave të bukura për të ardhmen.

\* \* \*

Miqësia midis tyre u bë më e fortë. Ata takoheshin çdo mbrëmje bufeve e pinin deri natën vonë. Pinin dhe flisnin, përse nuk flisnin, por sidomos për pasurinë që do të shkonin të merrnin jashtë shtetit.

Kushëriri i Llajnit prishte para aq sa ky shpesh i thoshte:

— Më vure në borxh!

— Vetëm atë fjalë mos e zër me gojë. Kemi të hamë e të pimë, jo vetëm ne, por edhe nipat e stërnipat tanë.

Po në këtë miqësi të re Llajni ndiente një ndryshim: Djaloshi me xhakavento, sado i përzemërt që dukej, e mban-te Llajnin nën një presion të madh. Ndonjëherë ky i kri-

jonte edhe një ndjenjë frike, se i fliste edhe për gjëra që Llajnit s'i shkonin ndër mend, por, prapë miqësia me të i pëlqente e aq më tepër se e garantonte përditë e më shumë se do të bënin një udhëtim të bukur.

Një mbrëmje sa u takuan e përpoqën gotat e para, djaloshi me xhakavento i tha:

— Merre këtë dhe nesër shko thyeje në bankë.

Ai i dha një çek.

Llajni e pa me habi, me kureshtje, po edhe me gëzim. Në çek ai lexoi emrin e tij. Lexoi edhe shumën e parave.

— Janë dy mijë lekë të rinj. Shko thyeje nesër në bankë, gjysmat për ty, gjysmat për mua.

\* \* \*

Llajni rrinte i gëzuar para sportelit të bankës e priste të merrte paratë e thyera, po i ngjau një e papritur.

Nëpunësi i foli me ton të ashpër.

— Fallsifikues!...

Ai u hutua, u skuq, u zverdh, po fjalët që dëgjoji s'i lidhte dot. Në thellësi të shpirtit të tij ndjeu një diçka të turbullt, ogurzezë, të çakërdisur që i sthurte fatin.

\* \* \*

Kometa Hallej do të duket përsëri nga Toka pas 77 vjetësh, domethënë në vitin 2064. Megjithatë, për hir të së vërtetës duhet thënë se kometa përmendet edhe në një këngë popullore. Ajo është edhe sot e kësaj dite në një nga stendat e Muzeut të Himarës. Atë e ka nxjerrë patrioti Konom

Zoto dhe lidhet me një ngjarje të atyre kohërave. Kënga popullore është kjo:

*Nëntëqind e dhjetë viti,  
vaftin që shkoi komiti,<sup>1)</sup>  
thonë Himara krye ngriti.  
Seç u shkel mytesarifi,  
asqerë nga Preveza ngriti,  
Himarës seç ia vërviti.*

Këtë herë studiuesi i folklorit pas kometës nuk pati mundësi të gjente ndonjë këngë apo varg për Hallejn, por, pa u harruar jehona e saj, agjencitë e lajmeve të botës njoftuan se një asteroid me diametër 1000 kilometra do të përplasët me Tokën në vitin 2115, domethënë gjysmë shekulli më parë se Hallej.

Këtë lajm ia deklaroi shtypit kryetari i Shoqatës së Astronomëve peruanë, Estramadorje Estramadorjo. Ai vuri në dukje se rruga e kësaj mase gjigante qiellore që përbëhet nga metale të shkrira mund t'i japë fund jetës së gjallë

Sipas astronomit në fjalë është akoma shpejt të bashkohen përpjekjet për t'iu kundërvënë asteroidit, ndofta duke përdorur sonda të posaçme të pajisura me bomba bërthamore.

---

1) Lexo: Kometa

## PERMBAJTJA

	Faqe
<b>PJESA E PARË</b>	
Prolog .....	5
<i>Kreu i parë:</i>	
Qyteti me katër porta .....	11
Midis aleatëve të klasës punëtore .....	14
O Pasha, o tungjatjeta, Me ngadalë ato trumpeta! .....	17
Ese për dasmat .....	23
Aforizëm .....	25
Në fotografi buzëqesh një çift .....	31
<i>Kreu i dytë:</i>	
Moj shtëpia me dyzet pleq, Kujt t'ia prish e kujt t'ia ndreq .....	37
Drejt studimeve shkencore .....	40
Mysafirët i tregojnë një sekret .....	45
E dini pse i nënshtrohet gomari njeriut? .....	50
Intermexo .....	59
<b>PJESA E DYTË</b>	
<i>Kreu i parë:</i>	
Njeriu me tri datëlindje .....	65
<i>Kreu i dytë</i>	
Ku është ndryshimi midis kamerierit dhe kozmonautit .....	73
Kompromentimi vjen vjedhurazi .....	81
<i>Kreu i tretë:</i>	
Në frigoriferin e dyqanit të bretkocave mbyllin kryekamerierin. ....	85